

Deri më sot, si romani i parë i shkruar në gjuhën shqipe përgjithësisht merret "Shkodra e rrethuese", botuar në vitin 1913, duke anashkaluar kështu një roman më të hershëm, "Marzia o kshthenimi n'filles t'vet" i po të njëjtit autor, dom Ndoc Nikaj i cili, me botimin e tij të parë në vitin 1892, e shpie romanin shqiptar një shekull më para.

Në përkujtimin e 160 vjetorit të lindjes së autorit, këtë vit "Onufri" do ta ribotojë pas 131 vitesh këtë vepër.

"MARZIA" I DOM NDOC NIKAJT, ROMANI I PARË I SHKRUAR NË SHQIP

Nga **Andreas Dushi**

**ATDHEU LAKURIQ
I TRIFON XHAGJIKËS**
Ese nga Xhevair Lleshi

(fq.5)

SHËNIME MBI LIBRAT

"Grabjani rrëzë kodrave" i Lekë Tasit

**FUQIA SUGJESTIONUESE,
BINDËSE DHE PURIFIKONJËSE
E NJË ROMANI**

Nga **Petro Zheji**

(fq. 15)

Romani "Vito" i Bashkim Hoxhës

**ALEGORIA SI PJESË E
STRUKTURËS ROMANESKE**

Nga **Agim Bajrami**

(fq. 9)

Kolana me 7 vëllime "Teatri, kjo lojë
magjepsëse!", botimet Ideart

**PËLLUMB KULLA - "KULLË" E
LARTË E HUMORIT SHQIPTAR**

Nga **Josif Papagjoni**

(fq. 8)

"Shtëpia te Selvia" i Anisa Markarian,
botimet Çabej

SI TË ISHTE LEXIMI I ABETARES

nga **Enver S. Morina**

(fq. 12)

"Albumi i thashethemeve" i Stefan Çapalikut,
botimet Fishta

NJË ROMAN NË... PENTAGRAM

Nga **Tefë Topalli**

(fq. 10)



Si të shkruash skenar original ose të frymëzuar nga romani

Nga **Gani Mehmetaj**

Te filmi i Kujtim Çashkut "Të paftuarit" (1985), skenarin e të cilit e shkroi Ismail Kadare, autori i romanit "Prilli i thyer", koha, hapësira e personazhet nuk ndryshojnë. Filmi i përmbahet kryekëput romanit me disa zhvendosje strukturale apo ndonjë personazh që nuk e ka romani, ndërsa është shtuar në film. Te filmi brazilian "Prapa diellit" ("Behind the sun"), apo (*Abril Despedaçado*) (2001) të regjisorit Ualter Sales (Walter Salles), po ashtu sipas romanit të Kadaresë "Prilli i thyer" koha, hapësira dhe karakteret ndryshojnë.



174 vjet nga lindja


Mihai Eminescu
(1850-1889)

Përgatiti dhe përktheu nga origjinali
rumanisht: **Dr. Luan Topçiu**

(fq. 16)

VIRGINIA WOOLF
Arti i biografisë

Përktheu: **Granit Zela**



BIBLIOTEKË

— **Anna Kove** (fq. 20)

Gloria in excelsis deo

— **Neviana Shehi** (fq. 13)

Pranë heshtjes

— **Lekë Tasi** (fq. 14)

Grabjani rrëzë kodrave

— **Jack London** (fq. 21)

Zhdukja e Markus O'Brajenit

— **Mihai Eminescu** (fq. 16)

14 poezi

Me rastin e 148 vjetorit të lindjes

JACK LONDON

Përgatiti dhe përktheu:

Dr. Ernest Nasto (fq. 21)

**URIME PËR
MOTMOTIN 2024**

Nga **Enver Kushi** (fq. 11)

**Botohet në arabisht
romani "Valsi i lumturisë"
i shkrimtarit Ylljet Aliçka**

(fq. 19)

Dom Ndoc Nikaj, personaliteti i shumanshëm i fundit të shekullit XIX dhe fillimit të të XX-it, i njohur për historinë, letërsinë, biznesin dhe meshtarinë e tij, filloi të shkruante qysh herët, pak pas të njëzetave. Libri i tij i parë, “Vakinat e Kishës”, u botua më 1888 dhe libri i dytë, “Marzia o kshthenimi n’filles t’vet”¹ më 1892, duke vënë kështu gurin e parë në historinë e romanit në gjuhën shqipe. Vetëm pas 21 viteve, autori iu rikthye prozës së gjatë, me “Shkodra e rrethueme”, për të mos u ndalur më. Një pjesë prej romaneve të tij janë botuar, ndërsa dorëshkrimet e pjesës tjetër presin në koleksionet e Arkivit Qëndror të Shtetit.

Pra, Nikaj filloi si historian, vijoi si romancier, pastaj si studiues, hartoi abetare e libra ushtrimesh për gjuhën, qe dramaturg, u mor me biznes dhe shërbeu si meshtar. Secili prej dimensioneve të kësaj jete mund të jetë objekt i një studimi më vete me kapituj që i përgjigjen çdo libri apo çasti të jetës së tij, prandaj duke mos dashur të shpërndahe mi në shumë fusha, do të ndalemi vetëm te qenia e tij si romancier, veçanërisht në rastin e romanit të tij të parë “Marzia o kshthenimi n’filles t’vet”.

Paçka se kishte romane të shkruara nga autorë shqiptarë në gjuhë të huaj, si “Dashuria e Talatit me Fitneten” e Sami Frashërit, botuar në turqisht më 1872 apo “Sofia Kominake”, i lënë në dorëshkrim nga Françesk Santori², historia e prozës

¹ Te Nikaj, Ndoc “Kujtime të një jete së kalueme”, “Onufri”, Tiranë, 2016, fq. 50, Nikaj shkruan: “Unë fillova me shkruar “Vakinat e Kishës” që me ndimen e Pieter Dodmasejt mbujta me e shtypë në Shtypshkrojen e Propagandës së Romës në vjeten 1888. Mbas atij libri, në shtypshkrojen e Jezuitëve në Shkodër shtypa ma të parin romanz “Marzia ose Kshthenimi në fillesë të vet”. Këta kjene botime të bame prej meje në kohën e xhakonis e qi kjene fillesa e botimeve [të] mija.

Botimin e librit të parë “Vakinat e Kishës”, atë Gjergj Fishta e përmend edhe në poezinë satirike “Kontrata” e cila, përtej ironisë dhe satirës, na jep disa të dhëna interesante si p.sh. tirazhin e atij botimi:

E, për mos m’e tjerun hollë,
Ndigjo ‘i herë se ç’i ka ndodhë
Me një liber shqyp Dom Ndocit
Liber shqyp, po, mje n’ palë t’kocit
Don Ndoc Nikaj, si xhakue,
Historin e Kishës pat shkruar
E me ndihmë të Dodmaseut,
(Qi asht bamirsi i gjith ktij dheut.)
E botoi, s’ dij kú n’ Europë,
Jo ma shum, veç n’ pësquind copë,
Edh’ e qiti, ndigjo ‘i fjalë!
Jo m’e shitun, por m’e falë.

² Shih. Elsie, Robert, “Historia e letërsisë shqiptare”, përkth. ang. Abdurrahim Myftiu, “Dukagjini” Tiranë-Pejë, 1997, fq. 200-201.

Deri më sot, si romani i parë i shkruar në gjuhën shqipe përgjithësisht merret “Shkodra e rrethueme”, botuar në vitin 1913, duke anashkaluar kështu një roman më të hershëm, “Marzia o kshthenimi n’filles t’vet” i po të njëjtit autor, dom Ndoc Nikaj i cili, me botimin e tij të parë në vitin 1892, e shpie romanin shqiptar një shekull më para.

Në përkujtimin e 160 vjetorit të lindjes së autorit, këtë vit shtëpia botuese “Onufri” do ta ribotojë pas 131 vitesh këtë vepër.

“MARZIA”

ROMANI I PARË I SHKRUAR NË GJUHËN SHQIPE

nga Andreas Dushi

së gjatë në gjuhën shqipe zë fill pikërisht me *Marzia*-n.

Në *Historia e Letërsisë Shqipe* botuar në vitin 1959 nga *Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë* dhe hartuar nga një redaksi me në krye Dh. Shuteriqi lexojmë:

*Për sa i takon novelës së gjatë dhe romanit, i pari që na ep diçka shqip është Ndoc Nikaj, me një roman të vogël të përshtatur nga Italishtja, “Marzia e kshthenimit n’fillesë t’vet” (1892), vepër që e merr temën nga fillimet e kristianizmit.*³


Henrik Lacaj më 1963 shkruan se *Nikaj*

³ “Historia e letërsisë shqipe”, përg. Instituti i Historisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1959, fq. 551.

[...] *punon e punon me ngulm sidomos në hartimin e romaneve. Pa dyshim Nikaj asht i pari në letërsinë tonë dhe një nga të paktët prozator që del me një grumbull veprash të këtij lloji [...] Vlen për t’u vu në dukje se Nikaj me romanin “Marzia” hap ciklin e pjesëve të tjera të këtij llojit, ndonëse ka një distancë të madhe vjetësh midis këtij të parit dhe të tjerëve.*⁴ Lacaj na thotë edhe se ky roman ishte një sukses që i kënaqi lexuesit⁵ duke

⁴ Lacaj, Henrik, “Dom Ndoc Nikaj (1864 – 1951), Shënime mbi jetën dhe veprat”, “Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës (seria e shkencave shoqërore), Tiranë, 1963, fq. 189-190.

⁵ Po aty.



përforuar atë çfarë shkruhet me rastin e pesëdhjetë vjetorit të meshtarisë së Nikajt, se romani *kje këndue me shumë andje e dishir prej djelmnisë*⁶ dhe se autori është *nji nder shkrimtarët ma të lexueshëm të vendit t’onë*.⁷

Se *Marzia* është romani i parë shqiptar na e thonë edhe Rexhep Qosja⁸ dhe Aurel Plasari⁹.

Nëse të gjithë studiuesit e lartpërmendur bien dakord për këtë fakt, ata ndahen për vitin kur romani u botua.

Viti më i hershëm i përmendur është 1889, më së pari në shkrimin redaksional¹⁰ të “Hylli i Dritës” me rastin e 50 vjetorit të meshtarisë së Nikajt¹¹ ku renditen të gjitha veprat e autorit. Edhe Karl Gurakuqi, pak vjet më vonë ruan të njëjtën renditje¹². 1899 na e japin si vitin e botimit të parë edhe Lacaj, Qosja dhe Plasari. Por

⁶ “Në 50-vjetorin e meshtarisë së Dom Ndoc Nikajt”, shkrim redaksional, “Hylli i Dritës”, nr. 7, 1938, fq. 384.

⁷ “Pesëdhjetëvjetori i Meshtarisë së D. Ndoc Nikaj”, shkrim redaksional, “Cirka”, vjeti III, nr. 51-52, 31 gusht, 1938, fq. 227.

⁸ Shih. Qosja, Rexhep, “Historia e Letërsisë Shqipe – Romantizmi I”, “Toena”.

⁹ Shih. Plasari, Aurel, “Trembëdhjetë infraksionet e Dom Ndoc Nikajt” në “Shqipëria, zgjim i dhimbshëm”, Tiranë, 1991, fq. 83-84 & Plasari, Aurel, “Panteoni i gjymtuar”, “Nëntori”, 4/1991, fq. 91.

¹⁰ Aurel Plasari në “Trembëdhjetë infraksionet e Dom Ndoc Nikaj” ngre dyshimin për autorësinë, duke thënë mendimi im është se i përket penës së At Anton Harapit dhe unë si të tjin do ta cek. (Plasari, Aurel, vep. cit., fq. (...)).

¹¹ “Në 50-vjetorin e meshtarisë së Dom Ndoc Nikajt”, art. cit. fq. 390.

¹² Gurakuqi, Karl, “Ndoc Nikaj (1864) “Shkrimtarët Shqiptarë – pjesa II”, në “Shkrimtarët Shqiptarë, Pjesa II”, botim i Ministris s’Arsimit, Tiranë, 1941, fq. 94.



Familja e Dom Ndoc Nikajt.

Në këmbë: Pjetër Guli (daja), Kini (vëllai), Shaqja (motra), Dom Ndoc Nikaj, Çilja (motra), Pashku (vëllai), Kel Guli (daja). Ulur: Gjoka (i ati), Asunta (e motra, murgeshë), Justina (shoqja e motrës), Ageja (e ëma), Matia (daja), Ogulina (e motra), Tonia (e motra)



Dom Ndoc Nikaj me fëmijët e të vëllait, Kinit: Lezja, Zefi, Luigi, Lini

pavarësisht kërkimeve tona, nuk e kemi gjetur dot një kopje të këtij botimi. Mund të ngrihet dyshimi mos redaksia e *Hyllit* gabon dhe të tjerët citojnë vazhdimisht atë gabim, por kjo duket e çuditshme, pasi ai shkrim botohet në gjallje të autorit. Duhet mbajtur parasysh se Lacaj në artikullin e tij, bën edhe një përshkrim të shkurtër të veprës duke thënë *shkrimtari ynë nxori romanin e shkurtë, por mjaft tërheqës "Marzia", me të cilin tregoi se ishte një përkthyes apo përshtatës i mirë dhe se gjithnjë mbrenda sferës fetare dinte të zgjidhte subjekte mjaft të kandshme nga grumbulli i romaneve, që flasin mbi martirizimet e të krishterëve në shekujt e parë të salvimeve*¹³. Kështu, ai na bën të besojmë se nuk i është referuar vetëm shkrimeve të mëhershme për Nikajn, por edhe e ka pasur në dorë veprën me këtë vit botimi. Kjo përfordhet edhe nga fakti se në tekstin e përgatitur prej *Institutit të Historisë dhe Letërsisë* më 1959, për *Marzia-n* jepet si vit botimi 1892 dhe arsyeja na çon të mendojmë se Lacaj, po mos ta kishte pasur veprën fizike në dorë, do t'i ishte referuar edhe atij studimi. Po ashtu, sërish në një shkrim me rastin e pesëdhjetë vjetorit të meshtarisë së Nikajt, shkruhet ... "*Vakinat e Kishës*" *qi u botue në vjetin 1888 në Shtypshkronjën e Propagandës në Romë. Nji vjet mbrapa botoi romancin e vogël "Marzia" që u lexue me shum andje prej së rijsh*¹⁴. Por prap se prap, duke mos e pasur në dorë një kopje të këtij viti botimi, mund të thuhet se kemi të bëjmë me një fantomë.

Robert Elsie¹⁵ dhe Arshi Pipa¹⁶ janë të mendimit se viti i botimit të parë të romanit është 1892. Të njëjtin vit ka edhe kopja më e hershme e kësaj vepre në fondin e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë¹⁷ e cila gjendet në katër ekzemplarë. Ky botim pasqyrohet edhe te bibliografia e Legrandit, *Bibliographie albanaise* me nr. 557 si dhe te Manek etj., *Albanesische Bibliographie* me nr. 14/1892. Kopje nga ky botim, shtypur në Shtypshkronjën e së Papërllyemes kemi pasur në dorë.

Te zëri i *Marzia-s*, Legrand shton: *Ky roman i shkurtër është botuar vetëm në njëqind kopje, siç më është thënë në letrën e tij të datës 20 maj 1899 nga Faik Bej Konica, i cili mori këtë detaj nga autori vetë*¹⁸.

Më 1893, vepra ribotohet. Përveç vitit në frontespice, është identike me paraardhësen. Disa kopje të saja, të cilat mundëm t'i konsultojmë, gjenden në fondet e BKSh (me nr. 159 te Bibliografia e Vozgës). Ky botim, me vitin 1893 pasqyrohet si botimi i parë dhe i vetëm i veprës "*Marzia*" në katalogun e botimeve të së Papërllyemes, përgatitur prej Luigj Shehanit dhe i mbetur në dorëshkrim¹⁹ si dhe në studimin e Markus W. E. Peters "Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë..."²⁰

Zgjidhja për çështjen e vitit të botimit gjendet në vetë fondin arkivor të lënë nga Nikaj, që është pjesë e Arkivit Qëndror të Shtetit. Është e njohur mania e tij për t'i ripunuar veprat, sikurse ndodh me "*Vakinat e Kishës*" që 26 vjet pas botimit

¹³ Lacaj, Henrik, "Dom Ndoc Nikaj...", art. cit., fq. 185.
¹⁴ "Pesdhjetvjetori i D. Ndoc Nikajt", shkrim redaksional, "Gazeta shqipëtare", 1938, 27 gusht, fq. 2.
¹⁵ Elsie, Robert, vep. cit., fq. 200.
¹⁶ Pipa, Arshi, "Letërsia Shqipe: Perspektiva Shoqërore", përkth. Myftar Gjana, "Princi", Tiranë, 2013, fq. 185.
¹⁷ Shih. Vozga Ramazan, "Libri shqip 1555-1912 në fondet e Bibliotekës Kombëtare", nr. 153, BKSh, Tiranë, 2010.
¹⁸ Legrand, Émile, "Bibliographie Albanaise", ribot., "Botime Françeskane", Shkodër, 2011, fq. 182.
¹⁹ Një kopje e këtij dorëshkrimi është dhuruar pranë BKSh nga familjarët dhe mban titullin "Katalogu i librave të botuem nga shtypshkronja 'Zoja e Papërllyemë' t'etëve jezuit në Shkodër prej vjetit 1871-1928".
²⁰ W. E. Peters, Markus, "Shtëpia botuese më e vjetër në Shqipëri dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare, arsimin dhe kulturën", përkth. Emond Malaj, "Shoqata e Jezuitëve", Tiranë, 2016, fq. 480.



Shtypshkronja "Nikaj", 1909.
 Jak Nikaj (ulur), Luigj Gurakuqi, Pjetër Cafa, Martin Manovi, Tunin Franja, Lec Gjeka.

të parë, del me titullin "T'nollmet e Kishës. Ç'më kohë t'vjetra e deri n'tashmet", "Shtypshkronja Nikaj", Shkodër, 1914 apo me "Historija e Shqypniës. Ç'më kohë t'vjetra e deri m'tashmet" botuar për së pari më 1902 dhe për së dyti, më 1917, sërish në shtypshkronjën e tij.

Faksimilet e mëposhtme autoriale të Nikajt na tregojnë se ai filloi ta ripunonte edhe *Marzia-n*, por procesi u ndërpre në një pikë dhe në dorëshkrim mbetën vetëm dy kapitujt e parë të librit.

Sikurse shohim, autori e qartëson vetë vitin e botimit duke na thënë se romani

u botua më 1892 dhe se në këtë rast, pra të dorëshkrimit që kemi para syve, kemi të bëjmë me një përsëritje nga autori të atij teksti. Ndonëse, ç'është e vërteta, mes kapitullit të parë të *Marzia-s* dhe këtij dorëshkrimi, ndryshimet janë shumë të mëdha, thuajse thelbësore, ndryshe nga sa ndodh me rastin e dy botimeve të "*Vakinat*" apo "*Historia*" në të cilët, autori vetë na thotë se ndryshimet janë kryesisht në rrafsh gjuhësor:

Kshtu edhe m'ket blëe t'Nollmesh, sikursë nder gjith shkrimet t'ona, kena kerkue me shporrë ato shkronja qi duken e ianë t'teperme...

Saa per nduer t'shkrimit t'fialve, per deri m'sot, mundena me thanë qi askush nuk




*mundet me gjikue e me prozhmue tietrin, pse deri m'tash nuk është shetue nji fillce shkrimit qi t'na diftoinë per njimënd si do t'shkruset fiala.*²¹

Romani

"*Marzia* o kshtenimi n'filles t'vet" tregon historinë e një paganeje, shërbestare në tempullin e perëndeshës Vesta e cila, si gjithë shërbestaret e tjera, virgjërinë e kishte të shenjtë. Ajo rridhte nga një familje e njohur dhe e pasur, por që fëmijë, i qe dorëzuar tempullit. Ngjarjet ndodhin në vitet e para pas Krishtit, kohë kur akoma feja po përhapej nëpërmjet udhës apostolike.

Perandori, për një krim të pakryer, dënon vëllain e saj, Severin, me vdekje, por ai arrin të arratiset dhe, para se të lërë atdheun, vendos të shkojë e të takojë të motrën. Ishte një nga netët në të cilat ajo duhet të ruante zjarrin që të mos fikej në tempullin ku shërbente. Sapo sheh të vëllain, *Marzia* del dhe e përqafo. Por biseda zgjat aq sa zjarri fiket e për më

²¹ Nikaj, Ndoc, "T'nollmet e kishës", "Nikaj", Shkodër, 1914, fq. 14.



tepër, njerëzit e shohin duke përqafuar një burrë.

Gjyqi vendos ta gjykojë dhe për këto krime, e dënon me vdekje, duke e varrosur për së gjalli në një guvë të nëndheshme. Aty i lënë vetëm pak ujë dhe bukë sa të shtyjë për një ditë. Teksa ishte në agoni, sheh mirazhin e një engjëlli që vjen dhe e shpëton. Në fakt ishte shoqja e saj, Prudenzia bashkë me të motrën, Preseidën dhe të tjerë njerëz, të njohur e të panjohur që kishin përqafuar krishtërimin. Ato e strehojnë dhe Marzia fillon të njohë Krishtin nëpërmjet tyre.


Pas një kohe të shkurtër, pagëzohet dhe kërkon që bashkë me të tjerët, t'u shërbejë të krishterëve, në atë kohë të shpëtojë, të burgosur dhe të dënuar nga pushteti i Romës. Me anë të rryshfetit, Presedia e të tjerët arrinin të futeshin në burgjet ku vuanin apo prisnin vdekjen të krishterët dhe t'i ngushëllonin, t'i ushqenin apo t'u jepnin ndonjë ndihmë tjetër.

Në një prej atyre ditëve, në një qeli, Marzia sheh të shpërfytyruar vëllain e saj dhe vendos ta ndihmojë e ta shpëtojë. Ai, nga ekzili kishte njohur Krishtin dhe qe kthyer për të shpërndarë fjalën e tij në Romë. Kur del në gjyq, nën tortura të tmerrshme i kërkojnë të mohojë Krishtin, por Severi nuk pranon. Gjatë torturave, atij i del gjak dhe e motra, me një façetë, ia fshin. Gjyqtari pyet kush është ajo dhe Marzia i thotë: "Jam motra e Martirit!". Gjyqtari e dënon edhe atë me vdekje, sipas një dënimi të zakonshëm në atë kohë kundër të krishterëve: Në një arenë me luanë të uritur. Ajo vdiq dhe u varros në katakombet romane.

Romani synon kështu të tregojë vuajtjet e të krishterëve të parë dhe gatishmërinë e tyre për t'u sakrifikuar për Krishtin; po ashtu, ai rrëfen edhe mënyrën e jetesës së fshehtë të të krishterëve (që deri në vitin 313 ishin të paligjshëm në Perandorinë Romake) dhe konvertimin e paganëve në të krishterë, vëllazërinë e bashkësive të krishtera dhe përmasat e jashtëzakonshme të dashurisë së tyre dhe mizorisë së romakëve.

Dramatizimi i veprës

Në fillimet e viteve '20, zhanri i dramës në Shqipëri po nxirrte krye ngadalë, me brishtësi. Secila dramë ishte një kontribut jo i vogël për pasurimin hap pas hap të kësaj forme të re artistike, pak të njohur dhe tepër të pëlqyer nga publiku. Ishte kohë pra, kur nuk kishte mirëfilli dramaturgë, ndaj personalitete të angazhuar në të tjera fusha të shkrimit, ndonjëherë shkruanin edhe drama. Mes



tyre ishte edhe dom Ndoci i cili, subjektin e romanit të tij "Marzia" e kthen në dramë me titull *Motra për vllan* dhe e boton në vitin 1924. Drama ka tetë të dukuna (skena) dhe qysh në mbititull, sqarohet se është një *Çfatime teatrore për varza*, pra për shkollat apo institutet vajzore të kohës.

Personazhet e romanit portretizohen më mirë në dramë, marrin karakteristika më konkrete dhe diskutimet e bisedat i qasen më natyrshëm gjuhës së zakonshme të popullit, duke u vënë re edhe një shkëputje e lehtë prej asaj mahnitjeje hyjnore e frymëzuese që lexojmë në faqet e romanit. Po ashtu, tematika lëviz; nga një vepër e kushtuar sakrificës për Zotin nëpërmjet martirizimit të të krishterëve të parë, tani kemi të bëjmë me një vepër ku tregohet deri në ç'pikë mund të arrijë sakrifica e motrës për të vëllanë, dhe ky variant i tekstit është shumë më larg atij origjinar pasi, sikundër e thamë më lart e do ta sqarojmë në vijim, kemi të bëjmë me një roman që nuk është tërësisht krijim vetjak i autorit, por përshtatje dhe ritregim i një teksti pararendës.


Origjina e tekstit

Në frontespicin e romanit sqarohet *E citi ngjuhë scgyptare D. Nnoz Njkai*. Po ç'domethënë "e çiti"? Nuk është e zakonshme si formë shprehjeje, përktheu, përshtati, solli po, por çiti? Gjithsesi, duke bërë këtë sqarim, autori tregohet krejt i hapur me lexuesin, ndryshe nga të tjerë autorë të kohës e të mëvonshëm.²²

Kjo fjalë na bindi se në fakt, nuk kishim të bënim me një tekst tërësisht origjinal të autorit, se burimi për shkrimin e këtij libri vinte nga diku dhe tani na mbetej të zbulonim edhe burimin, edhe qasjen e autorit në të.

Nëse subjekti tregonte jetën e një martireje të vërtetë të krishtërimin, pra rrëfimin e jetës së një shenjtë, çka ishte subjekt i një pjese të madhe të librave të botuar në ato vite, atëherë patjetër martirja me emrin Marzia do të gjendej në indeksin e *Martyrologium Romanum*, vepra përmbledhëse e të të gjithë martirëve të kishës katolike romane. Pavarësisht kërkimeve tona në disa prej botimeve, nga më të hershmet e referencialet, deri te më të vonat, nuk mundëm të gjenim një martire me emrin dhe fatin e personazhit

²² Shih. Plasari, Aurel "Traditë letrare, historizëm, estetizëm", "Studime Albanologjike", 2008/2, fq. 14. Aty, Plasari tregon dy poezi të atë Vincens Prenushit nuk janë krijime, por përkthime. Kështu, në rastin e "Grueja Shqyptare" kemi të bëjmë me *diccka mes një përkthim të lirshëm, një adaptim të shthurur të poezisë* "La donna italiana" të poetit Giuseppe Regaldi, dhe se origjinalin e poezisë "Burri Shqyptar" e gjejmë me titull "I martiri di Palermo" të po të njëjtit autor.



tonë. Pastaj kërkimin e orientuam duke pasur parasysh datën e martirizimit, të treguar në fundin e librit ku përshkruhet rrasa e varrit të Marzias në katakombet e Romës: dymbëdhjetë prill. Asnjë nga të krishterët e martirizuar atë datë të ndonjë viti nuk ndante histori të njëjtë me personazhin. Vajtëm akoma më larg: Në kohën kur ndodhin ngjarjet në roman, në Romë funksiononte kalendari julian. Konvertuam datën 12 prill të kalendarit julian në gjegjësen e tij të kalendarit gregorian, pasi e *Martyrologium Romanum* u botua pas këtij ndryshimi, por sërish nuk qe një kërkim i frytshëm.²³

Hoqëm dorë nga ideja se kishim të bënim me një personazh të vërtetë historiko-fetar dhe, duke mbajtur parasysh faktin se shpesh në vitet e para të krishtërimin, fate të vërteta rrëfeshin nëpërmjet personazhesh të trilluara pasi mungonte mundësia për një dokumentim historik, por ngjarja kalonte e rrëfyer gojë më gojë, kërkua ta gjenim mes të tilla teksteve edhe origjinarin e romanit të Nikajt. Dhe pasi kërkua në katalogjet e pjesës më të madhe të bibliotekave evropiane, ramë në gjurmët e atij materiali.

Bëhet fjalë për librin *Marzia la vestale*; *Racconto Storico*; *dei primi tempi del cristianesimo* shkruar nga Enrico Mastracchi, botuar në Firenze më 1875. Në frontespis, po ashtu, tregohet se kemi të bëjmë me një *reduktim të variantit frëng* i cili nuk përmendet me titull origjinal, ndaj nuk e identifikua dot. Të njëjtën metodë, atë të reduktimit ndjek edhe Nikaj me variantin e Mastracchi-t, duke na dhënë në shqip një libër më pak

²³ Ky ndryshim ndodhi pikërisht para botimit të *Martyrologium Romanum*. Ai ndryshon me dhjetë ditë nga paraardhësi. Më 1582, 4 tetori u ndoq menjëherë nga 15 tetori. Kështu 12 prilli julian i konvertuar në kalendarin gregorian do të jepte datën 23 prill.

voluminoz për nga përmbajtja.

Meqë nuk e kemi të identifikuar tekstin frëng, nuk mund ta dimë dot nëse metodika e punës së Mastracchi-t ka përfshirë edhe doza origjinaliteti në vepër, por nga ai variant te i mëvonshmi i Nikajt po, autori i ri, *xhakue* sikurse thotë vetë te kujtimet e veta, i jep vetes të drejtën për një dozë të arsyeshme kreativiteti. Ndryshimi tërësor, ose ritregimi me fjalët, shprehjet dhe stilin e tij prej shkrimtari të pjekur tanimë, duket se ka qenë dëshira e mëvonshme e autorit, e porealizuar. Qëmtimi i një krahasimi mes tekstit të Mastracchi-t dhe atij të Nikajt është një punë që do të shoqërojë edhe botimin e plotë të romanit në gjuhën shqipe.

Botimi

Romani, sikurse e thamë që në krye, do të botohet këtë vit nga shtëpia botuese "Onufri", me rastin e përkujtimit të 160 vjetorit të lindjes së Nikajt. Duke qenë se leksiku do të ruhet ashtu sikurse është dhe vetëm alfabeti do të njësohet me atë të cilin Nikaj propozoi më vonë në abetaret e tij dhe përdori vetë në krijimet e pas Kongresit të Manastirit, botimi do të shoqërohet me një fjalorth për fjalët e rralla, arkaizmat dhe huazimet, kryesisht orientizma si dhe do të paraprihet nga një studim i qenësishëm i aspekteve që në këtë prezantim paraprak u prekën shkarazi. Në këtë mënyrë, urojmë të prishet edhe ai mallkim edipian i vendit tonë që vrau atin e romanit shqip, sikurse thotë Visar Zhiti në "Kartelat e realizmit të dënuar". Sepse Nikaj vdiq në burg, në moshë shumë të thyer, i arrestuar nga sistemi komunist. Dhe, rastis që javën e ardhshme, më 16 janar të kujtohet edhe përvjetori i ndarjes së tij nga jeta.

Dritarja me një dantellë trëndafili, ndriçohej me një dritë të zbehtë agimi, ndërsa zemra digje nën *Atdheun që është lakuriq*, por drita e tyre e dobët rrethohej nga një errësirë e rëndë.

...E pashë Atdheun lakuriq, (vetëm pa miq e shokë)/mundohej të këpusë një degë dafine/nga lavdia e shekujve./Atdheun e dija të uritur!/Por sa i vogël qenka!/As një degë nuk e këpuste dot./E mora për dore/ta rrit në zemrën time.../Vëllezër-/Po e kërkuat Atdheun,/e kam unë./Ndihamomëni të qesh/ Ndihamomëni të gëzoj./Atdheu është lakuriq!/(1963)

Mërzia binte si re. Ndoshta thurej ndonjë aventurë që hallakatej andej-këtej me zë të ulët, pasi gjithçka kish nisur më 20 korrik 1963, kur një shofer i parkut automobilistik të Korçës, ka trokitur në Degën e Punëve të Brendshme në Pogradec dhe ka denoncuar se “një major që kishte marrë një makinë nga Elbasani, zbriti pa pritur në rrugën Qafë Thanë - Pogradec, afër lapidarit të Reshit Çollakut”. Sytë përquendruar, veshja e thjeshtë me një çantë shpine ushtarake, ngjyra blu herë e çelët dhe herë e rënduar, qe thelluar në mënyrë të çuditshme në një vijë të hollë e të guximshme, duke krijuar një subjekt të përsosur për një artikull gazete. Aty në bisht të vijës prisnin dy civilë të tjerë, të cilët kishin hipur në Elbasan. Ja, pra, “majori do të takonte dy civilë”, me siguri e shtuar nga hetuesi. Dukej ndodhi e çuditshme! Hetimet e rrepta u mbushën plot e përplot. Orekset kënaqeshin me të qeshura duke treguar dhëmbët e prishur të diktaturës, që në një hetim të ndërë, përshkruanin se “pas pak mbërriti dhe shoferi i dytë, që raportoi në Degën e Brendshme për zbritjen e tre civilëve të tjerë në të njëjtin vend. Emrat e tyre: Thoma Rafaeli, Vangjel Lesho dhe Franko Sara”.

Funksionarët e diktaturës kishin “qëndrim dhe sjellje korrekte” dhe, si të thuash, të papërlyer, në dukje, gjë që ishte e domosdoshme asaj kohe për njerëzit në ato organe; gjithnjë me atë vështrim të fikur e të shtrënguar brenda syve, aq sa kishte rrezik të mos lëviznin apo të vëzhgonin dot. Në çantat e shpinës 3 kamerdare makine, 6 salvaxhente për të lidhur varkën në breg, 6 lopata të vogla dore për të lëvizur varkën e përgatitur me kompensatë, një bajonetë, një thikë dore, një elektrik dore i izoluar, për t’u ruajtur nga uji, një revolver sovjetik, pagure me pije alkolike dhe dokumente të tjera personale. Dhe natyrisht plani: “Do të arratiseshim për në Jugosllavi”... Këtu zë fill arrestimi dhe ndëshkimi i grupit më politik dhe antikomunist të viteve ‘60. Trifon Xhagjika, Fadil Kokomani, Robert Vullkani dhe Stavri Rafaeli...

Një qoshe krejt e dyshimtë, por spikaste me qetësinë e moshuar e të dashur. “O njerëz të thjeshtë./ju dua./Mund t’iu shërbej./si ushtar, si shërbëtor besnik./Veç me mua ejani,/t’iu rrëfej të vërtetën./që ndrit./Ta dinë udhëheqësit lart./dhe e larta Republikë./se ne nuk jemi,/as të verbër,/as shurdh në politikë.../Tek ty jam,/I lirë pa liri,/I gjallë i pajetuar,/I vdekur, i pavarrosur. Është “Kënga e verbër”(Trakt). A thua se kishim një akuzë të hapur, një shpërthim të sinqertë dhe rebel. Sekonda solemne. Ndërkohë, dëgjoheshin hapat e butë të vdekjes, e cila përshkonte hapësirën e zbehur, në zjarrin që digjte shpirtra, gazmendit i hijeve të rënda. Ishte sikur mes bisedës së tyre, krejt papritur të kishte hyrë e *papritura*, duke i parë të pranishmit me atë vështrimin e saj të akullit. Por Trifon Xhagjika dinte t’i këndonte bukur edhe dashurisë, të cilën e mbante në dorë dhe në zemër. “Dashuria, - shkruan ai diku, - ka qenë për mua gëzim që bulon nga lulja në akull, freski e borës që lodron në rrëze dielli, stuhi e egër që skërmitet në oqeane.”

Dhe fjala mori dhenë... mbërthyer prej kësaj atmosfere të gëzuar, me të qeshura që morën një tingull aq të çuditshëm, sërish të habitur, por që ngjanin me zhurmën e tingullit të kristaleve që thyhen. Madje, u krijua e gjitha kjo skenë gjykimesh të rrëmujshme ku elementët e ndryshëm të pranishëm përziejeshin me skeptikë mondanë dhe shtyeshin e hidheshin njëri - kundër tjetrit.

ATDHEU LAKURIQ I TRIFON XHAGJIKËS

Ese nga Xhevair Lleshi

Nga i gjithë ky grup, dy vetë u pushkatuan, Trifon Xhagjika dhe Thoma Rafeali. Dhe Trifoni është i vetmi që as tentoi të arratisë. Të tjerët u dënuan me nga 25 vite burg, por më pas u pushkatuan në revoltën e Spaçit në vitin 1973.

- Thuaj, pra, sa do të jemi nesër?... Po tjetër?
- Kurrë nuk dihet me saktësi se sa do të jenë, por ma thotë mendja se do të jenë shumë!
- Po pse, gjithë popullin do ta pushkatojnë?
- Jo gjithë popullin, po në emër të popullit!...
Më 23 gusht të 1963 Trifon Xhagjika ishte para hetuesve të tij, kapiten Rustem Çipi dhe prokurorin Major Sami Kapllani, duke rrëfyer “veprimtarinë armiqësore” kundër pushtetit popullor.


E di cila është e mërzitshme te këto *histori me pushkatime*? Duket se janë gjithmonë të njëjtët njerëz... Mirëpo duhen fytyra të reja. Ka nevojë njeriu i gjorë... Përpiquni, pra, të na gjeni ndonjë... Pa shiko!... Më erdhi një ide! Po shkoj t’i lutem atij njeriu atje... E di ti, or mik se Trifon Xhagjika ishte një antikomunist i sinqertë? Se, sinqeriteti qoftë edhe antikomunist, si ai i Trifon Xhagjikës, do të çonte patjetër te pushkatimi i tij në fund. Ai që fliste ishte duke u përgjumur mu në mes të sallës së pritjes në Degën e Punëve të Brendshme. Në atë mënyrë ai argëtohej për së largu duke ndjekur bisedat delikate, por duke mbajtur një pozicion me dinjitet të paparë. Pastaj ai u kthye, duke thënë se Trifon Xhagjika duket se është bërë pjesë e këtij grupi, prej miqësisë me Vangjel Leshon, ish gazetar i Radio Tiranës dhe mik me Trifonin. Hetime të vështira dhe torturose: Dhe gazetari që pat tentuar të arratisë, pranoi se në grupin e tyre ishte dhe Trifon Xhagjika.

- Kjo nuk është e mundur.
- Çfarë?! Edhe ju paskeni qenë në atë grup!
- mërmëriti hetuesi duke qeshur.
- Eh, jeta duhet njohur me të mirat dhe me të këqijat e saj...

Ata u zgërdhinë një copë herë. u tërhoqën pas, duke u fërkuar e përplasar njëri me tjetrin, të pushtuar nga një gaz i papërmbajtur. Ky kalama ishte gjithë turp dhe si i mahnitur. Më 15 gusht të vitit 1963, ai ka pranuar para hetuesit se në shoqërinë e tij bënte pjesë dhe Trifon Xhagjika. Ai më hiqte mërzitjen.

- Po vënë një pjesë të jashtëzakonshme në skenë.

- Po si kështu, zotëri! Është e mundur të gjendet një njeri që të mos e dojë punën?!



- Armiqtë e popullit nuk e duan, ndaj ne u japim plumbin... - Kapiteni rrinte te dera si i kafshuar nga qeni.

S’kishte si të kos i admiroje ata njerëz, që bënin tërë atë punë ‘të fisme’! Dhe zëri i atyre që flisnin ishte bërë i butë e molisës, sikur të ndjenin një prehje shpirtërore prej kishë, apo atë këngën diskrete e të mekur që luhej aty. Thuhet qartë në aktadinë e ‘krimit’, se nga i gjithë grupi, Trifon Xhagjika ishte pro-Perëndimor, ishte gati të arratisë jashtë kufirit dhe më pas në Itali, kurse pjesa tjetër pro-Ruse.

Asnjë prej hetuesve, të cilët si zakonisht tundnin derën, nuk kishte ndërmend të dorëzohej, ndaj hidhnin vështrimin sa andej-këtej. Të paktën të kishin gjetur një bionde të mrekullueshme. Por megjithatë erdhi çasti të mbeteshin vetëm. Hetuesit përziejeshin me ta, thoshin ndonjë frazë miqësore, të besueshme, shpejt e shpejt, pastaj ktheheshin me një shkëlqje syri dhe me një shenjë mirëkuptimi. Ishte si një parullë që ai e shpërndante në një mënyrë të natyrshme. Njoftimi vraponte sa tek njëri, tek tjetri, përmbi zhurmën e ethshme të këtij operacioni fajësie. *Disidenca letrare*? Trifoni kishte botuar ndërkohë një libër me poezi “Gjurmët” dhe kishte ende pa botuar një grumbull poezish të mirëfillta disidente. Poezia “Kroi plak”, “Atdheu është lakuriq”, “Për ty Republikë” etj., janë dokumente të forta të vetëdijes së tij antikomuniste.

- Jo, mos flisni kot, - thoshin të dy hetuesit me një zë. - Poezia është gëzim, është dritë... E keni dëgjuar mirë apo jo?

- E mrekullueshme! - mërmëriste roja, i plakur brenda një dite. Ai fshihte një buzëqeshje të papërcaktuar e disi enigmatike, e cila nxirrte në pah pak nga e verdha e dhëmbëve të tij.

Ndryshe nga të tjerët më 23 gusht, si sot 60 vite më parë, Trifoni ka dhënë llogari para hetuesve për këto poezi. Ka dëshmuar kujt ia ka dhënë, kush i ka lexuar e pse i ka shkruar. Këto vargje Trifoni i deklamoi përpara trupit gjykues. Tirana drithëronte. Tirana rrëqetëj. Tirana dëgjonte poetin tridhjetenjë vjeçar, që nuk i luante qerpiku. Diktatura dhe shërbëtorët e saj shtrëngonin nofullat, lëshonin britma ogurzeza “në emër të popullit”(!). Po luhej akti i një tragjedie...

Avokatja Vera Bodo thotë se ata ishin të akullt, të pandjeshëm dhe të prerë. Vendimin e kish marrë tjetërkush. Sadizmi komunist. Por... e pashoqe qe qëndresa dhe krenaria e Trifonit.

- Po filloj të shqetësohem edhe unë...

Kishte ardhur momenti për të rrezikuar. Mbrëmja letrare në hetuesi po shkonte për bukuri. Edhe titujt flasin shumë: “Kënga e verbër”, “Ndihamomëni të qesh”, “Nuk duan të kuptojnë, që jemi njerëz” etj. E besonte edhe vetë se e kishte seriozisht atë që kishte shkruar dhe në ato që thoshte.

- E kam vërtet shumë seriozisht... Është një trill, ju e dini.

- Ee, meqë puna qenka kështu, atëherë do t’ju ndihmoj unë, - dëgjon t’i thonë.

Dhe *sinqeriteti* i tij i keqpërdorur!

Në fakt historitë e vërteta njerëzore nuk janë bardhë e zi. Trifoni ishte pjesa e sinqertë e grupit, që besonte si antikomunist, vepronte si i tillë dhe donte të arratisë në Perëndim. Por sa vinin dhe e humbnin ritmin, bëheshin më pak aktivë dhe një lloj lodhje dukej sikur i përkundte e i përgjumte.

Hetuesit iu vunë punës për ta shkatërruar fshehurazi, po edhe drejtpërdrejt poetin, me një lloj zhurme të lehtë prej dhelprë; ndërkohë që hundën e kishin futur tërësisht brenda në dosje, shoqëruar me një ndjenjë

të trashë kënaqësie, saqë nuk donin as t’u binte ndërmend ta hiqte që andej, gjithnjë pa u ngutur, duke shkuar sa tek njëri tek tjetri, pa ngulur këmbë, rrinin aty disa çaste për të vështruar burrin e sinqertë dhe kurdoherë me një pamje pyetëse të heshtur dhe duke vënë buzën në gaz dhe... bënin tutje.

Zjarri i madh digjej në gjoksin e paduruar të historisë, duke e shndërruar atë - herë në ngjyrë rozë, herë si të thatë - më shumë seç duhet, po edhe çuditërisht të ngathët. Ai u arrestua në shtëpi sepse kishte marrë pjesë në çdo plan antikomunist(!), ai ishte edhe vetë formulesi i trakteve të hedhura në prill të vitit 1962 në Tiranë! Dëshmitarët e pranojnë këtë. Vangjel Lesho ka porositur Trifonin. Shkrimi i përmbajtjes. Pastaj edhe Fadili. Më në fund shpërndarja. Dorezat plastike të motrës infermiere për të mos lënë shenja gishtash dhe një shishe zamke... Dhe kështu ka humbur sekretin, por në hetuesi del qartë. Trakti i shpërndarë në Prill të vitit 1962 qe ideuar nga Trifoni dhe Vangjel Lesho.

Padyshim edhe lidhjet e shpikura nga gjithë këqyrja e dosjes ka dy detaje që duket se janë të shpikura nga vetë anëtarët e grupit, për të krijuar besim tek njëri-tjetri por që në fund u janë përdorur si vepra të rënda penale. E para ka qenë lidhja me jugosllavët. Këto lidhjet i pranuan në hetuesi, ku thuhet qartë se që në fillim të bindej Trifoni se nuk ka rrezik për arratisje, pasi do të ndihmojnë jugosllavët matanë kufirit. Pastaj edhe pjesëtarët e tjerë të grupit. Legjendat që thureshin me ambasaden jugosllave për arratisjen e tyre, është një nga ato mitet që njeriu ngre për t’i besuar vetë. Trifon Xhagjika i rrinte pranë mendimit të tij, herë-herë hidhte vështrime të buta, të shoqëruara gjithnjë me një buzëqeshje të zbehtë. Në urinë e tij prej ujku, duke u bërë ceremonial, ai provokonte se në këto çaste gjithçka vëzhgonte me bishtin e syrit.

Gënjeshtra më e bukur ishte atentati politik kundër dikujt nga udhëheqja. E gjithë kjo është bërë në përpjekje për të bindur Trifonin t’u gjente bomba dhe pistoleta, që t’i kishin për t’u arratisur. *Atdheu i veshur dhe i mbetur lakuriq* e ka ngrënë sapunin për djathë. Dhe mbetën tek ideja se duhej një akt terrorist ndaj udhëheqjes që të bënte bujë.

Trifon Xhagjika i ka besuar të gjitha hamendjet që përfundonin në veshët e Sigurimit e të hetuesisë. Bombat dhe pistoletat që nuk u gjetën kurrë, u përdorën si aktakuza themelore ndaj poetit, që i ka kushtuar pushkatimin. Qëndrimi krenar dhe ekstravagant, mendimi krejt i dukshëm në ballë, mania e një sinqeriteti të sëmure, larg - shumë larg marifeteve, me të vetmin qëllim që të mos turpërohej kur ta shihnin në sy, ndeshte gjithnjë në ngërdheshjen e tmerrshme e të hapur, bëhej hezitues, nuhatës, duke lënë gjithçka në harresë. Një ushtarak model, por i konsideruar tradhtar ndaj atdheut u bë lajtmotiv për fundin e tij është tragjik.

Nga i gjithë grupi ky është i vetmi që ka shfaqur gatishmëri antikomuniste, por s’ka bërë asnjë gjest penal përveç poezive që konsideroheshin agitacion e propagandë, kanë takuar diplomatë të huaj. Ky vetëm ka qenë dakord. Dhe u pushkatua. Drama e sallës së gjyqit është një histori më vete. Prokurori ka lexuar pretencën: “Veçanërisht paraqesin rrezikshmëri të lartë shoqërore të pandehurit Trifon Xhagjika dhe Thoma Rafaeli, të cilët duke qenë oficerë të Ushtrisë Popullore, kanë tradhtuar adheun.”

Trifoni krenar, dëgjonte me interes të veçantë dhe adhurim të bindur, të fshehtat e tjetrit, asnjëherë dhe kurrë nuk i rrëfente ato që kishte brenda vetes. Vëllai i tij Ylli Xhagjika sapo dëgjoi shqiptimin e vendimit me vdekje dhe me të parë ligështinë e Trifonit në fytyrë u ngrit dhe i tha: “Ngrije kokën lart. Nuk u frikësohemi këtyre ne!” Është ndaluar në sallën e gjyqit dhe arrestuar dy javë më vonë. Sytë e saj digjeshin prej kureshtjes. Ajo vdiste që të ishte në mes të historive të forta, i mbërthyer nga dëshira për të dhënë si i vëllai edhe më sublimen, jetën.

Janë një varg pyetjesh e mëdyshjesh, të cilat i dalin para skenaristit në çastin kur e fillon procesin e shkrimit të skenarit, duke e pasur për bazë romanin e caktuar, ose, kur producenti i ka dhënë detyrë skenaristit të përshtatë një vepër letrare, sipas së cilës duan të bëjnë film. Në këto çaste halli më i madh i skenaristit është si të sillet me veprën letrare: t'i qëndrojnë besnik apo ta shpërfillë romanin, duke i dhënë krahas imagjinatës së tij? Skajshmëritë janë të rrezikshme. Maturia e kujdesi janë fanar udhëzues që ndihmojnë shumë. Prandaj përpunimi të gjeni mesin. Që nga çasti kur e lexoni romanin për ta adaptuar e deri në finalen kur e keni përfunduar procesin e adaptimit, ju do të ecni nëpër një rrugë të gjatë, plot të papritura e vështirësi. Të papriturat duhet t'i kaloni, nëse i keni vënë detyrë vetes të keni sukses. Mëdyshja e pasiguria do t'ju ndjekin gjatë gjithë kohës, por ju duhet t'i përballoni, t'i mundni, sepse gjatë çdo procesi të krijimit a rikrijimit, sikurse është skenari i adaptuar, ka mëdyshje e pasiguri.

Teoritë e adaptimit janë të ndryshme. Pa u përqendruar hëpër hë të skeptikët, që mendojnë se letërsia nuk mund të përthetohet në film dhe se filmi duhet të jetë i pastër, e i pandikuar nga letërsia e teatri, ne po përmendim ato teori sipas të cilave letërsia është e pashmangshme në kinematografi.

Sipas grupit të parë duhet t'i qëndrojmë besnik romanit të adaptuar, meqë sipas tyre besnikëria garanton sukses, qoftë atëherë kur romani tashmë ka bërë jetën e vet publike (është i popullarizuar), qoftë atëherë kur romani ende nuk ka bërë jetë publike, por ka situata të gjetura me mjeshtëri, karaktere të skalitura për mrekulli dhe ka rrëfim të mirë. Por vetëm këto dy segmente nuk mjaftojnë për t'i qëndruar besnik romanit, ashtu sikurse duhet të jemi të kujdesshëm atëherë kur i shmangemi romanit, duke e ritreguar me mjetet tona shprehëse dhe me mënyrën tonë, sepse edhe për këto shmangie duhet të dimë arsyet. Nuk mjafton arsyeimi i shpeshtë se adaptuesi ka liri të pakufishme shprehëse, se është i pavarur të bëjë ç'të dojë me romanin, sepse ai mund të ketë liri edhe më të madhe shprehëse nëse e bën skenarin origjinal, pa e kërkuar frymëzimin në roman, tregim, novelë apo tekst drame dhe pa i dhënë llogari askujt pse e bëri në këtë mënyrë e jo në një mënyrë tjetër. Atëherë do të varet vetëm nga imagjinata dhe kreacioni i tij.

Në këtë punë të vështirë e me plot të papritura, disa nga autorët e romaneve janë të kënaqur me veprat e tyre të adaptuara, të tjerët janë po aq të dëshpëruar, ndërsa të tretët që të mos e shprehin haptas pakënaqësinë e tyre shpesh deklarojnë: filmi është ndryshe. Ata nuk pranojnë se kjo është vepra e tyre, por nuk duan të acarojnë më shumë raportet me producentin a skenaristin. Megjithatë mbeten të thartuar me atë që shohin nga vepra e tyre në ekranin e kinemasë. Prandaj, adaptimi është punë me përgjegjësi.

Por para se të flasim për adaptimin, duhet të dimë ç'është adaptimi.

Adaptimi është bartje, transformim, distilim, përkthim, transponim nga një medium në mediumin tjetër, përkatësisht përshtatje nga romani e drama në film. Teoritë për adaptimin e skenarit merren me shqyrtimin e qasjeve të ndryshme, analizojnë mundësitë e teknikave të përshtatjes së një teksti letrar (tregim, novelë, roman), apo të shkrimeve të gazetave (reportazhe, analiza sociale, lajm i zgjeruar, fejtone) në film.

Adaptimi i skenarit është faza e parë më e rëndësishme e bartjes së një teksti nga një medium në një medium tjetër, përkatësisht nga një art në artin tjetër. Nga mjeshtëria e bartjes, aftësia e transformimit dhe nga kreativiteti i skenaristit varet se si do

Te filmi i Kujtim Çashkut "Të paftuarit" (1985), skenarin e të cilit e shkroi Ismail Kadare, autori i romanit "Prilli i thyer", koha, hapësira e personazhet nuk ndryshojnë. Filmi i përmbahet kryekëput romanit me disa zhvendosje strukturale apo ndonjë personazh që nuk e ka romani, ndërsa është shtuar në film. Te filmi brazilian "Prapa diellit" ("Behind the sun"), apo (Abril Despedaçado) (2001) të regjisorit Ualter Sales (Walter Salles), po ashtu sipas romanit të Kadaresë "Prilli i thyer" koha, hapësira dhe karakteret ndryshojnë.

SI TË SHKRUASH SKENAR ORIGINAL OSE TË FRYMËZUAR NGA ROMANI, DRAMA E KRONIKA SOCIALE E GAZETËS

Nga Gani Mehmetaj

të funksionojë ky skenar, sa do t'i ofrojë mundësi regjisorit dhe se si do të duket në film.

Për shkallën e përshtatjes së skenarit ka qasje e teori të ndryshme. Disa janë të mendimit se s'ka roman apo dramë që s'mund të bartet në film, të tjerët mendojnë se kjo nuk është bartje, adaptim, por është një lloj tradhtie që i bëhet letërsisë! Sepse bartje (siç e vënë në pah kundërshtarët e

adaptimit) nuk është e mundur të bëhet në atë masë sa të ruhet integriteti i tekstit të bartur.

Sergej Ajzenshtajni (Sergei Eisenstein), gjeniu i kinematografisë, njëri ndër regjisorët që i dha shumë filmit, ishte i mendimit se edhe "Kapitali" i Marksit mund të bëhet film, madje këtë mendonte ta bënte personalisht. Thuhet se pati bisedime edhe me autorin e romanit "Uliksi",



Xhejms Xhojs, që ta ekranizonte romanin e tij[1]. Të tjerët mendojnë se shndërrimi i këtyllë është i pamundur. Sipas tyre nuk është e mundur shndërrimi nga një medium në tjetrin, por është fjala për një proces të ri, madje për një vepër të re. Prandaj ata e mbrojnë teorinë se për filmin duhet të bëhet skenari origjinal që nuk frymëzohet nga letërsia a mediumet e tjera, por kryekëput frymëzimin e ka në imagjinatën e autorit të skenarit a regjisorit. Madje shumë prej tyre mendojnë se letërsia e mediave e tjera nuk duhet të barten në ekran të madh, sepse vetëm mund të deformohen.


Pavarësisht mëdyshjeve të vazhdueshme të kritikëve të adaptimit për film, pavarësisht kundërshtimit që letërsia të ushtrojë ndikimin e vet në film përmes adaptimit, në historinë e filmit shumë nga romanet e njohur janë bartur, pra janë adaptuar në film, disa janë adaptuar më shumë se dy-tri herë, ndërsa më vonë ky proces u bë diçka e zakonshme. Ndonjëherë gati gjysma e filmave të prodhimtarisë kombëtare ishte adaptim, përshtatje e romanit, tregimit, novelës e tekstit të dramës. "Historia e letërsisë ka regjistruar shembuj të panumërt të përshtatjeve të veprave klasike dhe të krijimit të kryeveprave nëpërmjet përshtatjeve"[2].

Ndërkaq, kur është çështja te bartja nga letërsia në film shumë nga teorikët e filmit e skenaristët mendojnë: "Kultura në përgjithësi dhe letërsia në veçanti s'kanë ç'humbin nga aventura e përshtatjes [3]. Përkundrazi. Bazen mendon se letërsia mund të fitojë.

Nëse përshtatja është e suksesshme, statistikisht kanë dëshmuar se edhe tirazhi i librave të shitur është më i madh. Ndërkaq, po dështoi filmi i bërë sipas romanit, këtë gjë do ta marrin vesh vetëm një numër i vogël i lexuesve, të cilët e kanë lexuar romanin. "Dihet fare mirë se letërsia dhe romani janë elitare, ndërsa filmi u dedikohet numrit shumë më të madh të shikuesve [4]. Pra, në këtë rast përfiton edhe letërsia, e cila popullarizohet, sepse shikuesi cilet ta lexojë romanin, tregimin a dramën, por përfiton edhe kinematografia, sepse merr subjekte të gatshme, ka në dispozicion karaktere të formuara, nuk e çan kokën të krijojë situata as të shpikë veprime[5]. Mbi tekstin që e merr për ta adaptuar ai mund të veprojë pastaj duke shtuar apo hequr, duke e plotësuar apo ndryshuar. Por edhe për këto veprime janë disa rregulla, ka procedura, ndiqet përvoja nga e kaluara dhe adaptimet në mediat e tjera, ashtu sikurse duhet të përfillet mënyra se si do të bëhet adaptimi.

Mënyra e adaptimit

Mënyra e adaptimit kërkon njohje të caktuara teorike, mësim të rregullave të adaptimit, sikurse kërkon të shikojmë filmat e të lexojmë sa më shumë romane. Janë një lloj i romanit dhe i tregimit të për-




shtatshëm për adaptim, apo sikurse thonë disa njohës të letërsisë e kinematografisë të gatshëm për film. Ndër shkrimtarët e preferuar thuhet se Çarls Dikens është shkrimtari më i përshtatshëm për adaptim në film, prandaj është njëri ndër autorët veprat e të cilit më së shumti janë bartur në ekranin e kinemasë. Ndërkaq Shekspiri, megjithëse nuk mund të thuhet se është shumë vizual, dramati e tij prapëseprapë janë më të adaptuarat në film. Por kjo nuk do të thotë se ne duhet të kërkojmë tekstet letrare të përshtatshme për adaptim. Ne duhet të kërkojmë subjektet interesante, personazhe të skalitura me mjeshtëri, ngjarjet dinamike dhe porositë e dukur, krahas vlerave artistike të dëshmuara. Asgjë që na hyn në punë nuk duhet të shpërfilllet. Duhet të kërkojmë edhe romane të tjera, të cilat mund t'i adaptojmë, ndërsa nuk e kanë atë lehtësi rrëfimi, apo atmosferën e gatshme për përshtatje, mirëpo brenda teksteve të tyre mund të gjejmë atë që është e përshtatshme për shikues, pavarësisht se i mungon aftësia e komunikimit. Sidomos duhet të bëhen krahasimet e romaneve të shkrimtarëve të mëdhenj, të cilët janë adaptuar, duke i shikuar filmat dhe duke i krahasuar me "rimejk" (filmat e njëjtë që janë ekranizuar më herët), ne do ta kapim fillin e fshehtësisë. Kjo mënyrë ndihmon, sepse mundëson që përmes përvojës së adaptimeve të bëra nga skenaristë të njohur, apo shkrimtarëve të cilët ishin njëkohësisht edhe skenaristë të filmave të tyre, të bëjmë përçapjet tona.

Edhe në këtë aspekt ka përvoja të ndryshme. Do ta bëni adaptimin e romanit duke i qëndruar besnik kohës, hapësirës, ngjyrave mjedisore, personazheve e frymës së romanit, apo romani mund të të shërbejë vetëm si shtytës, si kornizë, ndërsa të tjerat janë pjellë e imagjinatës suaj. Motivet e veprës së frymëzuar mund të të shërbejnë si pikënisje, të tjerat pastaj i shtroni sipas kërkesave të tjera.

Koha, hapësira dhe karakteret janë të njëjta te filmi "Dashuria në kohën e kolërës" (2007), sipas romanit të Gabriel Garcia Marquezit, nën regji të Mike Newel. Është vetëm çështja e shkurtimeve, e dendësisë së ngjarjeve ajo që e dinamizon. Madje edhe fillimi është i njëjtë si në roman ashtu edhe në film. Këto tri elemente nuk ndryshojnë as te filmi tjetër "Festa e çjapit" (Fiesta del chivo) (2005) të shkrimtarit tjetër latin-amerikan, Mario Vargas Llosa, sipas skenarit e regjisë së Luis Llosas, me Isabel Roselinin në rolin kryesor, ku përmes kryepersonazhës rrëfëhet në mënyrë kronologjike shumë vjet pas për diktaturën dhe diktatorin në një shtet të Amerikës Latine.

Ndërkaq te filmi i Kujtim Çashkut "Të paftuarit" (1985), skenarin e të cilit e shkroi Ismail Kadare, autori i romanit "Prilli i thyer", koha, hapësira e personazhet nuk ndryshojnë. Filmi i përmbahet kryekëput romanit me disa zhvendosje strukturale apo ndonjë personazh që nuk e ka romani, ndërsa është shtuar në film. Te filmi brazilian "Prapa diellit" ("Behind the sun"), apo (Abril Despedaçado) (2001) të regjisorit Ualtes Sales (Walter Salles), po ashtu sipas romanit të Kadaresë "Prilli i thyer" koha, hapësira dhe karakteret ndryshojnë. Skenaristi dhe regjisor morën vetëm disa motive nga "Prilli i thyer", ndërsa të tjerat i përpunuan, i hoqën apo i shtuan, duke iu përmbajtur parimit të Riçard Krevolin-it, i cili thotë se gjatë adaptimit të skenarit mund të ndryshosh kohën, hapësirën gjeografike, personazhet e ngjyrat e tjera mjedisore[6]. Filmi "Prapa diellit" është më afër filmit italian "Padre Padrone" të vëllezërve Taviani sesa tekstit të frymëzuar.

Pra, nuk është e thënë që filmi t'i përmbahet romanit, as të bëjë bartjen besnike të tij në ekran, sepse atëherë do të bëhej adaptimi-leximi i romanit në film. Ndërsa



leximi besnik i romanit nuk është qëllim i asnjë regjisorit.

Adaptimi për film nënkupton përshtatjen, adaptimin, kthimin nga një formë në një formë tjetër, përkatësisht nga rrëfimi a lajmi i gazetës, i tregimit, i novelës e romanit, në skenar filmi. Adaptim për film është bartja e romanit, e tregimit e të for-

mave të tjera letrare në ekran të madh, duke iu përmbajtur rregullave dhe, njëkohësisht, duke krijuar rregulla të reja. Gjatë adaptimit duhet të përfillen rregullat e skenarit, teknikat e bartjes, mënyra se si do të përshtatet tregimi a romani në film.

Janë dy mënyra themelore të përshtatjes: adaptimi i tregimit, i novelës dhe

i romanit, duke iu përmbajtur në masë të madhe romanit të cilin e adapton, ose adaptim duke krijuar veprë të re, sipas motiveve të romanit bazë. E para është kur vepra letrare ka ushtruar ndikim të madh në autorin e skenarit, përkatësisht të atij që është duke e përshtatur romanin për film, me të gjitha karakteret, situatat e veprimet që i merr në pikëvrojtim. Kjo nuk do të thotë se pavarësisht ndikimit të madh që ushtron romani mbi autorin e skenarit, ai duhet të bëjë shfletim të romanit faqe për faqe, apo kaptinë për kaptinë. Me shfletimin do të bëhej filmi i mërzitshëm, i gjatë e i ngadalshëm. Në këtë mënyrë nuk do t'i bënte shërbim të mirë as romanit. Dihet se filmi e ka kohëzgjatjen, e ka ritmin e rrëfimit, e ka dramën e brendshme dhe disa rregulla të tjera të veçanta, të cilat ndryshojnë nga romani apo nga tregimi e novela.

Mënyra tjetër, mënyra e adaptimit të tregimit, të novelës apo të romanit është përshtatje, frymëzim, sipas motiveve. Edhe në këtë plan mund të ketë shmangie të mëdha apo të vogla nga romani. Jo rrallë ndodh që skenaristët të cilët e bëjnë adaptimin e romanit bëjnë shmangie nga koha kur e rrëfejnë, që ndryshon dukshëm nga ajo që e ka romani.

Adaptimi është i njohur nga lashtësia. Dramaturgë antikë kanë adaptuar mitet e legjendat e ndryshme. Homeri është mbështetur në legjendat për Luftën e Trojës kur e ka shkruar kryeveprën "Il-iada". Dramaturgët romakë po ashtu në mbështetje të legjendave janë frymëzuar për dramën e tyre, ashtu sikurse edhe Shekspiri, duke bërë adaptimet e rrëfimeve, legjendave dhe ndodhive të ndryshme të mesjetës së hershme, ka shkruar dramën më të realizuar për teatër dhe për film. Edhe filmi ka vazhduar gjurmëve të traditës së arteve pararendëse, por në teknikën tjetër, në teknikën e shiritit të celuloidit. Nga legjendat e lashta, nga literatura antike greke, romake e hebraike janë bërë dhjetëra, të mos themi qindra filma. Mbi bazë të dramave antike e mbi veprën e Homerit, pastaj dramën që i ka shkruar Shekspiri, dramën kalorësiake të mesjetës e deri në ditët tona.

Mirëpo për të bërë adaptimin e suksesshëm duhet të njihet natyra specifike e adaptimit, nga romani deri te format më të lehta dhe më të përshtatshme të adaptimit- shkrimet e gazetave, të cilat pavarësisht faktit që në pamje të parë duken të lehta, kërkojnë përkushtim serioz sikurse gjinitë më të vështira. Tekstet e shkrimeve në gazeta, kronikat sociale a reportazhet janë më jetësore, më dinamike dhe më të kapshme, por ato njëkohësisht kërkojnë përpunim shumë më të përkushtuar.

Fragment nga libri "Adaptim filmi - si të shkruash skenar original ose të frymëzuar nga romani, drama e kronika sociale e gazetës" që këto ditë del nga shtypi.

[1] D. A. Cook: A history of narrative film 1999, 1996, W. W. Norton & Company, Inc, faqe 254-256.

[2] Balazh, Bela, Filmkultura, faqe 269, përkthyer nga Kristaq Dhama, Albin, Tiranë, 2008.

[3] Andre Bazën, Ç'është kinemaja, përkthyer nga Elvis Hoxha, Zenit Editions, Tiranë, 2012, faqe 98.

[4] Po aty.

[5] Pas suksesit që pati filmi "Apokalipsi tash", nën regji të Frensis Ford Kopoles e "Daullja e llamarintë" i Folker Shlendorfit, redaksia e botimeve të "Rilindjes" në Prishtinë, përktheu romanin e Xhozef Konradit "Zemra e errësirës" dhe të Gynter Grasis "Daullja e llamarintë".

[6] Richard Krevolin: How to adapt anything into a Screenplay, USA, John Wiley & sons, inc.

Filmi brazilian sipas romanit "Prilli i thyer"



Emrin e Pëllumb Kullës e hasa më së pari në rrëfimet pasionale të mikut dhe shokut të tij, sa dhe timit, regjisorit të estradës së Sarandës, Thoma Milajt, kur të dy u jepnin krahë ëndrrave të tyre në Shkollën e Lartë për Aktorë "Aleksandër Moisiu". Kur në vitin 1968 unë punova një vit në këtë estradë, në skeçet që Thoma ia jepte të interpretonim shihja rëndom emrin e Pëllumbit. Dhe kur fitova dije, kur ia nisa kritikës dhe mbarova vetë po atë shkollë, ai m'u bë edhe më i dashur. E hasja në disa përkthime që ai kishte bërë nga letërsia ruse dhe italiane për bibliotekën e Institutit të Arteve. Dhe ja, ashtu, Pëllumbi hyri në vetëdijen dhe njohjen time në disa përmasa, të cilat i ndoqi si eremiti strofkën e vet të përsiatjes dhe vetmisë, aty, në tavolinën e tij të punës, në kërkim të së vërtetës, të kohës, të bukurive si dhe shformimeve të njeriut. E njoha, pra, si regjisor, si shkrimtar humorist, si dramaturg, si përkthyes, si publicist. Strofka e ngrohtë e tij u bënë të pesë këto, le t'i quaj "siudhësia", të cilat lidheshin habitshëm njera me tjetrën, falë një ujane estetike tërësore - shpirti, fjala, mendimi, krijimi, gjesti teatror - dhe krijonin së toku një hapësirë të vetën. Ky asket i librit kishte një Zot lart, le ta quajmë Talent, nga vinte frymëzimi dhe një Zot poshtë, le ta quajmë Vullnet, nga ku njeriu i ulur orë pa fund në tavolinën e punës derdhte mendje dhe shpirt mbi letër. Dhe në tërë këtë jetë, kur vitet e mbrame peshojnë fort mbi supë, ai donte t'i vinte një kapak kolanës së tij me 7 vëllime, ku është përfshirë krijimtaria e tij e zgjedhur, me titullin *Teatri, kjo lojë magjepsëse!*

E mua, një murg i teatrit, më duhet të flasë, pra, për këtë "eremit" të artit...

Diku në një nga shkrimet e tij në këtë vëllim të fundit të kolanës Pëllumbi e "leqendis" emrin e vet, i cili po ikën nga kujtesa e studentëve të arteve, të cilët nuk kanë dëgjuar gjë për të se cili ka qenë e ç'ka bërë! Vërtet ka studente vanitoze, që e kanë mendjen vetë të lyejnë flokë e thonj, s'kanë se si ta njohin Pëllumb Kullën. Sepse atë, në fakt, e njeh gjithë një komb. Ai s'ka faj se një brez injorantësh e vanitozësh të sotëm brehin e mbushin sot rrugët e *Boshtit*. S'ka faj pse u dha trajtë mijëra krijesave të shpikura nga mendja e tij si në një pllenim social e mirëfilli shqiptar, s'ka faj pse ishte si ai Demiurgu në mugëtirën e largët të përrallës së krijimit të gjithësisë, i cili u kish fryrë qenieve të veta e u pat dhënë shpirt. Po, shkrimtari është një Zot i vogël në tokë. Pëllumb Kulla ka krijuar në gjithë opusin e vet letrare me komedi, drama, skeçe, dialogë e monologë humoristikë, essé, libra e gjer monografi, një botë mirëfilli të TIJËN, e cila është njëherazi edhe një botë e madhe, mirëfilli SHQIPTARE.

Emri i Pëllumb Kullës është i lidhur më së pari me estradën e Fierit. Ai sikur e krijoi vetë atë, e lindi nga shpirti i tij, i dha frymë si Zoti krijesës më të dashur e më të përkryer: NJERIUT. Kam bindjen se kujtesa kulturore e popullit nuk ka për ta lëshuar kollaj emrin e Pëllumb Kullës nga skedarët e vet. Ai u bë një *Fenomen*. Një fenomen i humorit shqiptar. Më i "rëndë" dhe më identitar para vitit 1990, por edhe pas këtij viti, tanimë më i shpenguar falë ajrit të lirisë, që e mbushte me frymë. Po njësoj mbeti ai, njeriu që e ka humorin burim të vetvetes, fshikull, ironi, përqeshje, sarkazëm, një humor jo prej satiri dionisian mjekër-e-këmbë cchap, por prej thumbi që hidhëron, prej zjarri që djeg, prej harëje që shëndosh e shëron, sa dhe prej një poetike dhe mirësie që përtërin e këndell. Pse? Sepse ai i gërsheton aq bukur të gjithë kategoritë estetike të humorit, satirën dhe ironinë, groteskun dhe absurdin, burleskun dhe humorin e "lehtë", lojën dhe argëtimin, keqkuptimet dhe kundërshtitë e llojllojshme, karakterin dhe situatën komike. Dhe mbi të gjitha: mesazhin dhe emocionin pozitiv. Nuk është dyfytirësh, siç ngjau me shumë sharlatanë e meskinë të kohës së re, edhe pse pesha e kryqit Pëllumbit i pat rënë dikur mbi shpinë, por mbeti po i njëjti siç ka qenë, njeri me karakter, andaj dhe i respektueshëm. Me karakter si artist e shkrimtar, me karakter si pedagog e intelektual, me karakter si diplomat, publicist e nëpunës shteti. Por le të kthehemi në strehëzën e tij, humorin, ku të gjithë duam të jemi nga pak të pranishëm!...

E kush e pa dhe nuk qeshi me "Po martojmë Malon", e kthyer në hitin e humorit të viteve '70 e më tutje?! Po me "Lipe Shtogun në listë", që ditëziut Lipe u pre në grykë llafi kritik, kur mori vesh se dhe ai ishte në listë dhe jo pas liste, për të ngrënë e për të pirë, si sedërli e qylaxhi që ish. Po me mungesën e artikujve të imët, ku në vend të pjatave, gotave e filxhanëve të serviroshin tepsi, tenxhere e kusi? Po këngën nga sikleti, te skeçi "Rrufe nga mali", të atij ballistit që ia kishin rrasur revolen në brinjë dhe... këndonte

Kolana me 7 vëllime "Teatri, kjo lojë magjepsëse!"

PËLLUMB KULLA – "KULLË" E LARTË E HUMORIT SHQIPTAR

Nga Josif Papagjoni

a s'këndonte i gjeri?! Po "Farat e shalqinit" që e çanë fshatin dhe e bënë kashtë e koqe, sepse i futën njerëzit në hullitë e luftës së klasave a kinse meritave dhe plasi sherri, zilia?! Ja dhe katundari që i vodhën lopën ("Po ai që e vodhi lopën?!"), që e shqepën duke e sharë se ku e kishte mendjen, ndërsa atë që e vodhi askush nuk e shante. Po te komedia "Kanani kërkon sy", kur njeriu i varfër është gati të heq dhe syrin e ballit dhe t'ia shesë një banditi, ca se e shpëton familjen nga fukarallëku, ca edhe nga frika? E kush nga ne, prindërit, nuk kemi qeshur me të madhe dhe s'e kemi parë veten te skeçi "Leksione për ushqimin e vogëlushë", teksa për një lugë ushqim në gojën e fëmijëve tanë kemi sajuar llo-lloj budallallëqesh, jemi bërë arinj e ujër, jemi bërë zogj e lepuj, një hare plot ende kjo, e shkujdesur, që s'lë vrag... Dhe shembujt nuk mbarojnë, se e begatë është vërtet krijimtaria e shkrimtarit tonë.

Pëllumbit fati nuk ia dha të gjitha. Në të ri të tij fati iu ngrit si një mal pengese, por ai e tërhoqi zvarrë fatin, e bëri me vete. Nuk e kam fjalën për Zotin efemer të Qiellit, por për Zotin e tokës, në një Shqipëri që vuante paranojat e Enver Hoxhës dhe dasitë e nxitura nga Lufta e Klasave, e ngritur në sistem. E cili shpirt, i cili artist, nuk fyhet e nuk shqyhet. Por Pëllumb Kulla e gëlltiti fyerjen dhe bëri atë që metafora e hershme e njerëzimit e ka bartur bukur mijëvjeçarëve: nga hiret e zjarrit, shpupuriti krahët dhe u ringrit në fluturim, si zogu Fenix. Aty, në Teatrin e Fierit, ai punoi afro 18 vjet, aktor e regjisor. Sot jeton në Amerikë, por nuk rri dot përherë atyre dhërave, arti e thërret vazhdimisht në dhëun e tij, sidomos në qytetin që i dha emër e ymër, në Fier. Shkon e vjen. Rigjen Itakën e munguar.

Krijimtaria më cilësore që vjen te kjo kolana 7 vëllimshme në fushën e dramës, humorit dhe letërsisë skenike lidhet, më së pari, me teatrin dhe estradën e Fierit e më pas ecejaket gjithandë skenave shqiptare. Në repertorin e

tij, si dhe të kanaleve televizive, u jetësuan një sërë dramash e komedish të tij si: "Shoku Niqifor", "Dy krisma në Paris", "Kështu të dua", "Çobo Rrapushi me shokë", "Kërcuri", "Milioneri", "Dikush duhet të vdesë", "Shtëpia me të djeshme pa fund", dhe sidomos komeditë e shkurtra. Qysh para vitit 1990 ai ka botuar pesë vëllime me skica, komedi një aktshe dhe tregime liriko-humoristike, nën titujt "Lipe Shtogu në listë" (1979), "Shoku Niqifor" (1981), "Portrete pa makiazh" (1983), "Po martojmë Malon" (1984), "Këshilla për fëmijët e moshave nga 5 deri 55 vjeç" (1988), të cilat u kthyen në një "depozitë" për repertorin e estradave tona dhe të qindra grupeve amatore kudo në Shqipëri, nëpër fshatra alpinë të veriut e në ata fushorë, për shkolla, ndërmarrje e reparte ushtarake. Ishte një mushkëri e madhe që buiste gaz e frymonte harë.

Në vitin 1997 ai shkroi monografinë me natyrë eseistike kushtuar aktorit Skënder Sallaku, *Si qeshnim nën diktaturë*. Në një mbrëmje gazmore të organizuar nga Shtëpia Botuese "Eric" për një përvjetor të Sallakut, pos që ai na shkriu gazit e na lumturoi me barseletat e tij të panumurta, në fund aktori më dhuroi edhe librin e Pëllumbit kushtuar atij. Kur e lexova, ri-qesha me shpirt, por kësaj here të qeshurat m'i ndillte pena dhe hijeshitë letrare të Pëllumbit, i cili përmes humorit të "ndaluar" të Skënderit nëpër mjediset e epërme të pushtetit, gjer te Mehmet Shehu, Kadri Hazbiu, madje edhe Enver Hoxha, mendjemprehtësia e aktorit i tejkalonte shpotitë e lolove shekspirianë në oborret mbretërore. Sepse ishin tejet të hidhura sa dhe të guximshme, si prej kokëkrisurish, ndryshe të quajtura "humor i zi". Ishte humor, që pasi qeshje, një tmerr e griminë e zezë të hapet përpara këmbëve të tua. Por po aq i zgjuar, ama! Habitesha se si Skënder Sallaku kishte mundësi (gjente guximim ?) t'i thoshte haptazi ato anekdota të "zeza", të një kohe të zezë! Por, ja që hë! Vetëm njerëz si ai mund ta bënin këtë gjë. Prandaj dhe libri i Pëllumb



Kullës për artistin tonë lexohet plot ëndje sot e mot, sepse nuk është thjesht një monografi, por përtej saj. Një shenjë e kohës.

Me të drejtë Pëllumb Kulla thotë një të vërtetë, kur pohon se letërsia e realizmit socialist ishte një shkretim pa fund, me lavdërime pa fund, gënjeshtra pa fund, ndërsa humor, ndryshe nga letërsia epike (dithirambike?) e lirike e kohës, do-sdo, duhej të godiste deformimet, zvetënimin e njeriut dhe burokracinë e sitemit, të keqen. Dhe herë me guxim e herë në pajtim me aq sa lejohej, ai e kreu këtë mision. Doemos jo plotësisht e në rrënjë, por, ama, krijoi një katarsis të munguar për kohën. Stoqe librash të asaj letërsie sot kanë vdekur, i ha krimbi i harresës, ndërsa pjesë të ndritshme të humorit, si ato të Pëllumb Kullës, Qamil Buxhelit, Miço Kallamatës na japin ende gëzim e na mbushin ende me harë. Pa dyshim, Pëllumbi ishte nga shkrimtarët më të mirë, në mos më i miri, sidomos në gjinitë e shkurtra dramatike si komeditë me një akt, skeçet, paroditë, që ndihmonin në realizimin e këtij katarsisi social...

Kam pasur rastin që shumë nga skeçet, dialogët dhe monologët e përmbledhjes disa vëllimshme të Pëllumb Kullës *TEATRI, KJO LOJË MAGJEPSËSE*, në vitin 2007, i kam shfrytëzuar si referenca shënjuese në librin tim "TË QESHËSH - Me cilin? Për çfarë? Përse?". Pra, jo vetëm lexuar, por studiuar. Kam vlerësuar se ato kanë qenë nga më domethënëset në të kuptuarit e komikës dhe humorit në letërsinë tonë, kushtuar teatrit të varietesë, të shtrira në gjithë njësitë, shenjimet, kategoritë teorike e estetike, format e shpërfaqjes. Më duhen faqe pa fund t'i komentoj ato 300 skeçe e komedi të shkurtra dalë prej penës së tij, por ja, këtë hop po më vjen në mendje skeçi "Asaf Lala kërkon largimin". Këta mburravecë si Asafi, që ndryshe thonë e ndryshe bëjnë, i sheh gjithandë, dje dhe sot, dhe kur uji u lag prapanicën, hidhen përpjetë, turfullojnë, shtirjet dhe lajle-lulet bien. Mund të them se e njoh në thellësi opusin krijues të Pëllumbit, dhe po e ripohoj fare shkoqur: te ky opus janë të larmishme temat dhe motivet, janë të mëvetëshëm karakteret dhe personazhet, janë domethënëse idetë dhe mesazhet. E gjithë kjo krijimtari e begatë, në disa qindra njësi kësisoj, na shpërfaqet, nga ana tjetër, falë një shumësie situatash humoristike, stilemesh, modelimesh, paradigmash e tipologjish të komikës. Po, Pëllumb Kulla është një mjeshtër i tyre. Humori i buron vetiu, është brenda qenies së tij. Dhe është aq elegant, plot shije e dije, pa tepri e banalitete. Ai solli humorin e kulturuar në skenë, solli hijeshinë e fjalës. Nuk gjen asnjë të sharë në veprat e tij, teksa sot ka një keqkuptim dramatik sa i përket përdorimit të elementit banal në komedi. Pena e tij nuk i qas elementet spekulativë të kich-artit, ca më pak nuk tundohet në asnjë rast nga komedia "skatologjike" (me përdorimin e zhargonit të ndyrësive dhe "haleve"). Kur rrekem ta shoh letërsinë e Pëllumbit nga sipër e të bëhem një Zot i vockël, e para gjë që shquaj janë ngjyrat, larushia: një galeri tipash, gjendjesh, lodrash, rrengjesh, marifetesh, ku derdhet gazmend, ku i jepet fjalës dritë dhe harë. Jetësimi i tyre letrar sa dhe regjisorial (sepse Pëllumbi ishte njëherazi edhe mishëruesi i tyre skenik në skenën e Fierit si dhe estrada të tjera të vendit), dallon për shpërndarjen e ekonomizuar e racionale të vëmendjes sa nga një moment në tjetrin, përputhur theksimeve të mirëstudjuara, duke ndërtuar kësisoj një diagramë dinamike, të kahut rritës e progresiv, me të papritura e befasime të këndshme (p.sh. komedia "Luftë e ngatërruar"), në formë ciklike, me përsëritjen e situatës por në stade edhe më groteske (p.sh. te komeditë "Kush ma futi koburen?", "Rrufe nga mali"), ose si keqkuptim prej një ndodhie të pritshme (p.sh. komedia "Fshatarët dhe Kadriu"). Elementi i zmadhimit, i hiperbolës, i groteskut tek ai rri mirë, është i paqumë, ruan sensin e masës, dhe nuk kërcet. Si shkrimtar të shquar humorist të skenës, kritika e ka vlerësuar për humorin e tij të çlirët, spontan, plot të papritura dhe mprehtësi komike, me kapërcimet e befasishme e të mençura të veprimt komik në situata të këndshme, që të japin gaz



e hare. Ai aplikon forma të larme të strukturës letrare humoristike. Ja, te ky libër, me pak vëmendje, ju do të dalloni gërshetimet e qasjeve komike: sa demaskimin e menjëhershëm të bartësit të cilësisë, apo të dukurisë negative, që bëhet objekt humorit përmes shpërfaqjes së përbashkimit, si për shembull te komeditë "Dikush duhet të vdesë", "Shtëpia me të djeshme pa fund", aq dhe zbulimet e shkallëshkallshme, duke përdorur tashmë përsëritjet rituale dhe riciklimet e të njëjtit veprim, falë një raporti të zhdërvjelltë karakter-situatë komike, si te "Sa shumë gjethë të thata atë vjeshtë!" - komedia e tij fituese e çmimit të parë në Festivalin Kombëtar të Teatrit 1989. Ishte një spektakël i suksesshëm i trupës elbasanase që me regjinë e fisme të Spiro Dunit dhe lëndën letrare të penës së mprehtë të Kullës arritën të thyenin hegjemoninë e Teatrit Popullor të kryeqytetit, dominuesit të vendeve të para në këta lloj festivalesh, qëkur nuk mbahej mend! Pëllumbi është një fije-thurës i mrekullueshëm i karaktereve në marrëdhëniet gjegjëse me gjendjen e krijuar, me mbijetesën, me interesin, në një kabinet ministror ku ishin si ai i Ismet Verrizit.

Komedia "Shtëpia me të djeshmen pa fund", ma solli Pëllumbin në një stil elegant e një mendjempërthësi të thukët. Ti sheh Shqipërinë e fillim viteve '90, e futur si në një epruvetë ku gëlojnë të gjitha, e shkuara dhe e tashmja, mjediset dhe zyrat tipike të politikës shqiptare, e cila e sheh të ardhmen të kërcënuar sa nga e shkuara, aq dhe nga e tashmja. "Nuk bëra mik dot veçse shoferin tim, - thotë heroi kryesor. - Kurse një nëpunësi të ndershëm ish komunist, nuk ia nxora dot frikën e vjetër nga hierarkitë. Dhe më tej, një njeri me vlera, por që pat rënë dikur në burg, nuk arrita ta çliroj, me gjithë çlirimim që e sheh me tepri nga të katër anët."

Kjo komedi më ka lënë një shije të mirë, të një letërsie sqimatore. Sikur lëviz në ajri një shpirt i bukur, i dëlirë, fluturak sa dhe dinjitoz, ashtu sikurse do të donim të gjithë ne që të ishte një zyrtar i shtetit. Kam ndërje se si shpirti i autorit dhe shpirti i personazhit janë bërë të njënjshëm. Nëse e njeh personalisht Pëllumbin, s'do shumë mund ta identifikosh këtë çka po them. Te ky vëllim është dhe komedia "Ujku i përrallës". Një komedi lirike kjo, që ka një shtrim të thjeshtë, si pa u dukur, ku befasi, në fund, vjen dhe mirësia e njeriut, e Zamirit, i anatemuar nga shoqëria e ngurtë e kohës si rrugaç, por që në fakt ka një shpirt të dëlirë e që çmon të bukurën.

Nuk e mbyll dot këtë shkrim edhe pa dytri gjëra të thëna shpejt. Nga optika estetike e kuptimit të komikës nuk lë dot mënjandë disa elementë identifikues të pena e Pëllumb Kullës: raportet kontrapunktuale midis a) shkakut "dramatik", që lexues/shikuesi e kupton se ku buis, b) pasojës komike, e cila shpërfaqet herë bujshëm e herë si eshka që diget ngadalë e djeg fort, c) midis mundësive reale dhe pretendimeve fiktive, d) midis aftësisë dhe paaftësisë, e) midis të përkryerës dhe të cunguarës, f) midis hijeshisë fizike dhe gjymtimit etj. Këto kundërshtitë komike i gjen për bukuri edhe në skenarët e kinokomedive "Tela për violin" dhe "Stola në park". Paradoxet dhe të papriturat i sheh kudo, sa te përthyrjet surreale aq dhe te asociacionet e largëta. Pëllumbi ka shkruar 14 vepra për skenën, 9 prej tyre janë komedi dhe pesë të tjerat, drama. Bëri bujë me dramën dhe shfaqjen "Dy krisma në Paris" (në bashkautorësi me Sheri Mitën), kushtuar aktit heroik të Avni Rustemit në vrasjen e tradhtarit të kombit Esat Pashë Toptani, ku të rrëmbente fryma epiko-heroike, ligjërimi pasional dhe një tension i madh dramatik në dialog.

Në tavolinën e tij të shkrimtarit gjen botimet e shumta me skica e tregime, romane, artikuj e esë. Faqja e Facebook-ut të tij është një medie e begatë krijimesh, tregimesh, skicash humoristike, ngjarjesh të vërteta e të sajuara, artikuj e qasje sociologjike e politike. Nuk shterr, jo, ky Pëllumbi! Si publicist, ka shkruar një mori artikujsh dhe analizash mbi situatën brenda dhe jashtë vendit, rëndom të këqyrura nga një optikë satirike e shakatore, të botuara më pas në një vëllim 700 faqesh, me titull "Luftë pa Fund". Çdokush që shkruan e di se "shkronjat" nuk hidhen në letër kotsëkoti, por kanë një mision, kanë frymë. Të tilla janë shkrimet e Kullës, shkronjat dhe fjalët e tij.

Pëllumb Kulla, ti je një njeri i bukur, me shpirt të bukur. Një shqiptar FISNIK... Nuk dua që ky shkrim për ty të jetë thjesht një lëvdatë, një "qokë", se në mos hapur, në vetminë tënde do të më lëshosh ndonjë thumb. Ajo çka fle brenda meje si kritik e studiues paqësish, pa iu trembur teprimt, po them se Pëllumb Kulla ka qenë përmbi 50 vjet një nga orfejanët e penës mençur të humorit. Është majë. Po, mirë e thashë, sidomos në artin e humorit skenik është MAJA MË E LARTË!...

Rreth romanit "Vito" të Bashkim Hoxhës ALEGORIA SI PJESË E STRUKTURËS ROMANESKE

Nga Agim Bajrami



Ajo që të bën, të përjetosh njëherësh dy Agjendje të ndryshme në këtë roman të Bashkim Hoxhës, është jo vetëm subjekti intrigues, por edhe autoalegoria e jetës së protagonistëve, të cilën ata nuk ia besojnë askujt tjetër, përveç vetvetes. Edhe përkundër spontanitetit të saj, një veprim i tillë është kaq spontan dhe mjeshtëror, sa narratorit s'i mbetet të bëjë tjetër gjë përveç rolit të regjistruerit. Vëzhgues dhe hulumtues i kujdesshëm gjer në detaje, ai është i vetëdijshëm se duke pasqyruar protagonistët të tillë, është duke pasqyruar njëherësh edhe fragmente të një kohe cinike, kur jetën dhe vdekjen mund ti merrje fare mirë si zëdhënës të njëra tjetrës. Është ky shkak që gjatë shfletimit të jetës së tyre të ndihesh i pushtuar nga i njëjti ajër dhe makth ekzistencialist si ai, që i ka munduar gjatë gjithë kohës edhe jetët e personazheve që je duke lexuar.

Veprimi i heroinës së romanit me të njëjtin emër Vito ka një funksion të dyfishtë (çka është edhe mjeti intrigues i kësaj veprë). Të vajojë jetën e të tjerëve, duke vajtuar njëkohësisht edhe mjerimin e jetës tënde. Në këtë kontekst kjo veprë i ka të gjitha të shkrira në një të vetme, makthin ekzistencialist, rebelimin por mbi të gjitha ironinë dhe sarkazmën, ndaj fajtorëve të veshur me pushtet dhe paprekshmëri, veprime mjaft sinjifikative këto në një shoqëri "ku shpresa ka lindur e vdekur". Në një kuptim më të gjerë "Vito" është një roman kumtës, ku më mbizotëruesi prej tyre është: Ka njerëz për të cilët jeta ka ngjyrë të zezë, ndërsa për individë që bëjnë sikur jetojnë, vdekja mund të ketë edhe ngjyrë të bardhë. Shtatë plaka, katër pleq dhe një vajzë që lexon libra, përbëjnë një simbolikë interesante, ku komikja dhe tragjikja shtynjë pareshur njëra-tjetrën, duke i dhënë narrativës romaneske intensitetin dhe energjinë e nevojshme. Personazhet që lëvizin në të janë të lidhur ngushtë me tyre dhe në një farë mase ata plotësojnë njëri-tjetrin me parimin e enëve komunikuese. Vito dhe Niko, Qanija dhe Roza, Vito përbëjnë një tipologji interesante qoftë me botën e tyre të brendshme, ashtu dhe me veçantitë e tyre karakteriale. Pasuria dhe larmia e dukshme e

frazeologjizmeve dhe shprehjeve gjuhësore të tyre apo sentencat filozofike për përvojat dhe kuptimin e jetës, përveç se mjet identifikimi, janë në një farë mënyre edhe mjet artistike për të shprehur sa më fuqishëm revoltën dhe pakënaqësitë e tyre ndaj shoqërive të mbyllura dhe aspak tolerante, siç ishte shoqëria dhe sistemi diktatorial në vendin tonë. Është ky tipar që i bën më origjinal jo vetëm këta personazhe, por edhe krejt prozën e gjatë të Bashkim Hoxhës, në raport me krijuesit e tjerë bashkëkohorë

Jo më kot gjatë njohjes me historitë e çuditshme të tyre lexuesi model ndihet si i pushtuar nga ideja se: Të gjithë njerëzit jetojmë të njëjtën histori, por të ndryshëm na bëjnë rrethanat dhe mënyra se si lëvizim ata në trajektoret e jetës. Në pasqyrimin e personazhi kaq kompleks siç është Vito, kemi një bashkëveprim të ndërsjellë mes zërit dhe figurës. Nëse në momente të zakonshme zëri plotëson figurën, në momente të tjerë ndodh e kundërta.

Në kohën kur ajo filloi detyrën e saj si vajtojç dhe zuri të qante një të ri, figura nisi të kryente funksionet e saj plotësuese.

"Të gjithë arrinin prej zërit të saj të shikonin sytë, duart, trupin që grisej, dhe ato copëza letre që treteshin në erë."

Që nga faqja e parë dhe gjer tek e fundit, qëllimi parësor i veprës është zbulimi i sekretit të qenies dhe alegoria e fundit të saj. Vito arrin ta realizojë këtë nëpërmjet vajtojçës rivale Qanije. Konkluzionet e saj filozofike rreth individit të pavarur dhe prishjes së ekuilibrit të tij me turmën, janë kaq tragjike dhe tronditëse. Kombinimi i jetëve në lojën e ruletës së madhe edhe pse në pamje të parë, nuk kanë asgjë të përbashkët me njëri-tjetrin, në fund i bashkon fakti se në finale të gjithë duam s'duam ndajmë të njëjtin fat. Esenca e narrativës së këtij autori është ekuilibri mes raporteve të së dukshmes dhe së padukshmes si dhe shumëkuptimshmëria e shprehjeve, që nëse do të përdorja një citim nga John Foss, "Më shumë se informim janë kuptime më vete".

Kjo ndodh ngaqë autori nuk shkel dy apo më shumë herë në të njëjtin shteg, duke ia kursyer kësajsoj lexuesit të tij përshkrimet

e gjata dhe të lodhshme. Me fraza të prera dhe pothuajse telegrafike ai e çon atë, pa e sorollatur shumë në thelbin e rrëfimit.

Dialogjet e personazheve, të pasur, të thellë dhe plot ngjyresa filozofike janë asete të vyera.

P.sh.: "Mos ia bëj shtëpinë kazermë byrazerit tim", (nga biseda e Nikos me Vitën).

Ose "Mua nuk më është tharë ende trëndafil që më solle para ca ditësh. E mbaj në një kavanoz, që ka pasur turshi kastravecësh." Kësaj proze i mjafton një regjistër fjalësh dhe shprehjesh të caktuara frazeologjike, për të pasqyruar më së miri gjendje të caktuara jetësore por më së shumti edhe filozofia të caktuara, për individë dhe rrethana historike. Vetëm në kapitullin e nëntë mund të hasësh një duzinë prej tyre

Ja disa prej tyre: "Serioziteti u takon murgjëve dhe filozofëve. Jeta nuk është festë, festa zgjat një ditë, fishekzjarrët shuhën dhe harrohen", etj. Po kështu edhe përdorimi efikas i alegorisë. Kjo është një armë me të cilën autori depërton gjer në skutat më të thella të personazheve të tij, duke i zhburrëruar dhe bërë qesharakë ata. Një alegori të tillë, Milan Kundera e rreshton në dhjetë tiparet esenciale drejt të cilave duhet të priret romani i sotëm. Jam shumë i bindur se interesi i lexuesit dhe kritikës ndaj romaneve të fundit si "Duartrokitësit", "Kronikat e mjegullës", "Asnjëherë të martën", "Dimri i librave", nuk do të kishte qenë kaq i dukshëm, pa praninë e saj të fuqishme. Nëse në planin moral mjeti alegorik i shkatërron dhe shpërftyron personazhe të caktuar, në planin artistik ai arrin të krijojë me ta modelin estetik të së keqes, çka është edhe një dëshmi e pjekurisë dhe forcës artistike të këtij autori. Si zgjatim të kësaj alegorije mund të merren edhe refleksionet antidiktatorë, të cilët edhe pse zënë një numër të kufizuar faqesh flasin shumë. "Turma e zhurmshme, që përplaste hapat me zhurmë, e përfshiua atë brenda vetes".

Simoni ecte me ritëm tjetër Ata e futën brenda vetes, që Simoni të ecte me ta me një hap. Por Simoni donte të dilte dhe turma e shkeli me çizmet e saj dhe e la të vdekur.

Të njëjtin emocion provon edhe tek momenti i martesës së fantazuar të Nikos me Rozën, të cilën autori e sendërron me pluhurin mitik të baladës së fjalës së dhënë dhe valsit të vdekjes. E prirur nga filozofia se asnjë individ, nuk mund ta ndërtojë individualitetin e tij në kushte depersonalizuese dhe në një "Mos, qe gjëmon," individët e këtij romani mundohen ta zgjidhin në mënyrën e tyre format e mbijetesës. Ata perfeksionojnë artin e komunikimit dhe qëndrësës së heshtur me kundërshtarët dhe të keqen e madhe. Mbyllen brenda kullës së alegorisë, nisin t'i marrin jetët e tyre me shaka, ashtu siç nisin të marrin edhe vdekjen. Nëse do t'i hyjmë thellë-thellë një veprimi të tillë, kemi të bëjmë me një lloj rebelimi të pashpallur ndaj kultit të së keqes, përballë të cilit ishin gjunjzuar shumica. "Ti përgatit vdekjen, i thotë Niko Vitos, ndërsa unë po përgatis dasmën".

Kjo është arsyeja pse midis Nikos dhe Vitos ekziston gjithmonë një urë e padukshme simpatie dhe një kod i heshtur mirëkuptimi. Personazhe të tillë i mundon pengu, se edhe pse në moshë të madhe, akoma nuk kanë mundur ta gjejnë shkakun e ardhjes së tyre në jetë dhe pse-të e shumta të saj.

Me gjithë vramendjet dhe përsiatjet e tyre të shumta ata e ndjejnë se më pak se gjithçka kuptimi i tyre për jetën është dhe mbetet absurd. Ajo çka mbetet për t'u shijuar më pas, s'është gjë tjetër, përveç shijes së athët, që të lë zhgënjimi.



Leksema "album-i-et" në Fjalorë shpjegues L të shqipes, në valencë me shumë fjalë, vjen e krijon sintagma fort të përdorura në të folur e në të shkruar, si: *album fotografish, albume me pulla poste, album me skica pikturash, album me piktura, album me peizazhe, Album i Pavarësisë, Album i Nënë Terezës, Album i Kongresit të Manastirit, Album i vëllezërve Frashëri etj.*; kurse, më gjerë, në fushë të artit: *album me poezi (Noli), album me këngë, album me përralla, album me melodi etj.* Por, të rrimë shtrembët e të flasin drejt, *album i thashethemeve*, nuk kishim dëgjuar; këtu e rreth një shekull më parë, sociologu dhe filozofi Anton Harapi, pat shkruar *thana e thasha* popullore dhe me ngjyrim intelektual, rrëfenja moralizuese... mes së mirës dhe së keqës. Në Shkodër, janë quajtur edhe *përgojime*, një fjalë që ka mbetur aq pak e normës letrare.

Papritur, në Panairin e Librit, që sapo u mbyll, (si përherë) me rekord në numër vizitorësh, sidomos moshash të reja dhe po aq edhe blerësish (kupto: lexuesish), takoj shkrimtarin e ri Stefan Çapaliku, tek hapësira e Entit Botues "Fishta", ku çifti Kulli, me disa vajza studente lëviznin dhe sistemonin autorët e tyre. Sa më shikoi, më mori krahun dhe, pa një pa dy, më bëri shenj se do të ngjiteshim bashkë në katin e dytë dhe ...drejt e në stendën e botimeve të Akademisë së Shkencave të Kosovës, tek Albanologjia, sigurisht. Më pyeti për librin e akademikut Ismajli "*Për historinë e gjuhës shqipe*", e mori në duar dhe shkroi dy fjalë blatimi...jo pa humor! Njëfarë habie ky veprim miqësor dhe i një bashkëpunimi para disa vitesh, kur patëm përgatitur së bashku, për botim, "Letrat e P.Bogdanit". E dija se ka fjalë dhe thonë se Stefani, si të gjithë shkrimtarët, marrin libra, por ja që u dashka besuar se edhe japin, jo për veprat e tyre ku vënë kushtesa *shtampë*, me pak rreshta, ose edhe vetëm firma, por dhurojnë jo rrallë libra me vlerë, siç veproji me mua. Ky nuk është thashethem, si ato të *albumit të tij*...shihni firmën në fund të shkrimit, po nuk e besuat.....!

Kur kemi lexuar çfarë ka shkruar deri më sot S.Çapaliku, bindemi se shkrimtaria e tij në prozë e meriton plotësisht sentencën latine "De novo ad novum" (atribuar ndoshta, filozofit stoik Seneka),¹ një shprehje që, për t'iu larguar termit "novator" të një kohe të njohur me *punëtor novator, brigadë novatore, kolektiv novator*, do të mund të përdorej në kuptimin "nga risia në risi". Dhe kështu ngjet me trilogjinë "Secili çmendet sipas mënyrës së vet", ku autori karakterizon kohën në ndryshim, "Përtej së mirës e së keqës", si shkruante në devizën e tij Nietzsche; kur portretizon inxh. Eqremi a profesor Ashtën, Pietro Marubbin, personazhin kryesor nenin Age, nënën e tij si Helenë Troje, Doktor Mentorin apo axhën Zef. Është rasti të vihet në dukje se vështrimi letrar i autorit, këtu përqëndrohet brenda një shtëpie, në një lagje të një qyteti, por *thashethemi* depërton e rrezaton në mbarë shoqërinë, si një veti jo e njeriut të punës, njeriut të lirë, në daç, edhe jo e njeriut të kapitalizmit... Fundi i fundit, thasha e thana në letërsi, ndeshen prej kohësh, edhe tek autorë të njohur, si te George Orwell, në librin-kronikë me titull "Lavdi Katalonisë", ku rrëfimi mbahet në një linjë nëpërmjet thashethemeve nga dy kampet: Republikanëve dhe Frankistëve.² Autori luftëtar i brigadave republikane, merr e i regjistron ashtu si vijnë në përmbajtje, duke ia lënë lexuesit të mbajë krahun nga e vërteta.

¹ Seneka: *Lucius Annaeus Seneca* (viti IV para Krishtit - LXV, pas Krishtit), ishte një filozof, dramaturg e

politikan roman. Njihet gjithashtu, si Seneka filozof; është rreshtuar mes eksponentëve më të mëdhenj

të stoicizmit eklektik të kohës së perandorisë. Ai ka qenë shumë aktiv në disa fusha të jetës publike, si

senator. Tri vepra moralizuese të Senekës, i ka përkthyer në shqip N.Sotiri, Botimet *Apprimus*, 2015-2016.

² George Orwell, *Lavdi Katalonisë*, Shtëpia e Librit, Tiranë, 2021.

"Albumi i thashethemeve", i Stefan Çapalikut, Botimet "Fishta", 2023

NJË ROMAN NË... PENTAGRAM

Nga Tefë Topalli

Në prozën e gjatë romanore Çapaliku tregohet i kujdesshëm për vendosjen e ngjarjeve e përshkrimeve në një kuadër kohe të ravijëzuar imtësisht. Tablotë kohore, edhe kur ngajjnë se përputhen me njëra - tjetrën, nga vepra në vepër, nuk mbivendosen asnjë herë. Duket se janë vetë personazhet e skalitur saktë e shkurt, që e dëshmojnë atë, siç mund të themi me agronomin Lazër, një specialist i rrallë që ka lënë gjurmë në jetën e tij shkencore dhe në praktikën bujqësore prodhuese, në kohën e planifikimit, por edhe në ditët e sotme, ai është një pikë referimi për prurje të reja varietetesh bimore dhe metodave të kultivimit të tyre. Po ashtu, Zonja e shtëpisë që pret e përcjell vizitorë e shokë e miq, kujtohet në Shkodër si drejtuese aq e përpiktë e një shkolle emërmirë si ajo pedagogjike, vite me radhë. Brenda kësaj kohe, fëmijëria dhe rinia e autorit është e shpërndarë aq bukur në sagën e romanit trevëllimësh me titullin "Secili çmendet sipas..."; po ashtu tek "Engjëlli me frak"; ndryshe në romanin që po paraqesim: ka më shumë fëmijëri dhe rini te fabula e tij dhe gërshetimi i ngjarjeve.

Nuk është e para herë që ky shkrimtar nxit

përjetimet fëminore dhe ato të adoleshencës për të na sjellë vepra letrare si trilogjia *Secili çmendet sipas mënyrës ...së autorit*, apo *Një engjëll me frak*, por kësaj herë, përveç gjenerimit impresionist, gjen një mbështetje dokumentare tepër të pakundërshueshme, siç janë fotot e një albumi; kështu bëhet një lidhje e fortë midis fotografive, thanave e thashave që ndërtojnë *ciceronët* rreth tyre, nisur prej neni Ages (bashkëshortes së mrekullueshme të axhës Zef), pak prej rrethit familjar dhe vetë tregimtarit-fëmijë, i cili, herë sheh e dëgjon të tjerët në ballë të kallëzimeve, herë i plotëson ato, por edhe vjen e del vetë në plan të parë, si *peronazh i gjithëditur*. Dallohet në kallëzimin e autorit, kalimi hera-herës, simbas ritmit të metronomit muzikor, ç'është thanë e thashë e çfarë është reale, një mjet që ruan lidhjen drejtvizore të fabulës e gërshetimit të saj.

Është i njohur në letërsi një proces si ky, *kthim imagjinativ deri në fëmijëri*, siç shprehet S.Hamiti, *si hyrje në një botë të lirë, në një kulm strehimi shpirtëror, ku mbretëron qetësia dhe liria*.³ Parafrazat e teksteve

³ Sabri Hamiti, *Vepra letrare* - 6, Faik Konica, Prishtinë, 2002, f. 94.



letrare (shpjegimeve) që dalin prej fotove, si pasqyrim të tyre, përbëjnë dhe vijën lidhëse të fabulës së romanit më të ri të S. Çapalikut.

Një strukturë shumë origjinale proze, që çuditërisht, ka një lidhje të dukshme, e cila herë shihet qartë si vijimësi, herë edhe fshihet e fragmentarizohet, duke qenë e lidhur me vendin e kohën e zhvillimit të fabulës: me një fmiqe, me një shtëpi, pothuajse me të njëjtë njerëz të moshave të ndryshme, që ndryshon aq pak dhe koha që nuk lëviz përpara: ajo e para vitit 1990...Ka pasur për një periudhë të gjatë, kur *si qendra* bisede e tubimi bëhej një familje brenda një lagjeje qyteti, ku përshkoheshin jo vetëm të afërt gjaku e fisi, por vizitorë të tjerë, të dëshirueshëm si nga pritësit, edhe nga ardhësit. Komponimi i rrëfimit me intermexo, thurur me terma muzikorë ngjet me një kompozim të vërtetë, dhe vjen me përqsasje natyrisht, sepse edhe letërsia është kompozim: me gërshetim ngjarjesh, kolizion dhe antagonizëm, sekuenca interpretuese, kundërvënie dhe ujudi me fabulën. Lexuesi shfleton romanin me sythet e nominuar me terma orkestrale: nga simfonia, da *capo*, me alegrot e llojet e saj, andanten, kreshendon, ad libitum, alegron kapriçiose me forcë dhe energji, skercot dhe kadencën, deri tek kujtimi për *coda funerale* të neni Ages dhe *vizitën* që bën autori (tashmë në moshë të pjekur) në shtëpinë e vjetër të fëmijërisë së tijKa në këtë album *thanashe e thashash* gjithsej tetë, për të cilat, si të mos donte të ndahej prej tyre e të thoshte se ato nuk mbarojnë asnjëherë në qytetin e Shkodrës (jo se në vende të tjera nuk *kultivoheshin*), autori del nga numrat romakë dhe kalon në një rend tjetër, si: *nji shmangie e paparashikueshme nga tema, nji variacion mbi temën, stretta finale* (që shënon fazën konkluzive), *elegjinë* kushtuar njeriut të mirë, inxhinier Eqremit, që nuk u realizua asnjëherë në jetë - si fundi i dashurisë së tij tragjike me polaken Malgorzata Kaczmarek, edhe një herë thashethem in fundor, me emërtimin *triste finale*- një shkurtoje për doktorin dhe bashkëshortën e tij, shoqen Fitore, më vonë, në zhvillim të këtij karakteri, zonjën Vitore, sepse tashmë ajo ishte shndërruar shpirtërisht dhe mendërisht në emrin e fundit. Loja me fonemën e një emri (F/V), apo me kundërvënien Fitore/Vitore, e çon autorin në përcaktime tërheqëse, si: "*Në fakt, po ta shikosh hollë, si Fitore e si Vitore kishin me qenë e njafta gja, por ne këtu në Shkodër, Zoti na ka dënu me qenë bullista të fortë. I madh e i vogël këtu asht bullist. Mos të faltë Zoti nji difekt se nuk mbesim pa e marrë në gojë. Bullizmi këtu ka shpinë e vet.*" (f. 143-144)

Vijon rrëfimi me një diminueto tërheqëse, e cila sikur e bind autorin *në dëshirën për t'iu marrë me letërsi!* Në një shenj leximi të librit, vjen papritur *thashethemi i mbramë* (i fundit), një tjetër e rimerr (me *da capo*), vijon me *kadencën*, për ta mbyllur me *andante*-n e dhimbshme: kujtimin të paharruar të nenit Age, e cila arrin të karakterizohet aq mirë nga autori, sa ajo, megjithëse nuk kishte pasur fatin për të dhënë jetë, ishte një grua që u jepte jetë të gjithëve, kudo ku i shkelte këmba, me kujtesën e saj dhe fjalën e bukur, deri edhe në mbylljen e cadensës, me porosinë "Mos harroni me thirrë një fotograf, me fik sue funeralin ceremonial!". Lexuesi e kupton menjëherë se ky roman i sillet një kohe të vështirë jetese, në mjaft pikëshikime, e para e të gjithave qëndron varfëria, një atribut i padëshirueshëm përgjatë jetës së njeriut, për të cilën edhe filozofët kanë shkruar se *është një fatkeqësi të rroshtë në perandorinë e nevojës, por nuk është e domosdoshme të jetosh nën pushtetin e saj*.⁴ Gjithë skenat e kësaj gjendjeje materiale, vijnë e dalin nga vërejtjet apo shërbimet në tregtoje që i ngarkohen të bëjnë autorit-fëmijë, në kohën e atyre viteve. Është pikërisht ajo periudhë e ngjashme jetese, për të cilën nuk kishte ëndërruar kurrë populli shqiptar, dhe për të cilën Kadareja pat shkruar: "*Megjithatë, nën qiellin si helmetë, / Ëndërrova lule të tjera klime!*"⁵

⁴ Seneka, *Mëso të jetosh* - Letra për Lucilin, Botimet Apprimus, Tiranë, 2016, f. 26.

⁵ Ismail Kadare, *Vepra poetike në një vëllim*, Onufri, Tiranë, 2018, f. 220.

Duke shfletuar Albumin e fotografive, si kronikë dokumentare e jetës së një familjeje, gjenerohen kallëzime thshethemore gjithnduerësh: disa u referohen ngjarjeve të vërteta, disa të tjera janë imagjinore, siç del minitregimi për Lecin (Kolecin), që nis me parashikimin e një fallxhoreje në Itali, dhe *thonë...e thonë, thonë se, thoshin thashethemet, me gjasë se...e ta marrin gjermanët e ta çojnë Lecin si rob në Hamburg dhe...thonë se e ka shpëtue grueja e një oficeri gjerman, sepse ngjasonte me të vëllain e vdekur në luftë...janë ndie fjalë mandej se i paska thanë...!* Por ka edhe rrëfime historike sipas fotove, siç është ajo e ftesës së P.Gjergjit e Koliqit, drejtue Asdrenit dhe Lazgushit, me ardhë në Shkodër për vizitë... një fakt që, kohë më vonë, sipas ndonjë studiuesi të thellë, qenkesh bërë për t'i përfshirë të dy poetët toskë në ideologjinë fashiste, kur shkodranët e mësipërm po përgatisnin pushtimin e vendit nga Italia fashiste...! Ka biseda thanash e themesh, ku dalin përpjekjet e rrfimtarëve për t'i afruar me të vërtetën, si ajo për zhdukjen e dajës Luigj, për të cilin kërkohet mbështetje tek dëgjuesit, nëpërmjet një *"thonë ashtu, por ne ende nuk e dimë mirë"*, një ndërmjetim logosi, që ngjet sikur së shpejti do të merren lajme të sigurta prej të dërguarëve të posaçëm! Disa janë edhe thasha narrative me forcë prekëse, siç është ajo e italianit Renco, në dashuri fatkeqe me motrën e nenit Age. Fotot e Albumit kanë bërë që autori të sjellë e të risjellë portrete dhe emra të njohur shkodranësh, si pianistën Ida Mëlgushi, profesor Ashtën, bashkëshortën e tij, Aneta Baba – veprimtare sporti, mësuese, pedagoge dhe mjeshtrë e lëndës së Bukurshkrimit në shkollën pedagogjike; Ndoc Ashikun, etj. Personazhe të tjerë të realizuar në nivel të lartë janë: Silva, vajza e ëndërruar prej adoleshentit – autor dhe për të cilën shpërthen në poezi aq të ndjeshme të moshës rinore, krahasuar me Vuajtjet e djaloshtit Werther....

Në mbyllje do të themi se edhe struktura e këtij romani vjen me *novum*, por ndryshe prej veprave të tjera, organizimi i rrëfimit del i kryqëzuar, i ndërprerë prej dialogjesh, me të dhëna gojore të ndryshme, kundërshtime, aprovime, info kulturore për autorë e vepra letrare, kompozitorë dhe piktorë

Ndoshta, jo mbarë lexuesit, por unë nuk mund të ndahem prej këtyre shënimeve miqësore, pa u ndalur sadopak në gjuhën e autorit (*jashtë dëshmime me foto dhe larg thanave e thashave*). Në këtë roman, Çapaliku merr guxim dhe afron mjaft gjuhën e shkrimit me gjuhën e folur, i shpëtojnë rrallë, disa përsëritje leksiku, jo pak shmangie drejtshkrimi, por që asnjë autor nuk merr përsipër të fajësohet për këto devijime a lapsuse shkrimore.

Ai shfaq prirje të dukshme të rrafshimit të togut -ue në -u, sidomos në klauzolat verbale, si: *për ta posedu, du me dalë, ka mbaru, duke shayrtu, asht pershku*, por detyrohet ta vërë në dukje tek mbiemra si: *e kishte lanë të shkrueme, krijues, gjenerues*. Me një kujdes të lehtë, mund të ishte shmangë ndonjë leksemë si *pa u hukubetu, të bamit, guhak-e, do gjana, u thandru, dekoloronte, suspansë, i binte pianos* (luante në piano), *kisha pasë genë i shtërnguem, po i restaurohej simpatia e rrënueme, kishte xhelozu, entuziastik*, etj.

Shkrimtari S.Çapaliku dallohet për frazën e shkurtër, fjalitë dialogjike me elipsë, dhe për pasurinë e mjeteve lëdhëse konektive mes njërive predikative, por lexuesi nuk repton me kënaqësi struktura të panatyrshme, p.sh.: *"Siç lehtësisht pra merret vesh, nëpërmjet kësaj letre..."*. Ai është shprehur vetë se mendon të provojë si gjuhë letërsie edhe idiomën geqe, për shprehësinë dhe praninë e endiadave foljore, sidomos, por për këtë duhet një normë shkrimi, që nuk e kemi. Mjaft gjuhë europiane, të lëvruara prej shekujsh dhe me ndryshime dialektore shumë të mëdha, kanë letërsi në dialekte, po njëherësh brenda një standardi të njësuar.

URIME PËR MOTMOTIN 2024

nga Enver Kushi

I nderuar Prof.Agim Vinca!
Fort i nderçëm mëmëdhetar!
Shok i dashtun!

Po ju drejtohem edhe me fjalën "Shok" përdorur nga Migjeni, që shqiptot tanë legjendarë e kanë nxjerë nga fjalori i tyre, së paku prej tridhjetë viteve dhe nëse u drejtohem me këtë fjalë, fyhen aq shumë, saqë gati të shajnë ose më keq akoma të quajnë "komunist, bolshevik, marksist, idhëtar të diktatorit Hoxha, anakronik, fantazmë e ardhur nga kohëra të përmbysura». Këtu tek ne edhe qenit, qenushes, maces, maçokut, u drejtohen me fjalët "zotëri, zonjë, zonjushë".

Unë përgjithësisht shkruaj urime edhe për Krishtlindje, Pashkë, dy Bajramet, Ditën e Sulltan Nevruzit dhe të Ashures, edhe për datëlindjet. Shkruaj rregullisht urime për Motmotin . Për çdo Motmot. Mbjaj mend që dikur, në ca mote jo shumë të largëta, në Shqipëri, por besoj që edhe ju në Kosovë, e uronim njeri-tjetrin me kartolina. Në arkivin tim modest, kam ruajtur disa nga ato kartolina dhe si nostalgjik i pandreqshëm që jam, në ndërrimvite, i nxjer nga dosja e zverdhur dhe i hap në tavolinën e punës ose raftet e bibliotekës. Dhe më beso, shok i dashtun. Sa here i prek apo lexoj urimet e shkruara në to, më mer malli për miqtë e mi që shumë prej tyre prehen në përjetësi.

Së pari, t'uroj shok i dashtun, gjumin e ëmbël –që të mos dëgjosh si gjëmojnë njerzit nën barrën e kryqave të vet tue shkue në Golgotha. Të mos ndëgjosh as dëshmërimin e të mundunve as britmën e nganjysvet në këtë jetë. Të mos ndëgjosh bubullimet e Spanjës. . .

Ah i dashtun shok, Prof. Agim Vinca. Teksti i shkëlqyer i sipërpërmendun, është shkruar nga Migjeni 87 vite më parë, kur ishte vetëm 26 vjeç, por që kishte shkruar disa kryevepra në poezi dhe prozë duke sjellë një frymë të re, të paparë deri atëhere në letërsinë shqipe, të krahasueshme me poetë dhe prozatorë modern europianë. Dhe me të drejtë shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare, i cili në veprën e tij shënjoj një kthesë historike në letërsinë moderne shqiptare, ka shkruar për vizionein e veçantë artistik të Migjenit: "As grija e jetës së përditshme, as konkretësia e ngjarjeve e, së fundi, as pasioni i tij, nuk e zhveshin veprën e tij nga ai thesar i paçmuar që është universalismi".


Bubullimat e Spanjës tashmë nuk

dëgjohe më. Ato janë shuar në gërmadhat e kohës, por bubullima të tjera vinë nga Ukraina që prej dy vitesh. Prandaj shok i dashtun, uroj që viti 2024 t'i shuaj këto ulërime, britma, shkatërrime qytetesh e fshatrash nga egësia dhe barbaria e Rusisë së Putinit. Uroj gjithashtu që edhe bubullimat që vijnë nga hapësirat e Tokës së Shenjtë, ku kanë lindur disa profetë, viti i sapoardhur, t'i kthejë në melodi dhe këngë mirkuptimi mes popullit hebre dhe atij palestinez.

Së dyti, të uroj shok i dashtun "gjumin e ambël", me dëshirën që gjatë këtij gjumi të shohësh ëndrra me shqiptarë dhe veçanërisht me politikanë e deputetë, që nuk e urrejnë njeri-tjetrin, që të ulen dhe flasin shqiptarisht. Qiejt, herë gri, me re, erëra, shira e furtuna, por edhe të kaltër e me shumë dritë, vijnë dhe shkojnë mbi tokën e bekuar të shqiptarëve. Kjo prej mijëra e mijëra shekujsh, që nga fillesa, kur befasi u artikuloan tingujt e parë njerëzor dhe pastaj fjalët e para. Uroj shok i dashtun që fjala shqipe gjatë vitit 2024 të jetë më njerëzore,veçanërisht në gojën e politikanëve këtej dhe andej Drintit. Uroj që fjala shqipe edhe kur artikullohet, edhe kur shkruhet nga analistë e gazetarë të ketë shenjtërinë, mirësinë, dashurinë e apostujve të shqiptarizmes të të gjitha kohërave. Uroj që moto e tyre të jenë fjalët e arta të një prej gjenive të njerëzimit, Albert Ajnshtajnit: "Dashuria është dritë që ndriçon ata që e japin dhe e marrin. Dashuria është gravitet, sepse i bën disa njerëz të tërhiqen nga të tjerë. Dashuria është pushtet, sepse shumëfishon më të mirën tonë dhe i bën njerëzit mos të humbasin në egoizmin e verbër".

Së treti, të uroj shok i dashtun, prap "gjumin e ambël" që të mos ndëgjosh si afër teje gërset dhëmballa për dhëmballë nga të ftohtit. . . Asht tepër banale të thomi se mungon veshja dhe mbathja dhe zjarmi, prandaj: Gjumin e ambël, shok i dashtun . . .

Ehi nderuar Prof.Agim Vinca. Uroj që viti 2024 të sjellë sa më shumë drejtësi në tokën amë, Shqipëri, si dhe tek ju, në Kosovë, që politikanët e paskrupuj, të pangopur "këta derra të kënaqur", pasuruar duke vjedhur e grabitun pasurinë e shqiptarëve, të mos na hiqen si Mesia dhe mbajtur fjalime nga dritaret. Politikanë, ish shtetarë dhe shtetarë të sotëm, që në vilat e tyre kanë wc edhe për zonjushat mace, ndërsa të tjerë nga populli "gërsasin dhëmballë për dhëmballë nga të



ftohtit", duhet të ndëshkohen nga drejtësia, por edhe nga mallkimet e atyre që i grabitën, i lanë pa pronë.

Prandaj, uroj të mos vuajmë " bashkë me fëmin të cilët prindi nuk ja bleu lojën, bashkë me të riun që digjet n'erotizëm, me pesëdhjet vjeçarim që mbytet n'apatinë e jetës, me plakun që dridhet nga friga e vdekjes, me bujkun që lufton me tokë, me punëtorin të cilin hekuri dhe e ndrysh, me të sëmundët e të gjithë sëmundjeve të krejt botës" Dhe këtij teksti të Migjenit do t'i shtoja edhe urimin tjetër: Të mos dëgojmë gjatë vitit 2024 klithmat e fundit të vajzave, nuseve, grave shqiptare, të masakruara nga disa mostra burra, këta qenie barbare e të pashpirta, që fatkeqësisht janë shtuar në shoqërinë shqiptare.


Shok i dashtun! Në mbyllje të këtij urimi për Motmotin 2024, dëshiroj të citoj fundin e "Urime për 1937" të Migjenit: " Mbas gjumit t'ambël, t'uroj-çasht dhe e natyrshme- të jesh i gëzuem, gjithmon i gëzuem . . . Aq i gëzuem sa që bota të ta kenë zili dhe të thonë: Oh sa i lumtun asht! Të jesh i gëzuem, edhe pse nanë tjetër zemra të pëlset, si paljaços. Të jesh i gëzuem, se gëzimi yt u jep shpresa edhe të tjerëve. Në rasë se tryeza e shkrimit të çalon ti qeshu. Në rasë se e vetmja karrike që ke në shtëpi asht e shpueme dhe s'ka se ku të rrih, ti qeshu. Në rast se s'ke zjarm e ke të ftohtë, po, ti qeshu. Në rast se ndoj ditë, ashtu kot, të mungon dhe buka, ti merrja për lojë, për shaka dhe qeshu, qeshu . . . Sëmundja e të qeshunit do të përhapet ndër të gjithë dhe njerëzit si majmunat do të hidhen përpjetë nga gëzimi... Dhe kështu uroj që vjetin 1937 ta kalojmë në gëzim - edhe se të smunde patologjikisht"

POST SCRIPTUM

I dashtun shok dhe mik Prof. Agim Vinca. Ka kaluar mesnata dhe ka nisur Motmoti i Ri 2024. Vërtet ka hyrë i ri apo koha ka ngrirë në kalimviti 1937? Ah koha! Koha! Dhe më vinë ndërmend në këto momente idetë e Borgesit për kohën që " Është dhuratë e përjetësisë. Përjetësia na lejon gjithë këto përvoja në vazhdimësi: Kështu kemi ditët dhe netët, kemi orët dhe minutat, kemi kujtesën, ndjesinë e së tashmes, pastaj kemi të ardhmen, një të ardhme që ende nuk e njohim, që do të jetë, që e parandajmë ose e besojmë . . . "

Gjumë të ëmbël i dashtun Shok! Është urimi që vjen nga përjetësia, nga njëzet e gjashtë vjeçari me emrin e përjetshëm gdhendur në kohë: MIGJENI.

Shkodër-Tiranë
Motmoti 1937 dhe 2024



URIME PËR 1937

Shok i dashtun, unë përgjithësisht nuk shkruaj urime, as për Krishtlindje as për Bajram, as për ditëlindje as për ndoj festë tjetër. Nuk shkruaj, pse urimet që n'ato ditë e tanë bota ban, nuk dijt a plotësohen një për qind — se pothuaj të gjitha dalin nga hipokrizia. Bota këttë e din, por njësoj vazhdon të shkruajë urime. As për Motmotin e ri deri tash nuk i urren askujt asgjë. Por kësaj herë due të hyj në radhën e njerzve të korrektë dhe t'u uroj shokëve të mij Motmotin e Ri të 1937.

Së pari t'uroj, shok i dashtun, gjumin e ambël — që të mos dëgjosh si gjëmojnë njerzit nën barrën e kryqave të vet tue shkue në Golgotha. Të mos ndëgjosh as dëshmërimin e të mundunve as britmën e ngadhnyysvet në këtë jetë. Të mos ndëgjosh bubullimet e Spanjës, Gjumin e ambël — të mos dëgjosh si afër teje gërset dhëmballa për dhëmballë nga të ftohtit. Se atëherë duhet të pyesh: moç dhëmballë, pse ndesh për dhëmballë dhe gërset aq? E gjuna në vend të dhëmballës përgjegjet: pse asht ftohtë, zotni, e kur asht

ftohtë, zotni, e hyn ireqi trupit, muskulave, nervave, zotni, dhe q'ashtu gërset dhëmballa për dhëmballë, zotni. Asht tepër banale të thomi se mungon veshja dhe mbathja dhe zjarmi, prandaj: gjumin e ambël, shok i dashtun.

Së dyti, mbas gjumit t'ambël, t'uroj — ç'asht dhe e natyrshme — të jesh i gëzuem, gjithmon i gëzuem. Nga gëzimi i madh, në sentimentalizëm, të puthish drrasat e dhomës e shtyllat, si bani Greta Garbo në filmin „Mbretnesha Kristina" kur shijoi dashurin' shtazore (desha të them hyjnore, por njësoj asht). Aq i gëzuem sa që bota të ta kenë zili dhe të thonë: oh sa i lumtun asht! Të jesh i gëzuem, edhe pse n'anë tjetër zemra të pëlset, si paljaços. Të jesh i gëzuem, se gëzimi yt u jep shpresa edhe tjerëve. Në rasë se tryeza e shkrimit të çalon ti qeshu. Në rasë se e vetmja karrikë që ke në shtëpi asht e shpueme dhe s'ka se ku të rrih, ti qeshu. Në rast se s'ke zjarm e ke të ftohtë, po, ti qeshu. Në rasë se ndoj ditë, ashtu kot, të mungon dhe buka, ti merre për lojë, për shaka dhe qeshu, qeshu. Del në rrugë bile, në kryqëzimin e udhvet, dhe qeshu qeshu qeshu, e bota do ta ketë zili dhe do të thotë: ah sa i lumtun asht! E kur të të vijë në shtëpi ta shofi shkakun e gëzimit t'and, do t'i kujtohet botës vetvetja dhe do të fillojë të qeshi kikiki-kakaka. Smundja e të qeshunit do të përhapet ndër të gjithë dhe njerzit si majmunat do të hidhen përpjetë nga gëzimi... Dhe kështu uroj që vjetin 1937 ta kalojmë në gëzim — edhe se të smunde patologjisht.

Në mes të autobiografisë dhe ditarit vjen rrëfimi i aktores Anisa Markarian si kujtime. Të rrëfesh një të kaluar të papërsëritshme në kohë dhe aposteriori të pashpresë. Të tregosh rrëfimet e Nënës dhe më pastaj kujtimet e vetes deri në ikjen e babait! E tërë rrëfimi ndërtohet mbi aureolën e përkushtimit ndaj prindërve. E nderimit ndaj babait. E kujtimit më të mirë për veprën dhe vlerat e prindërve!

Parafjala një perlë, mjeshtëri, mesazh. Të shfletojmë kujtimet. “Të thurim gjerdanin e vyer të së shkuarës sonë” siç i krahason autorja “kujtimet-dëshmi si tablotë e mjeshtrove.”

Vepra është e ndarë në 23 kapituj të emërtuar. Kapitulli i parë “A. A. M.” kujtime nga rrëfimet e nënës. Lindja e Anisa Agop Markarian me datë 4 korrik 1962 I) kur nëna kishte 41 vjet. Prindërimi në moshë 64 vjeçare?! Vërtetësia apriori i rrëfimit të nënës? Të Asaj, në veten e tretë: “S’më besoni? Atëherë, mbani vesh se ç’më rrefen ime ëmë.” (f. 9)

Përshkrimi i veshës, i zisë. Tradita e uljes së fëmijës në tepsinë e fatit. Shpjegimi i fjalës “strukull”, mbiemrit dhe drejtshqiptimi fonetik. Anisa ka prekur stetoskopin, ka marr të kuqin e buzëve dhe stilografin në “Tepsinë e fatit”.

“Nëse gjer tani ngjarjet e jetës familjare i kam ndërtuar sipas rrëfimeve të të tjerëve, që nga data 17 prill 1966 e tutje do të bazohem kryesisht në kujtimet e mia...”, thotë autorja në kapitullin e tretë që del edhe titulli i librit.

Anisën e kam njohur që në vitin 1978. Dhurata në filmin “Vajzat me kordele të kuqe”. Një interpretim me ndjeshmëri të lartë artistik dhe karakter përmbajtësor. Me Anisen kam komunikuar për herë të parë në vitin 2015. Me Anisen për herë të parë takohem në Kuçovë në tetor 2019. Ishin këto komunikime me ndërmjetësim filmi. Dhe takimi tjetër me shkas libri. Vepra me kujtime. Panairi i librit “Tirana, 2023”. Dhe kushtimi.

Derisa në kapitullin e parë sipas Nënës përshkruan lindjen e vetes në kapitullin “M. A. M” më thjeshtësi, intimitet dhe në detaje përshkruan aktin e lindjes dhe çastet e para të jetës së foshnjës, vëllait. “Të bijës e të birit u ka vënë emrat e prindërve të vdekur gjatë marshimit për në kampin e përqendrimit.” (42). Më tej një rrëfim njerëzor dhe me virtyte të një fisnikërie të lartësuar familjare: “... -Vështirë të jetohej normalisht me prindër kaq të moshuar...”

Keni të drejtë, o përfolësa anonimë! Në jetën time e të tim vëlla, asgjë s’do të jetë “normale”. Dhe aq më mirë!



Romani “Shtëpia te Selvia”, i Anisa Markarian, shtëpia botuese “Çabej”

“... SI TË ISHTE LEXIMI I ABETARES.”

nga Enver S. Morina

Rrëfim, dromca e fragmente nga fëmijëria, lindja deri në vdekjen e babait. Thjeshtësi dhe lehtësi leximi. Rrëfime nga e kaluara e një periudhe “idilike” dhe “të perënduar” (4 korrik 1962-16 gusht 1980)

Normaliteti s’bën për ne. Është një status i mërztishëm e i pamjaftueshëm. Pothuajse i rrezikshëm! Na ndrydh iniciativën e na fyen krenarinë. Më keq, akoma! Na rrëmben të jashtëzakonshmen e na zhyt në rëndomtësinë e pabujë. Unë e im vëlla jemi fryt i dashurisë së një burri të pjekur me një vajzë flokëthinjur, që e kryen gjer në fund

misionin e tyre mbi tokë. Pa bërë llogari me moshën, pa iu përvjedhur përgjegjësi, pa iu trembur nofkës poshtëruese “prindërgjysh”. Ç’fat që po rritemi ndryshe! Në familje tonë nuk përgojohen të tjerët, nuk shpërdorohet koha e nuk ngrihet zëri. (Im atë dëgjon më shkoqur kur flitet me zë të ulët.) Na mësohet respekti për tjetrin



si të ishte leximi i abetares. Na jepet shembulli që dashuria e lumturia nuk njohin moshë. Edukohemi me detyrën e ndershmërisë e të besnikërisë dhe betohemi se s’do të qëndrojmë kurrë mospërfillës ndaj padrejtësive dhe dhunës. Shpirti artist i sime ëme dhe romantizmi djaloshar i tim eti janë universi ynë i emocioneve...” (43-45)

“Gjirafa” a “Qafëlejlekja” ka disa ndalesa gjatë rrugëtimit të saj të përditshëm. Ndalesa e parë: Këndi i Lojërave. Ndalesa e dytë: Klinika Dentare. Ndalesa e tretë: Teatri i Kukullave. Ndalesa e katërtë: Rruga e Barrikadave. Ndalesa e pesat: Pazari i Ri. “Ndalesa e gjashtë”: “Kongresi i Përmetit”.

“Është shumë e rëndësishme ta njohësh mirë historinë tënde familjare.” (32)

Historia e familjes Markarian vjen në detaje, përmes një dokumentacioni të ruajtur mirë, siç i quan autorja në “Sëndukët e Majrigut e të Yzhenit”. Vajza e përshkruan kështu dashurinë e Nënës ndaj babait: “...Dashuria e sime ëme për tim atë ka dy kulme: respekt e dhembshuri. Respekt për personalitetin dhe moshën e tij (kanë plot 23 vjet diferencë) e pat gjithçka që ka arritur në jetë me ndershmëri, punë e këmbëngulje. Dhembshuria është për vuajtjet që ka hequr e mizoritë që ka parë me sy.” (63)

Informacione dhe të dhëna të veçanta për filmat “Guliveri”, “Aventurat e Çufetinos”, “Pinokio”, për serialet “Odisea”, “Vëllezërit Karamazov”, për veprat e baletit “Detashmenti i kuq i grave” dhe “Vajza me flokë të thinjura”, koncertin pianistik “Lumi i verdhë” (koncert pianistik). Përmes pronësisë së një televizori mësojmë për gjendjen sociale, jetesën në periudhën e viteve 60-ta e fillimvitet e 70-ta të shekullit. “Në të shumtën e rasteve, televizori përfaqëson qendrën e gravitetit të shtëpisë.” (73), thotë autorja.

Vepra “40 ditët e Musa Daghut” nga Franz Werfel. Autorja na jep disa fragmente të romanit në shqip, e krahason Afion Karahisarin me qytetin e Gjirokastrës. (102)

Një nga kapitujt më të mirë “Para Marsh”. Parulla, rrëfim, dialog. Përshkrim që përçon ide të mëdha. Liria e një kombi dhe universalizmi. Fragment: “Të ecurit më fal një ndjesi magjike. Përparoj çdo ditë drejt hapësirash të virgjëra. Në çdo hap të ri, farëzojnë ëndrra e dëshira të parrëfyera. Jam i ndërgjegjshme që liria ime i ka këmbët e lidhura. Diku, dikur, do të ndeshem ballë për ballë me Portat. Janë aq të larta saqë, për t’i kapërcyer, duhet shpuar dielli. Qëkurse kam ardhur në jetë, i kam parë gjithmonë të mbyllura. “Do t’u jenë ndryshkur drynat e s’u bën më asnjë kyç”, - i them vetes. “Për t’i hapur, u duhen këputur hallkat me një darë të fuqishme.” Por nuk shoh dara. As bravandreqës. “Ndoshta



janë dryna të padukshëm, të maskuar në kushedi ç'pjesë të Portave. I kërkojnë prej vitesh, por ende s'i kanë gjetur. Ata të paktë që shihen në bisht të llozave shërbejnë vetëm për të na hedhur hi syve", mendoj. "Ndoshta, janë duke punuar gjetkë", i shfaqësoj. Duhet të jenë me miliona dryna. Të rëndë e mëdhenj. Të përçudnuar. Vetëm dryna të tillë arrijnë ta mbajnë kyçur një popull të tërë." (110-111)

Tek kapitulli "Lajmëtarja" Anisa përgatitet për rolin e radhës aposteriori. Në filmin "Vajzat me kordele te kuqe". Më tej autorja i vë rëndësi përshkrimit të kohës, jo vetëm si çështje filozofike-ekzistenciale por edhe pragmatike, mëkatin e humbjes së kohës kot. "S'ekziston arsye në botë që mund të përligjë mëkatin e kohëvrasjes." (148)

Në kapitullin "Ora e frëngjishtes", autorja flet për dialektin, gjuhën, të folmet, abetaren (177, 178), për Kongresin e Drejtshkrimit, për veprat "Bagëti e Bujqësia" e "Andrra e Jetës", për aktorin Prokop Mima, për Robert Shvarcin, për Rafin (pseudonim i shkrintarit Hagop Hagopian), për përkthyesin Aziz Vrionin (Luan Gjergji), për veprën "Arturo Ui", etj. për "Antologjia e prozës shqiptare" (1984), përkthyer nga Jusuf Vrioni, Aleksandër Zoto dhe Luan Gjergji (mësojmë se Luan Gjergji është pseudonim i Aziz Vrionit, f. 189)

Babai e porositi vajzën: "Gabimet në armenisht, të falen. Shqipen, ama, ta flasësh e ta shkruash në mënyrë të kulluar.", ndërsa autorja thotë për vete "Flas gegërishten e Durrësit dhe shkruaj gjuhën letrare." (180). Aziz Vrioni e këshillon: "... Mëso sa më shumë shprehje idiomatike! Janë pasuri gjuhësore." (186)

Takimi i babait më të vdekurit, më paraardhësit (197), një përshkrim dramatik dhe rrëfim që të mban frymën. "Një spiun në shtëpinë time", mund të quhet fragmenti i fundit të kapitullit "Ujë fle, armiku s'fle" si një triptik rrëfimtar Vigjilenca, Parulla dhe Zgjimi (faqe 205, 206)

"Parandjenja" në fund. 2) Filmi "Në çdo stinë". Dy citate në vend të përfundimit: "Jeta është më e fortë se vdekja." dhe "Im atë do të prehet në të njëjtin varr me Yzhenin dhe Majrig Koharin. Tre armenë së bashku, në dy metër katrorë të tokës bujare shqiptare." 3)

Dhjetor 2023, Prishtinë

1) Shënim i huazuar nga botuesi: Bijë e një nëne shqiptare dhe e një babai armen, i cili u mbijetoi masakrave të gjenocidit otoman dhe zgjodhi Shqipërinë për atdhe të dytë, Anisa Markarian lindi në Tiranë më 4 korrik 1962. Me gjithë prirjet për artin, sidomos për letërsinë e kinematografinë, ajo studioi mjekësi e punoi si mjeke anesteziste-reanimatore në Spitalin Nr. 2 të kryeqytetit deri në vitin 1991, kur emigroi në Francë.

2) Të dalësh nga familja, nga fshati, nga të afërmit dhe ti kesh e ti gesh vend "këmbëkryq" në vend tjetër? Ky është libri me kujtime, siç mund të lexosh një udhëpërshkrim tjetër, reportazh tjetër. Kësaj here kam gjetur strehë tek familja Markarian, tek jeta e Anisës, tek fëmijëria e saj?

3) Krahasimi me fatin e dy popujve: Derisa Anisa përmes babait rrëfen gjenocidin kundër armenëve dhe fatin e tyre, Ne muhaxhirët e kemi "të largët" këtë përjetim. Gjyshi i gjyshit ka jetuar në Toplicë.

Neviana Shehi

PRANË HESHTJES

poezi

DJEPI

Kur erdha në jetë ai ishte ende aty në cep të dhomës së miqve si relikte dhe askush s'e dinte moshën e tij të vërtetë as gjyshja as nëna as dajot dhe kushërinjtë e mi

Dukej se kish ardhur në shtëpinë tonë që nga fillesa i vjetër sa lashtësia dhe i bukur sa jeta

Me dy këmbëza druri dhe një mori figurash floreale vizatuar mbi dy harqet e epërm dikush kishte gdhendur edhe dy pëllumba të bardhë të vegjël por që koha i kishte zbehur

E megjithatë ai djep ishte kaq i bukur dhe kaq i dashur për mua

Sa e sa foshnja të fisit tim ishin përkundur në vite e dekada mbi të vëllai im motrat dhe unë

Përpara se ta përkundte nëna ime të tjera duar nënash dhe gjyshesh e kishin përkundur atë

Sa herë që hyja në dhomë dhe vështrimi im binte përmbi të s'di pse më bëhej se aty shikoja foshnjërinë dhe rritjen time nëpër vite

Ai djep kish brenda tij shumë nga të qarat e mia dhe vitet ai djep më shumë se druri ish ndërnuar prej ninullash dashuri nënash

ndaj nuk donte t'ia dinte për vitet

Ditën kur u ktheva në shtëpi dhe s'e pashë provova një dhimbje dhe ndjesi braktisje

Ikja e tij kishte marrë me vete edhe pjesën time më të bukur dhe më të virgjër fëmijërinë

Edhe pse kanë shkuar vite dhe jam bërë nënë në kujtimet e mi vazhdon të përkundet po ai djep i foshnjërisë sime...

LIBËR I PALEXUAR

Dikush e ka lënë në cep të një stoli pa marrë mundimin ta shfletojë asnjë faqe dhe kjo duket qartë

Një libër i palexuar është si një person misterioz kalon para teje me një shall të madh rreth qafës dhe gjysmën e fytyrës futur në të

Ai enkas nuk t'i hedh sytë duke pritur t'i flasësh ti i pari dhe ndërkohë që ti ngurron ai të ka lënë targën dhe është zhdukur

Një libër i palexuar di të të josh me misteret e tij edhe pse ti s'i ke qejf shfletimet

Kapakët e tyre të trashë janë kasaforta ku fshihen kaq shumë ngjarje dhe skena dramatike kaq thirrje dhe ofshama heronjsh të tradhtuar

Nëse do të afronit pak veshin

ju mund të dëgjoni gjithfarë historish dhe subjektesh nga më të ndryshmet

Lum ai që di gjuhën ose kodin e shfletimit

Librat e palexuara janë gjithshër të mençur që kanë kaq shumë gjëra për të rrëfyer por nipërit dhe mbesat ju kanë kthyer shpinën dhe as që duan të dinë për ta

Ua kuptoj që nga larg mërzinë por më shumë se kaq ca psherëtima të verdha trishtimi

Librat e palexuar janë copëza jete njerëzore të mbyllura nën kapakë përbuzje dhe flakur në askund...

LIBRI I MBRËMJES

Ata u puthën me zjarr atë mbrëmje dhe cipa e qiejve u bë një hartë buzëqeshje

Nuk u ndodha aty por në librin e mbrëmjes ishte shkruar gjithçka dridhja e ajrit parathënia e lëvizjeve prekjet e para dhe psherëtimat

Etimologjia e zjarreve që ndodhen në trupat e tyre do të jetë e paqartë

Më vonë kur bukinistët do ta marrin në dorë atë libër do të ngelin në mëdyshje dhe në vend që ta shesin do ta mbajnë për vete

PRANË HESHTJES

Unë dhe heshtja ulemi çdo mbrëmje pranë njëra tjetrës me nga një filxhan çaji në duar dhe na pëlqen të rrimë pranë njëra tjetrës deri vonë

Gëlltis me ëndje hurbat e çajit ndërsa ajo e futur brenda meje di të më shohë vetëm në sy

Jo se na janë mbaruar fjalët por kemi kuptuar se kjo është e vetmja mënyrë për t'u ndier më mirë

Mund të jetë kjo arsyeja që kemi kaq kohë që rrimë bashkë dhe nuk jemi mërzitur asnjëherë me njëra tjetrën

Në shumicën e herëve këto lloj miqësish mbarojnë shumë shpejt por për tipat si unë kjo nuk qëndron

E kam kuptuar prej kohësh inflacionin e fjalëve dhe ideve ashtu siç kam kuptuar me kohë të kundërtën e tyre

Shumica e njerëzve të sotshëm flasin atëherë kur s'kanë gjë për të thënë ndërsa ne kemi aq shumë sa nuk na del koha për t'i thënë të gjitha

Rrimë çdo natë pranë njëra tjetrës me nga një filxhan heshtje nëpër duar dhe vështrimë me keqardhje rrotullimin e zhurmshëm të globit

Ndonjëherë heshtjet zhurmojnë më tepër se një milion gjëmime daullesh bashkë



18 Tetor 1975

U mbushën katër ditë sot që ndodhemi të internuar në Myzeqe. Grabjan i thonë fshatit, nja 20 km nga Lushnja por larg rrugës nacionale, në drejtim të perëndimit, veçse det nuk shohim me sy, e kemi të fshehur, prapa një vargu kodrash.

Na kanë dhënë dy dhoma në një kapon të mbuluar me llamarinë, i cili strehon veç nesh edhe dy familje të tjera po nga Tirana.

U ngushtua edhe më rrethi, çarku. Vetëm burgu ndodhet përposht nesh tani... Por çuditërisht e kam zemrën të lehtë, me shpresë.

Dua t' i shënoj ngjarjet që do vijnë, si një spektator i mënjanuar; që me to të formoj më pas një histori, një nga të shumtat e kësaj epoke, që është e mbushur me të tilla, fate njerëzish në qytet e në fshat dhe sidomos në vendet e mbyllura, burgje e kampe, një sferë kjo mjaft e njohur për familjen tonë nga e cila ishim shkëputur prej disa vitesh dhe që tani po na gllabëron sërish.

Në Tiranë kam bërë një jetë monotone vitet e fundit, deri diku të rehatshme; tani filloi të lëvizë prapë indikator, gjilpëra....Të rrih mënjanë e tua regjistrosh këtyre "bëmat", kjo më nxit mjaft megjithëse nuk është kaq e thjeshtë (kjo frymë pikniku e ditëve të para, ka për të na lënë së shpejti, kjo dihet). Sidoqoftë vlen t' i hyj kësaj pune, është e vetmja mënyrë për të mbajtur një lidhje me gjërat por edhe me veten time. Nga të tjerat s' do të jem fort i ndryshëm nga një automë, i dëshiruar për gjumë.

Kjo histori filloi në datën 14 kur na u komunikua vendimi i Komisionit Qëndror të Dëbim- Internimeve. Kemi dëgjuar për 60 familje të hequra, që i kanë shpërndarë në të katër anët. S'di sa e vërtetë është kjo shifër, disa thonë janë më shumë. Mund të them vetëm që në rrugën e Durrësit, kur dolëm atë mëngjes, të datës 15, kishte edhe makina të tjera, para e mbrapa nesh.

Mëngjesin e së djeshmes, të datës 14 isha nisur si përditë me biçikletë nga dhoma ime përtej Laprakës, për të vajtur në punë (që këto tetë muajt e fundit ka qënë në Fermën e Perimeve ngjitur me stacionin e trenit). Si përherë, bëra një ndalesë tek im'më për të veshur robot e punës. Gjeta Teftën, time motër, që më priste tek dera por jo si zakonisht. Ndërsa po lija biçikletën, diçka ndjeva tek sytë e saj. Bëra të hyj me një dëshirë të papërcaktuar për të shmangur atë që donte të më thoshte. Por ajo ma dha lajmin aty me të butë për të mos më alarmuar: Po na internojnë Lekë. Pesë vjet në një fshat të Lushnjës....Të kanë thirrur edhe ty, të paraqitesh menjëherë. Fjalët e saj nuk më ndalën por kur zgjata dorën të marr rrobat prapa derës, kuptova përnjëherë se dita ime po bënte një kthesë të fortë dhe se për të gjithë ne po rifillonin havazet.

Brënda gjeta mamanë të ulur në një cep; më vështroi me pikëllim U ula: "Ja ç'paskan qënë fjalët që qarkullonin. Për ne paskan qënë... thashë pa frenuar dot një sarkazmë të hidhur për verbërinë tonë. Dhe ne flinim gjumë" Ato më shikonin pa bërë zë.



Dhoma e rregulluar për bukuri,

Lekë Tasi

"GRABJANI RREZË KODRAVE"

Skena, personazhe, historira nga fshati i internimit në vitet '70-'80

Fragment nga romani



me atë sistemim rrënjësor që i bëme tamam këto ditët e fundit. Të gjitha kot... Njëzet vjet natë bodrum, vetëm tani, këtë muajin e fundit me ndarjen e pallatit karshi, e kishim hequr shpresën definitivisht se do na jepnin hyrje dhe i kishim bërë një revizion të thellë bodrumit (deri edhe me kartë të ngjitur në mure për të mbuluar njollat e lagështirës.)

U çova në këmbë:- "S'ka gjë ! Ky mund të jetë fillimi i fundit!" u thashë për të reaguar disi dhe për tu dhënë zemër. "Një palë kërkon të hedhë palën tjetër, për ti veshur krimet e bëra. Prandaj vetë vala që po na merr, mund të jetë menduar si klimë e egër, si shtrat i ngrohtë për të larë hesapet me kundërshtarët..."

Shpresojmë që diçka e mirë të dalë, një kthesë që e kërkon koha.

Vëllai im i madhi, Napoloni në Shkodër, është jashtë rrezikut deri sot. Pata një gjysmë shprese se edhe i vogli, Ylli i transferuar në Librazhd qysh në prill do të shpëtonte. Por s'mu vërtetua; e sollën në mbrëmje me polic. Peripecitë e tij kanë qënë më të shtrira në hapësirë se e ne të tjerëve. Para gjashtë muajsh kur ishte në Kukës për një punë, e pushuan dhe e dërguan puntor së bashku me mua (që më pushoi ndërmarrja ime) në Bonifikim. Pastaj urdhri u prapsua, sepse si duket u erdhi ne mend internimi që po pritej, por ndërkohë atë e dërguan në Librazhd për tu zgjidhur edhe një problem tjetër të ngutshëm që kishin.

E hidhur është kur kërkon shënja vërtetuese të asaj që je i bindur se po ndodh në thelbin e situatës dhe në vend të tyre të vijnë shuplaka të tilla. Është një duel me telepati, sikur ata e kuptojnë që ne i biem në të sëmundjes së vërtetë të tyre dhe na ndërshkojnë për këtë. Tani më duket se po paguaj për një optimizëm mjaft mëndjelehtë që kam shpalosur në këto dy - tre vjetët e fundit. Jo se më tronditet besimi. Më tepër është kjo tjetra, që kuptoj se faktori kohë në të gatuarit e ngjarjeve është i tillë që ta bën pothuaj të pavlefshme gjithçka ke pikasur, i shtyn, i largon tej e më tej ato që ti i llogatitje të afërta. Ajo është një kohë "politike", historike, shumë më e gjërë se e jona dhe tani duhet ti jap të drejtë atij shokut tim që entuziazmit tim rreth kursit të ngjarjeve para dy vjetëve iu kundërvu me një të qeshur gati tallëse: "Rrudhat tona s'mund të hahen me ato të sistemit..."Aq më tepër i jap të drejtë tani që erdha këtu dhe më pret bujqësia, që sa për rrudha e di vetë si i hap e i thellon së bashku me brazdat që do të na vënë të hapim.

Por prapë s'mund të rri pa shpresë. Më mjafton që kjo e jona është bazuar në gjëra të vërteta, të ndodhura, e jo si në vitet e para. Afatet fundja s'dihen, ka edhe të papritura....

Gjeta në korridorin e ngushtë të Këshillit një tjetër fatkeq si unë që po priste. Sa e pashë mendova me vete: Ja një nga ata, për të cilët dëgjojmë " e futën brënda filanin, e hoqën me kamion filanin". Edhe vetë emri i tyre sikur ndjell gjëra të tilla, ca emra si Burimi, Bregu etj ato janë kalimitat e luftës së klasave gjatë dekadave, gjithmonë po ata.

Sa i pambrojtur, i pakët m'u duk atë çast, i dënuar qysh në fillim të

ekzistencës së tij (do të ish nja 30 vjeç), të pozojë përherë në rrumbullaken e shënjestrës së tyre. Priste të hynte dhe kur më pa që po ngjitja shkallët bëri buzën në gaz si i turpëruar që e kapa aty në këtë rol që po lozte aq gjatë, përtej çdo lezeti.

Pale, u dashka pritur! mendova me gjakun në kokë përnjëherësh. Edhe tani që po na heqin qafe brënda 24 orëve duhet të rrimë e të presim përjashta! Është ajo teknika bajate tanimë e mjedisëve policore, e shkundjes psikologjike që ua kanë lënë trashëgim ustallarët moskovitë dhe që synon ti japë kujtdo që ka punë me ta një të përzier të lezetshme në stomak.

Nga i mërzhitur u ktheva gati në qejf .. shtyva derën dhe vetëm çastin e fundit një farë serioziteti ndaj vetes më frenoi që mos ta filloja me ndonjë të tillë si "Hajër ishalla" ose "Hë ç'kemi?" i vështrova me një ngrysje ku përbuzja, besoj, dukej hapur. Të katër muret e zyrës ishin zënë me njerëz të ulur në karrige rresht, që asistonin në aktin e komunikimit dora - dorës, të vendimeve. Ishin aq ngushtë të shtërnguar saqë brrylat e secilit kërkonin vend në ijët e tjetrit pranë. I kishin thirrur sigurisht si bashkëpërgjegjës. Ndoshta disa mund të ishin ndër ata që kanë raportuar emrat tanë këto javët e hartimit të listave, por s'm'u dukën fort të kënaqur që po i ballafaqonin me viktimat. Vështronin si të ngurosur përpara dhe asnjë s'guxonte të fliste ose të ndizte cigare, si ata të dy ne krye të tryezës. Njëri prej të cilëve, i vogli i vëllezërve Kondi, Shima, një tip kokëvogël përfaqësonte Ministrinë. Tjetri, Kryetari i Lagjes, i vetmi që aktivizohej, nja 40 vjeç, i pashëm, i bëshëm dhe fare i çkujdesur si një viç që ka shumë kohë para vetes gjersa ti vijë ora e thikës. Më komunikoi vendimin për pesë vjet jetë bujqësore në Grabjan të Lushnjes. Vazhdoi me arrogancë: "Nuk do të lëvizni nga shtëpia se jeni nën vërejtje: Nesër ju vjen makina" dhe vazhdoi të shfletonte dosjen. - "Kam nënën sëmure, dua një shtytje" tentova unë fare pa shpresë, por me një ton sa më të shkoqur e duke vështuar në tavan. Ata rrotull m'i kishin ngulur sytë, kurse ai me sytë përsëri në shkresa, e kishte spuntuar emrin tim dhe ma ktheu pa më vështuar: "Ka doktorë edhe atje."

U ktheva mendueshëm drejt derës, shumë ngadalë e pa i hequr sytë nga tavani. E tërë rezistenca ime u reduktua në kaq gjë, meqë s'më mbetej ç'të bënja më. I ndodhur natë pikë si duket preferova ritiratën sesa një palë hekura në duar. Fundja çdo gjë që të thoshnja s'vlente. Kjo është tatëpjeta e të gjithëve (edhe e atyre që rrinin ulur ngjitur me murin;) dhe çastin e fundit si për tu justifikuar me veten time, mu kujtua që 'heshtja është më dinjitoze'.

Dola që andej dhe shpejtova hapat për në shtëpi. Në 24 orë duhet të ngrenim plaçkat, t'i bënim gati. Nga t'ia mbaja? I pazoti vetë të ngul një gozhdë, s'më mbetej veç tu drejtohesha të tjerëve si përherë, meqënëse jeta paska prapë për ne kamiona e policë të armatosur që presin te dera; "Ylli duhej patjetër tani" thashë me vete i ndodhur ngushtë tani për paketim, për të mos përmendur atë që na pret atje poshtë, kush e di çfarë, çati që pikojnë, brava që s'mbyllen, soba që nxjerrin tym, gjëra këto që i kam parë

të rregullohen gjithmonë prej tij.

Kur u ktheva në shtëpi bëmë një program pune me mamanë dhe Teftën. Të dyja ato u vunë të grumbullojnë plaçkat e vogla, ndërsa vetë shkova njoftova Engjëllin (kushëririn) e pastaj vajta në shtëpinë time njoftova gruan (që atë javë ish turn i dytë). Vendosëm që ajo të vazhdojë punën gjersa neve të stabilizohemi. U dëshpërua shumë por unë s'kisha kohë të rrinja më gjatë. Janë të dyja shtatzanë ajo edhe e shoja e Yllit. Pastaj u hodha në ndërmarrje ku mora librezën dhe bëra likuidimin. Kur u ktheva në shtëpi gjeta një polic te dera. Në ato pak orë që na mbeteshin, jo vetëm nuk mund të delnim më nga shtëpia deri sa të vinte makina, por edhe askush nuk mund të hynte po të mos ish i rrethit familjar. Më vonë në vend të policit erdhën të tjerë, çuna të lagjes që ndenjën roje te dera gjithë natën, dy nga dy, me turne.

Por para se të vendosej mirë kjo bllokadë, pasdite përfitova nga një gjysmë leje e policit dhe dola për të fundit herë me biçikletë në rrugët e Tiranës. Vinte rrotull për shi, vesonte herë pas here prandaj dielli që shfaqej me hope në muret e ndërtesave, më dukej edhe më i shtrenjtë si vetë orët e pakta të lirisë që më mbeteshin.

Galloshet duheshin ngjitur - mendim naiv ky po ta gjykoj me këtë det balte që na priti këtu ku ka rrezik të fundoset çizmja - pedalet difektoze të biçikletës duheshin ndërruar, ca punë të tjera pezull duheshin mbaruar...


Gjeta njerëz plot te gomistët por në cepin e tejmë të banakut ku u mundova të çaj, një shok i ushtrisë, një krutan i lindur për tregti grosiste i katandisur tani të presë çizme e galloshe të vjetra, më njohu mbas 20 vjetësh dhe me gjithë rrëmujën zgjati dorën. Ia lashë me një përshëndetje që s'ma dëgjoi dhe ika vrap te biçiklistët. Edhe aty njerëz plot vinin rrotull nëper shiritat e verdhë të dritës së diellit që hynte nga dritaret e mëdha horizontale, secili duke kërkuar diçka në tokë për vete. I pata zili për atë jetën e tyre të muzgët që do të zgjatej përtej nisjes sime. Të kish të kthehej si për mrekulli urdhri, premtot të çoja një jetë të thjeshtë, të përkushtuar këtyre gjërave të vogla, lojrave të motit e të dritës dhe të gjitha ngjarjeve të parëndësishme që më ndodhin afër, veç pa problemet e ngutshme që urrej, siç është të nxjerrësh një këmbë nga balta ose të zësh rradhe në një dyqan të qelbur fshati.

Zërat e internimeve ishin hapur me shpejtësi si duket. Iu afrova përgjegjësit një djalë

sportiv mjaft i ngrysur që më kishte thënë "jo" nja dy herë kohët e fundit për pedale. Ruajta rastin dhe i fola në emër "Ke gjëkund ndonjë palë pedale se më duhen shumë" dhe pa i lënë kohë të përgjigjet shtova me zë të ulët "Po nisem familjarisht". Më nguli sytë një çast, pastaj më ktheu kurrizin dhe u zhduk te dera në fund. Mbas pak erdhi me dy kuti me ngjyra të ndezura e mi dha pa asnjë fjalë. Pagova dhe ika.

Kur u ktheva në shtëpi gjeta Engjëllin, kushëririn që kish filluar punën. Për fat na u ndodhën ca dërrasa. Me ato bëri arkat për plaçkat e për librat.

Në atë bodrum jetuam plot 20 vjet.



Dy fjalë për romanin "Grabjani rrëzë kodrave" të Lekë Tasit

FUQIA SUGJESTIONUESE, BINDËSE DHE PURIFIKONJËSE E NJË ROMANI

nga Petro Zheji

Janë shkruar edhe të tjera dëshmira letrare mbi vuajtjet e popullit tonë ndën Komunizëm. Po ky tregim i gjatë, në trajtë ditari, ka diçka të veçantë.

Autori është vetë një nga personazhet, që vuan edhe ai si shumë e shumë të tjerë dënimin e padrejtë të një internimi çnjerëzor që kapërcen kufijtë e çdo imagjinate të mundshme dhe që jepet me një kthjelltësi e konkretësi të mahnitëshme në një varg skenash e episodesh rrëqethëse, me të gjitha ngjyrat e mugëta të një ferri dantesk. Autori nuk mjaftohet me një përshkrim fizik të ngjarjeve po kërkon e zbulon në analizat e tij të gjata, të kujdesshme, të thella e të hollësishme psikologjike, politike, fillosofike rrënjët e fshehta që i motivojnë. Dhe, falë një stili të shtruar e të qetë si ai i një shkencëtari që heton me durim, kërrusur mbi mikroskopin e tij, viruset e sëmundjes, e bën edhe lexonjësin të kuptojë, të shohë, të prekë, të marrë pjesë shpirtërisht në gjithçka. Në këtë e ndihmon, dhe jo pak sipas mendimit tim, edhe familjariteti i tij me pikurën që i lejon të përkthejë më lehtësi në një gjuhë tabllorash, simetrrirash, prospektivash dhe ngjyrash të gjitha ato mbi sa ndalet, me një zemërshtrengim të dhimbshëm, me një kureshtje pothuajse të "sëmure", vëmendja e tij e palodhur dhe syri i tij i mprehtë.

Asnjë nga të dënuarit nuk e di veten fajtor, në mos qoftë thjesht e vetëm fakti i të qënurit krejt i pafajshëm sipas Drejtësisë, sipas Zotit, por jo veç sipas Padrejtësisë që qeveriste vendin, sipas djallit, "la bestia feroce trionfante", të cilit duket se është dhënë (edhe s' dihet për sa kohë akoma...) një pushtet i pakufishëm.

Ka pasazhe në roman kaq të nginjura me poezi, sa mund të vështrohen si sprova të një virtuoizmi poetik të rrallë. Dhimbja shkul ofshama Weltschmerz-i të pangushëllueshëm jo vetëm në planin shoqëror, por edhe në atë kozmik dhe metafizik.

Shfaqet para nesh, si në një fazmatagori të frikshme, një galeri personazhesh mjeshtërisht të skalitur, që japin e marrin ditë e natë në një dyluftim të rrezikshëm dhe të pabarabartë me djallin, duke u përpjekur të shpëtojnë jetën e tyre, dhe më shumë se jetën, dhe më shumë se çdo gjë tjetër, shpirtin e tyre të pavdekshëm. Thotë Krishti në Ungjill: "E ç' i vlen njeriut sikur të fitojë qoftë edhe tërë botën, por të humbasë shpirtin e tij?" Dhe sa e vështirë, sa ishte pothuajse e pamundur të mos e linje të shuhej atë shkëndijë qiellore në atë kaos Ferri ku i Ligu, përmes përfaqësuesve të tij të tejzëllshëm (njerëz të Sigurimit, spiunë, provokatorë, shkurt një ushtri e tërë me pleh njerëzor të këtij lloji...) thurte rrjetat, ngrinte i palodhur, me një mendjepjellori të pashterrshme, grackat e tij dinake, të holla, të paparashikueshme, kjo pikërisht përbën një nga temat qendrore të romanit, të cilës Autori i kushton një përqendrim të veçantë.

Fjala e tij shndërron si një shkop magjik gjithçka prek në ar poetik. Prania dhe pjesëmarrja e tij thuhet mbinjerëzore, si ajo e një shenjti, në të gjitha vuajtjet e imagjinueshme dhe të paimagjinueshme, të cilave u nënshtrohen shokët e tij fatkeq të internimit është kaq e gjallë, kaq thellësisht e ndërë dhe e vërtetë dhe kaq komunikuese, sa pas leximit të romanit, të këtij procesverbalit krimesh të padëgjua të kryera pas mburojës së ligjit mbi viktimat krejt të pambrojtura, si dhe të pasojave të tyre katastrofale psikologjike, s' qendron dot më indiferent dhe pasiv ndaj së Keqes në botë, ndaj asaj që Leopardi e quante në terma poetikë "...il brutto Poter che ascoso, a comun danno impera..." Ndjën se diçka ka lëvizur, se diçka ka ndryshuar për të mirë në thellësinë e shpirtin tënd. Kaq e madhe është fuqia sugjestionuese, bindëse dhe purifikonjëse e këtij shkrimi.

In memoriam 174 vjet nga lindja

POETI MIHAI EMINESCU (1850-1889)

Përgatiti dhe përktheu nga origjinali rumanisht:

Dr. Luan Topçiu

Mihai Eminescu, poet, gazetar, prozator, mendimtar i shquar rumun, lindi më 15 janar 1850 në Botoshani ose Ipotesti dhe vdiq më 15 qershor 1889 në Bukuresht.

Eminescu konsiderohet poeti kombëtar i Rumanisë dhe studiuesit e kanë quajtur „ndriçuesi i poezisë rumune” si dhe përfaqësuesin më të rëndësishëm të romantizmit në letërsinë rumune.

Në vitin 1861 u regjistrua në Obergymnasium në Chernivt, një shkollë në gjuhën gjermane. Viti 1866 është viti i botimeve të para letrare të Eminescu-t.

Kur mësuesi i tij i gjuhës rumune, Aron Pumnul, vdes në janarin e atij viti, nxënësit botuan një broshurë për nder të tij, në të cilën bënte pjesë edhe poema e Mihai Eminescut „La mormântul lui Aron Pumnul/ Në varrin e Aron Pumnul-it”. Më 25 shkurt, Iosif Vulcan i boton në revistën në gjuhën rumune „Familia”, në Pest të Hungarisë dhe më pas i ndryshoi emrin në atë letrar: **Mihai Eminescu**.

Gjatë viteve 1869 - 1872 Eminescu ishte student në Vjenë, ku ndoqi Fakultetin Filozofik dhe Juridik. Ai ishte aktiv në shoqëritë studentore, kohë gjatë së cilës miqësohet me shkrimtarin tjetër rumun, Ioan Slavici, dhe takohet me të dashurën e tij, që do të ishte edhe dhe muza e tij, Veronica Micle. Fillon bashkëpunimin me revistën e njohur „Convorbiri literare” dhe debuton si publicist në gazetën „Albina/Bleta” që dilte në Pest të Hungarisë. Në periudhën 1872-1874 vazhdoi studimet në Berlin. Gjatë viteve 1874 - 1877 ishte drejtor i Bibliotekës Qendrore, mësues, inspektor arsimit për qarqet Jashi dhe Vaslui, redaktor i gazetës „Curierul” që dilte në qytetin e Jashit. Vazhdoi të shkruante për revistën „Convorbiri literare” dhe në këtë kohë njihet me prozatorin më të madh klasik rumun, Ion Creangă.

Në vitin 1877 shpërngulet në Bukuresht, ku deri në vitin 1883 ishte redaktor, dhe më pas kryeredaktor i gazetës „Timpul/Koha”. Gjatë kësaj periudhe ai shkruan poemat e tij më të njohura: „Luceafărul/Ylli i mëngjesit” dhe „Scrisorile/Letrat”, duke u bërë poeti më i njohur për rumunët. Në kulmin e veprimtarisë dhe krijimtarisë së tij, shëndeti i përkeqësohet, sëmuret rëndë dhe shtrohet në spital. Në dhjetor 1883 botohet një vëllim me poezi të Eminescut të zgjedhura nga Titu Maiorescu, një personalitet i kohës. Duke vuajtur për disa vjet resht nga sindromi depresiv, Eminescu ndërron jetë në moshën 39 vjeçare. Rrethanat e sëmundjes dhe vdekjes së tij nuk janë sqaruar plotësisht as sot e kësaj dite.

Mihai Eminescu ishte i pari që e ktheu gjuhën rumune në një objekt të vërtetë arti, në kushtet kur poezia rumune, e pasigurt, ishte në përçapjet e para të saj drejt formësimit.



Përmes kompleksitetit të njohurive të grumbulluara në filozofi, drejtësi, mjekësi, duke treguar interes edhe për ekonominë, sociologjinë apo disiplinën të tjera, ndonjëse nuk arriti të marrë një diplomë universitare, Eminescu pati një sukses të vërtetë në karrierën e tij, jo vetëm si poet, por edhe si gazetar, përmes botimit të artikujve kritikë për letërsinë, shoqërinë, politikën në gazetën „Timpul” dhe „Curierul” të Jashit si dhe në organe të tjera. Vdekja e parakohshme ndërpreu ngritjen e një talenti që kishte arritur pjekurinë e krijimit të tij. Megjithatë, vepra e tij poetike e vendos Eminescu-n si një ndër përfaqësuesit kryesorë të romantizmit europian. Shumë vite pas vdekjes, më 1948, u zgjodh anëtar i Akademisë Rumune më 28 tetor 1948.

Gjatë periudhës komuniste, figura e Eminescu-t, i cili vazhdoi të mbetet një simbol kombëtar, u përdor intensivisht për qëllime të propagandës nacionaliste komuniste. U portretizua ekskluzivisht si një poet i përsosur, ndërkohë që shkrimet e tij filozofike dhe politike u marginalizuan për përmbajtjen e tyre, ndonjëherë radikale. Gazetaria politike e Eminescu-t mund të konsiderohet si „modeli më i mirë i shkollës së gazetarisë kombëtare”.

Për të lehtësuar njohjen dhe studimin më mirë të veprës së Eminescu-t, Akademia Rumune ka botuar vëllime me faksimile të veprave të tij të plota (23 vëllime)

Në vitin kur ndërroi jetë Eminescu, do të lindte një alter ego i tij në poezinë ballkanike, poeti shqiptar, Lasgush Poradeci. Është një përkim që të bën të mendosh për misterin e rastësive, emigrimin e shpirtave, duke pasur parasysh marrëdhëniet e posaçme të poetit shqiptar me veprën e poetit të madh rumun, vepër e cila i shërbeu si model kulturor, estetik dhe modelues. Ditëlindja e poetit, 15 janari, është shpallur dita kombëtare e kulturës rumune. Çmimi letrar „Mihai Eminescu” është më prestigjiozi në Rumani, çmim të cilin e ka marrë dhe një autor shqiptar. Poeti Mihai Eminescu ka qenë dhe mbetet i dashur për lëçitësit shqiptarë falë disa botimeve në Bukuresht, Tiranë dhe në Prishtinë.

Mihai Eminescu 14 POEZI

Lutje

Zonjë e bekuar gjithë mirësi
të lutem me përlulësi,
Na shpëto, lartësona ne
Me val'n e fanitje-ve:
Bëhu mburojë forcimi
Bëhu mur shpëtimi,
Vështrimi i çmuar
Zbrit-na në krahëruar,
Oh, nënë dëlirësie,
Virgjëreshë përjetësie,
Marie!

Ne, nga mëshira e hyjit
I bëjmë tokës hije,
Me dhembshuri të lutjeve,
Ylli i mëngjesit të deteve;
Rënkimet tona - në veshë,
Mbi ëngjëj Mbretëreshë,
Nga mjegulla shfaqesh,
Pah i ëmbël, i qashtë
Oh, nënë dëlirësie,
Virgjëreshë përjetësie,
Marie!

O, nënë...

O, nënë, nënë ëmbël, prej kohës q'u
shprish
Me fërmim fletësh drejt teje ti më grish;
E përmi kriptën e zezë të t' shenjtit varr
Shungullojnë akaciet nga era plot acar,
E bjenë ngadalë nga degët, zëri yt pikon
Gjithë do të bjenë, e ti do flesh gjithmon'.

Kur të vdes, o vashë, mi krye mos më qaj;
Nga i shenjt i ynë blir një degëzë na e ndaj,
Mi kokën time mbill degë të më mbulojnë
Mbi to lotët e valë nga sytë të vezullojnë;
Do ndjej un' andaj një hije mbi varrin tim...
Gjithjet' të rritet hija dhe un'do fle pa
zgjim.

Edhe në është e thënë që bashkë të
vdesim;
N'murishte varresh s'dua që të mbesim,
T'na hapin një vednth në bregun e një lumi
E tok le të na vënë në një zgavër qivuri,
E përgjithmonë ngjatë gjirit do të kem...
Prore uji do të qajë, ne prore do të flem'

Glossa

Kohë shkon, kohë vjen
Gjithë të vjetra, të reja gjen
Ç'është keq dhe ç'është mirë
Veten Pyet, fjalën pesho;
Mos u tut e mos shpreso,
Ç'është valë si valë do shkojë;
Në të grish mos u tundo
Rri mënjanes, mos u miklo.

Shumë gjëra ndodhin në dritë,
Kumbimet veshi përsërit,
Kush mban mend gjithçka
E pse t'i dëgjojë, pra?...
Ti kithët qëndro ashtu veçan
Ruaj qetinë që brenda mban
Kur zhurma të kota ndjen
Kohë shkon, kohë vjen.

As gjuha nuk epohet e s'lot
E peshores së mendimit t'fot
Drejt çastit të ndryshimit
Për maskën e gazmimit,
Që nga vdekja lind e re
Dhe ndoshta zgjat aq pak;
Për ata që dinë sadopak
Gjithë e vjetër, gjithë e re.

Spektator si në teatër
Ti në botë veten fytyro:

Luan njëri sa për katër,
Fytyrën e tij ti dallo,
Dhe kur qahet apo grindet,
Ti nqoshe ndihu dëlirë
Dhe kupto lojën e tyre
Ç'është e keqe a e mirë.

Çdo e shkuar dhe e ardhme
Të një flete janë dy faqe,
Në fund sheh dhe nistimin
Kush di të nxejë mësimin;
Gjithë ç'ka qenë e do jetë
Tash të gjitha janë në jetë,
Por për kotësinë në to
Pyet veten, fjalët pesho.

Mjetet e njëjta përher' janë
Që përher' nështronjë gjithçkanë,
Dhe prej mijëra vjetësh plot
Botë e lumtur, trishtim i kot';
Maska të tjera, pjes' e njëjtë,
Gojë të tjera, e njëjta këngë,
I zhgënjuar nga kaq gjemë
Mos shpreso dhe mos u trëmb.

Mos shpreso nga të paudhët
Në fitore lidhin urat
Fundërinat ta hedhin shpesh
Dhe me yll në ballë të jesh;
Mos ki frikë, do vijnë vërdallë
Të kashtosen sa janë gjallë
Por ti zemrën se hidhëron
Se është valë, e vala shkon.

Me një këngë prej sirene,
Rrjeta pahu bota shtrin;
Të ndryshojnë-aktorët-n'skenë,
Të josh fort në shakullin;
Ty hileqarët të braktisin
Madje mos iu hidh kashtë
Nga shtegu yt jashtë
Të tundojnë e të grishin.

Në të prekin, bëj mënjane,
Në të fyejnë, ti gojën mbylle;
Ç' do nga kësoj këshille,
Nëse e di masën e tyre;
Thonë atë ç'kan' për të thënë,
Ia kalojnë botës kush e di;
Të mos duash asgjënë,
Ndaj gjithçkaje mënjanes rri.

Ndaj gjithçkaje mënjanes rri,
Që të grish mos u tundo
Ç'është valë si valë do shkojë;
Mos u tut e mos shpreso;
Pyet veten, verbin pesho;
Ç'është e keqe dhe e mirë;
Gjithë të vjetra të reja gjen
Kohë kalon, kohë vjen.

Pse përkundesh ...

(me frymë popullore)

Pse përkundesh, korije,
Pa fryrë erë e pa rënë shi,
degët gjer në dhë ti?

— Pse të mos përkundem, pse,
Kur shkon koha dhe më le!
Dita shkon, nata zgjatohet,
Gjethi i rrallë zverdhëllohet.
Era fletët shkundërmon,
zogjtë e mi larg m'i çon
Era fryn më njëren anë, -
Dimër këtu, verë matanë.
Dhe pse mos epohem pak,
Të shoh zogjtë varg e varg.
Përmbi maja bisqesh larushe,
Shkojnë tufëza dallandyshe,
Me mendimet levorashe,
Bashkë me shortin tim të shkretë.
Edhe shkojnë në të përpjetë!
Horizontit nxirë si hije,

Shkojnë si çaste përjetësie,
Flatrat shkunden me pikëllim
E më lënë me shpirt jetim
fillikat me mallin tim,
Firuar dhe të mpirë,
Veç me vajin tim të nxirë.

Sa herë e dashur...

Sa herë, e dashur, ndërmend të sjell, sa herë
Oqeani prej akulli më del para sysh përherë:
N'kupën e qiellit zbardhëlluar – pa shenja yllëshish,
Hënë e zbeht' ngadalë zë fashitet prej magjish;
Kur rrjedhin përmbi valë akuj papushuar,
Një shpend i arratisur shtegton i përvëluar,
Se shoqja e tij pat humbur tutje, në mërgim
Me zogjtë e tjerë, tufëz që shkoi n'perëndim,
Vështrime vuajtjeplot pa hedh në përjetësi,
As keq më s'i vjen, as mirë jo ... po vdes tani,
duke ëndërruar vitet që lamë, një çast me lot.
.....

Jemi gjithë larg e gjithë më larg të dy sot,
E gjithë më i vetmuar po ngrysem edhe ngrij,
Kur në përjetësinë e agut humbet e zhdukesh ti.

Përse nuk vjen?

Shih, dallëndyshet, gjithë rrallohen
Gjethet e arrës shkundojohen,
Mbi vreshta bryma zë mbulon-
përse nuk vjen, përse vonon?

Eja në krahë të të mbaj gjallë
Të të kundroj me shumë mall,
dhe t'i vë kryet krejt pa mend
mbi gjirin tënd, mbi gjoksin tënd!

A të kujtohet qysh atëherë,
Lëndinave barisnim shënd e verë,
kur unë të ngrija pendë në erë
aq shumë herë, aq shumë herë!

Në k'të botë vasha plot gëzojnë
që sytë iskra u brambullojnë
Por qofshin t'ëmblla ato gra,
Si ti nuk ka, si ti nuk ka!

Se e ffillon ti gjithëherë
Jetën e shpirtit tim përzjerë,
Përmbi çdo yll ke bukuri
E dashur moj, moj zemër ti!

Vjeshtë e vonë është gjithkund,
Udhëve gjethet po i shkund
Dhe lëmi është veç shkreti...
përse nuk vjen, pse nuk vjen ti?

Kam të vetmin mall

Kam të vetmin mall:
Në natëzën e qetë
Më lini të vdes në zall
Të një deti të shkretë;

Ta kem gjumin e lehtë
Dhe korijen ta kem pranë,
E mbi ujët e paanë
Një qiell pa re të jetë.

Nuk dua flamuj më kot,
As stoli dhe arkëmort,
Veçse thurmëni një shtrat
Me purteka dhe bistakë.

Pas vdekjes sime askush,
Mbi krye të mos më qajë,
Të veniturën gjethnajë.
Vjeshta me zë ta mbush'.

Të vërshojnë me buçima
Krojet me gurgullima,
Hëna lehtas të rrëshqasë,
Kreshtave bredhash të gjatë.

E natëzës puhi
T'i ledhatojë këmborët,
Mbi mua i shenjtë bli
T'i hedhë deg'zat therorë

Nuk do jem më mërgimtar
Prej saore dhe më pas,
E kujtimet palë-palë
do t'më vijnë valë-valë.

Edhe ylli i mëngjesit
N'hije bredhash do të dalë
E si miqësi njerëzish,
Do më buzëqeshë prapë.

Do rënkojnë vuajtjesh therëse
Këngën e detit buçimlartë
Kur do t'jem i bërë baltë
Në vetminë e përhershme.

Liqeri

Liqer i kaltër mes korijesh
me zambak' plot bukuri;
dridhen në rrrathë bardhoshë
Përkundin lehtas një gjemi.

Dhe endem bregut rreth-e-qark,
Sikur dëgjoj e pres ç'të jetë,
Ajo t'ia behë prej kallamash
Të prehet mbi gjoksin tim të nxehtë;

Të hipim lundrës levorashe,
Nga zëra ujërash fashe-fashe,
Të shkasë direku ndër gjeratore
Të më shpëtojnë lopatat dore;

Të lundrojmë magjiplot
Nën pahun hënor të mbëmjes-;
Puhiza ndër kallama të shkojë,
Vala të tingëllojë mes ëndjes! -

Por ajo s'vjen... I vetmuar
Psherëtij dhe më zjen gjaku,
Ndanë liqerit kaltërosh
Mbushur plot lule zambaku.

Dëshira

Eja në lirishtë tek burimi
Nën dhë buron dhe drithërimi
Aty ku harliset bari në hulli
E degët falen plot fshehtësi

Dhe në krahët e mi të hapur
Vrapo e bjerë në gjoksin tim,

Të ta heq vellon sa më parë
Të të shoh, moj, s'kam durim.

Do të ulesh ndër gjunjët e mi,
Do të jemi gjithë vetëm, plot magji
Dhe në flokët ngjyrë floriri
Do të të bien lule bliri

Balli borë, flokë shpupurisës
Krahu im aq gjumëgrishës,
Mbetur pre e gojës sate
Ah! Buzët e tua të ëmblla zgjate

Ramë në njëëndërr lumturie,
Në këngë të lartë prej magjie
E burimeve të vetmuara,
Fryrja e flladeve të praruara;

Duke fjetur në harmoninë
E korijes plot mendime
Lule bliri do të bien
sipër nesh fije-fije.

I humbur në vuajtje

I humbur në përvuajtjen e asgjësë sime,
Si gjethja nër ujëra, si rrufeja në
pështjellime,
U përkula si magu para diellit dhe yjeve
Të më lejojnë hyrjen në prehjen e
përjetshme;
Nga hija e jetës sime asgjë mos regëtitijë,
Të kaloj si një frymë, një tingull, një
shkëndijë,
Si loti që derdh kot një femër ashtu.
Mendja ime është një skelë ëndrrash
kuturu.

Ç'është poeti n'botë, ç'është sot poeti
vallë?
Kushdo dëgjon zërin e tij në vetminë e
gjallë.
E panjohura rrëshqet si shkazmë botës
ngadalë
Dhe askush nuk pyet se ç'ishte a nesër ç'do
të dalë
Një shkulum prej shkumbe, një krelë dallge,
një emër
Sa i ndrojtur njeriu në këtë shekull krejt
hekur.
Do të ishte më mirë të mos kish qenë kurrë
në bot'
Dhe të kishte vdekur se sa të vdiste sot.

Tek ylli

Der tek ylli që agon
Udha është kaq e gjatë.
Mijëra vite udhëton
Pahu i dritës të na kapë.

Mbase u shua kahmot
Në largësitë blu,
Por-rrezja e tij veç sot
Sytë na ndezi këtu

Ikon' e yllit të mbramë,
Në qiell ngrihet gjithë jet',
Ishte kur nuk e pamë
Dhe është kur s'është vërtet.

Kështu ndodh dhe kur mungon, -
Shuar në natën e thellë,
Drita e dashurisë tonë,
Na ndjek, na ndjek përherë.

Zogj të përgjumur

Zogj të përgjumur
Në folenë e ngrirë
Gjethnajës struktur -
Natën e mirë!

Veç kroji psherëtin,
Drurët nxijnë nër parqë;
Lulet heshtin n'ëndërrim
Fli në paqe!

Mjellma ujërat çan
Kallamash gjumi e pret-
Ëngjëjt të qofshin pranë
Gjumë të lehtë!

Natë plot magji
Ç'flori hëne i shkrirë.
Kaq ëndërr dhe harmoni -
Natën e mirë

Në pyll ajo ndjek shtegun e saj

Në pyll ajo ndjek shtegun e saj,
Unë shkoj pas gjurmëve me brymë.
Kur fare pranë e arrij pastaj
Mezi marr frymë.

Unë frymë marr edhe një herë,
Një fjalë them dhe ajo dridhet
Vështrimin hedh nëpër erë
Dhe dot nuk më përgjigjet.

Por unë afrohem si me zor
Dhe s'di se ç'flas ashtu përçart;
Ajo më shtyn lehtë me dorë
Dhe shikon anash, poshtë, lart.

Te beli i saj krahët vë unë,
Ajo hepohet, bën mënjanë,
Pranë vetes e afrojmë shumë,
Më pranë, gjithë më pranë.

S'e di a do të vazhdoj,
Kokën i vë mbi supe
Me sytë mbyllur i ngjesh në gojë,
Të panumërtat puthje.

Në gjoks fort e mbaj shtrënguar.
Më meket fryma, oh!
E pyes pse është e trishtuar,
E pyes pse më do.

Sytë madhoshë, me dritën qelq
Lundruet hap me ëmbëlsi:
Dhe pse ndonjëherë je i keq
Të dua me zemër, në thellësi.

Dhe nëse degët bien në xham

Dhe nëse degët bien në xham
Dhe dridhërohen plepat,
Sepse në mendje unë të kam
Dhe më avitesh lehtas.

Dhe nëse yjet ndrijnë në liqer
Duke e ndritur për së thelli,
T'më ëmbëlsojnë tër' atë vrer
Dhe mendjen t'ma kthjelli

Dhe nëse retë mërgohen
Ndërsa llamburit hëna,
Ndodh që të kujtohem
Për ty - e ëndërrta.




1

Arti i biografisë, themi, por sakaq pyesim, a është biografia art? Pyetja është ndoshta marrëzi ta bësh, dhe sigurisht nuk është bujare, po të kemi parasysh kënaqësinë e madhe që na kanë dhënë biografët. Por pyetja bëhet vetvetiu kaq shpesh sa duhet të ketë diçka. Ajo diçka është aty sa herë hapet një biografi e re, e cila hedh hijen e saj në faqet e një libri; dhe duket se ka diçka vdekjeprurëse në atë hije, sepse në fund të fundit, nga moria e jetëve për të cilat janë shkruar, sa pak mbijetojnë!

Por arsyeja për këtë shkallë të lartë të vdekjeve, mund të argumentojë biografi, është se biografia, krahasuar me artet e poezisë dhe të prozës letrare, është art i ri. Interesi për veten tonë dhe për njerëzit e tjerë është një zhvillim i vonshëm i mendjes njerëzore. Në Angli, kjo kureshtje për të shkruar për jetën vetjake të njerëzve nuk gjeti shprehje deri deri në shekullin e tetëmbëdhjetë. Vetëm në shekullin e nëntëmbëdhjetë biografia u rrit plotësisht dhe ishte jashtëzakonisht e begatë. Nëse është e vërtetë se ka pasur vetëm tre biografë të mëdhenj - Johnson, Boswell dhe Lockhart - arsyeja, argumenton biografi, është koha e shkurtër; dhe shfaqja është se arti i biografisë ka pasur vetëm pak kohë për t'u krijuar dhe zhvilluar, dhe kjo vërtetohet nga tekstet shkollorë. Sado joshëse të jetë për të zbuluar arsyen, çështjen e pazgjidhshme se pse vetja që shkruan një libër në prozë u krijua kaq shumë shekuj pas asaj që shkruan një poezi, pse Chaucer-i i parapriu Henry James-it, është më mirë ta lëmë mënjanë, dhe të kalojmë në arsyetimin e radhës për mungesën e kryeveprave. Kjo ka ndodhur sepse arti i biografisë është më i kufizuari nga të gjitha artet. Dhe biografi e ka provën gati. Ja ku është në parathënien në të cilën Smith-i, i cili ka shkruar për jetën e Jones, përfiton nga rasti për të falënderuar miqtë e vjetër që i kanë dhënë letra hua, dhe "e fundit por jo më pak e rëndësishme" zonjën Jones, të venë, për ndihmën "pa të cilën", siç thotë ai, "kjo biografi nuk mund të ishte shkruar". "Romancierit", thekson ai, "thjesht shkruan në faqen e parë: "Çdo personazh në këtë libër është i trilluar". Romancierit është i lirë; biografi është i lidhur.

Tek kjo pikë, ndoshta i afrohem asaj çështjeje shumë të vështirë, përsëri ndoshta të pazgjidhshme: Çfarë nënkuptojmë duke e quajtur një libër vepër arti? Në çdo rast, ka një dallim midis biografisë dhe prozës së trilluar - një dëshmi se ato ndryshojnë në vetë lëndën nga e cila janë bërë. Njëra krijohet me ndihmën e miqve, të fakteve; tjetra krijohet pa asnjë kufizim, përveç atyre që artisti, për arsye që i duken të mira, zgjedh t'i zbatoj. Ky është një dallim; dhe ka arsye të fortë për të menduar se në të kaluarën biografët nuk kanë arritur ta kuptojnë këtë dallim. Është vetëm një dallim, por shumë i madh. E veja dhe miqtë kishin një detyrë të vështirë. Hamendësoni për shembull, që njeriu gjenial ishte imoral, me temperament të keq dhe ia ka flakur çizmet kokës shërbëtores. E veja do të thoshte: "Megjithatë e doja - ai ishte babai i fëmijëve të mi; dhe publiku, që i do librat e tij, nuk duhet në asnjë mënyrë të zhgënjehet. Shmange këtë detja; hiqe". Biografi i bindet. Dhe kështu, shumica e biografive të periudhës viktoriane janë si figurat prej dylli të ruajtura tani në Westminster Abbey, të cilat në ceremoni mortore kanë thjesht një ngjashmëri sipërfaqësore me trupin në arkemort.

Pastaj, nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, ndodhi një ndryshim. Përsëri, për arsye jo të lehta për t'u zbuluar, veçshat u bënë me mendjehapura, publiku më largpamës; shëmbëlltyrat nuk ishin më bindëse dhe nuk ngjallnin kureshtje. Biografi sigurisht fitoi njëfarë lirie. Të paktën mund të linte të kuptohej se kishte plagë dhe



Virginia Woolf

ARTI I BIOGRAFISË

Përktheu: Granit Zela

shenja në fytyrën e të vdekurit. Biografia e James Anthony Fraude për Thomas Carlyle-in nuk është aspak një maskë dylli e Iyer me të ngjyrë rozë. Dhe pas Froude-s ishte Sir Edmund Gosse, i cili guxoi të thoshte se i ati ishte një genie njerëzore që gabonte. Dhe pas Edmund Gosse-s në vitet e para të shekullit të njëzet erdhi Lytton Strachey.

2

Figura e Lytton Strachey-t është kaq e rëndësishme në historinë e biografisë, sa që na detyron të ndalemi. Tre librat e tij të famshëm, *Viktorianë të shquar*, *Mbretëresha Viktoria* si dhe *Elizabeta dhe Ekesi*, janë të një niveli për të treguar se çfarë mund të bëjë dhe çfarë nuk mund të bëjë biografia. Ato sugjerojnë shumë përgjigje të mundshme për pyetjen nëse biografia është art, dhe nëse jo, pse nuk arrin të jetë. Lytton Strachey lindi si autor në një moment me fat. Në vitin 1918, kur bëri përpjekjen e parë, biografia, me liritë e saj të reja, ishte një formë shumë tërheqëse. Për një shkrimtar si ai, i cili kishte dashur të shkruante poezi ose drama, por dyshonte për fuqinë e tij krijuese, biografia dukej se ofronte një alternativë premtuese. Sepse më në fund ishte e mundur të thuhej e vërteta për të vdekurit; dhe epoka viktoriane ishte e pasur me figura të jashtëzakonshme, shumë prej të cilave ishin shformuar rëndë nga shëmbëlltyrat që ishin stampuar mbi to. T'i rikrijoje, t'i tregoje ashtu siç ishin në të vërtetë, ishte një detyrë që kërkonte dhunti të ngjashme me ato të poetit ose

të saj. Në *Elizabeta* e trajtoi biografinë si një art; i shpërfilli kufizimet e saj.

Por ne duhet të vazhdojmë të pyesim se si kemi arritur në këtë përfundim dhe në cilat arsye e mbështesim. Në radhë të parë është e qartë se dy mbretëreshat paraqesin probleme shumë të ndryshme për biografën e tyre. Rreth Mbretëreshës Viktoria dihej gjithçka që ajo bënte, pothuajse gjithçka që mendonte, ishin njohuri të përgjithshme. Askush nuk i kishte verifikuar dhe vërtetuar nga afër. Biografi nuk mund të shpikte, sepse në çdo moment ishte pranë ndonjë dokumenti për të kontrolluar shpikjen e tij. Dhe, duke shkruar për Viktorian, Lytton Strachey iu nënshtrua kushteve. Ai përdori plotësisht fuqinë e përzgjedhjes dhe marrëdhënies së biografit, por e mbajti rreptësisht brenda botës së fakteve. Çdo pohim u verifikua; çdo fakt u vërtetua. Dhe rezultati është një jetë që, me shumë mundësi, do të bëjë për mbretëreshën e vjetër atë që bëri Boswell-i për krijuesin e vjetër të fjalorit. Me kalimin e kohës, Mbretëresha Viktoria e Lytton Strachey-t do të jetë Mbretëresha Viktoria, ashtu siç Johnson-i e Boswell-it është tani Dr. Johnson-i. Versionet e tjera do të zbehen dhe zhduken. Ishte një sukses i jashtëzakonshëm dhe pa dyshim, pasi e kishte arritur, autori ishte në ankth për të vazhduar më tej. A nuk mundet biografia të krijojë diçka nga intensiteti i poezisë, diçka nga emocioni i dramës, e megjithatë të ruajë edhe virtytin e veçantë që i përket faktit, realitetin sugjestionues, krijimtarinë e duhur?

Mbretëresha Elizabetë dukej se ishte e përkryer për eksperimentin. Shumë pak dihej për të. Shoqëria në të cilën jetonte ishte aq e largët sa zakonet, motivet, madje edhe veprimet e njerëzve të asaj epoqe ishin plot çudi dhe gjëra të pandriçuar. "Me çfarë arti do të depërtojmë në ato shpirta të çuditshëm? Sa më qartë ta perceptojmë, aq më i largët bëhet ai univers i mëvetshëm," tha Lytton Strachey në një nga faqet e para. Megjithatë, ishte dukshëm një "histori tragjike" e fjetur, gjysmë e zbuluar, gjysmë e fshehur, në historinë e *Mbretëreshës dhe Ekesit*. Gjithçka dukej se i përshtatej krijimit të një libri që kombinonte përparësitë e të dy botëve, që i jepnin artistit lirinë për të shpikur, por e ndihmoi shpikjen me mbështetjen e fakteve - një libër që ishte jo vetëm një biografi, por edhe vepër arti. Megjithatë, kombinimi doli i papërshtatshëm; fakti dhe trillimi nuk pranuan të përzihen. Elizabeta nuk u bë kurrë reale në kuptimin që Mbretëresha Viktoria kishte qenë reale, megjithatë ajo kurrë nuk u bë e trilluar në kuptimin që Kleopatra ose Falstafi janë të trilluar. Arsyeja duket të jetë se dihej shumë pak - atij iu kërkua të shpikte; megjithatë diçka dihej - shpikja e tij u kontrollua. Kështu, Mbretëresha lëviz në një botë të paqartë, mes faktit dhe trillimit, as të mishëruar e as të trupëzuar. Ka një ndjenjë zbrastëie dhe përpjekjeje, një tragjedi që nuk ka krizë, të personazheve që takohen, por nuk përplasen.

Nëse kjo diagnozë është e vërtetë, jemi të detyruar të themi se problemi qëndron tek vetë biografia. Ajo imponon kushte dhe ato kushte janë që vepra duhet të mbështetet në fakte. Dhe me fakt në biografi nënkuptojmë fakte që mund të verifikohen nga persona të tjerë përveç artistit. Nëse ai shpik fakte siç i shpik një artist - fakte që askush tjetër nuk mund t'i verifikojë - dhe përpiqet t'i kombinojë me fakte të llojit tjetër, ato shkatërrojnë njëri-tjetrin.

Vetë Lytton Strachey duket se në *Mbretëresha Viktoria* e ka kuptuar domosdoshmërinë e kësaj gjendjeje dhe i është dorëzuar në mënyrë instiktive. "Dyzet e dy vitet e para të jetës së mbretëreshës," shkroi ai, "përdriten nga një sasi e madhe dhe e larmishme informacioni autentik. Me vdekjen e Albertit ngihet një perde.

të romancierit, por nuk kërkonte atë fuqi krijuese ku ai e pa veten të mangët. Ia vlente të provohej. Dhe zemërimi dhe interesi që zgjuan studimet e tij të shkurtra për viktorianët e shquar treguan se ai ishte në gjendje të bënte Olivia Manning-un, Florence Nightingalein, Gordon-in dhe të tjerët të jetonin ashtu siç kishin jetuar që kur ishin prej mishi dhe gjaku. Edhe një herë ata ishin në qendër të një zhurme debati. A pinte vërtet Gordoni, apo ishte një shpikje? A kishte marrë Florence Nightingale Urdhrin e Meritës në dhomën e gjumit apo në dhomën e ndenjjes? Ai e nxiti publikun, edhe pse lufta europiane ishte ndezur, duke ngjallur një interes të mahnitshëm për çështje të tilla të vogla. Zemërimi dhe e qeshura përziheshin; dhe botimet u shumuan.

Por këto ishin studime të shkurtra me mbitheksimin dhe shkurtrimin që kanë karikaturat. Në jetën e dy mbretëreshave të mëdha, Elizabeta dhe Viktoria, ai ndërmori një detyrë shumë më ambicioze. Biografia nuk kishte pasur kurrë një shans më të madh për të treguar se çfarë mund të bënte. Sepse tani po vihej në provë nga një shkrimtar që ishte i aftë të përdorte të gjitha liritë që kishte fituar biografia: ishte i patrembur; kishte dëshmuar shkëlqimin e tij; dhe e kishte mësuar zanatin. Rezultati hedh dritë të madhe mbi natyrën e biografisë. Sepse kush mund të dyshojë pas leximit të dy librave përsëri, njëri pas tjetrit, se Viktoria është një sukses triumfues dhe se *Elizabeta* e krahasuar me të një dështim? Por duket gjithashtu, siç i krahasojmë, se nuk ishte Lytton Strachey ai që dështoi; ishte arti i biografisë. Në *Viktoria* ai e trajtoi biografinë si zanat; iu nënshtrua kufizimeve

Dhe kur me vdekjen e Albertit mbulesa u hoq dhe informacioni autentik nuk ishte real, ai e dinte se biografi duhet të ndiqte shembullin. "Duhet të mjaftohemi me një rrëfim të shkurtër dhe të përmbledhur," shkroi ai; dhe vitet e fundit janë asgjësuar shkurtimisht. Por e gjithë jeta e Elizabetës jetoi pas një perdeje shumë më të trashë se vitet e fundit të Viktorias. E megjithatë, duke shpërfillur pranimin e tij, ai vazhdoi të shkruajë, jo një rrëfim të shkurtër dhe të përmbledhur, por një libër të tërë për ata shpirtra të çuditshëm dhe madje edhe për trupa më të huaj për të cilët mungonte informacioni autentik. Sipas tij, përpjekja ishte e dënuar të dështonte.

3

Duket, pra, se kur biografi u ankua se ishte i lidhur nga miqtë, letrat dhe dokumentet, kishte vënë gishtin në një element të domosdoshëm të biografisë; dhe se ai është gjithashtu një kufizim i domosdoshëm. Sepse personazhi i shpikur jeton në një botë të lirë ku faktet verifikohen vetëm nga një person - vetë artisti. Autenticiteti i tyre mbështetet tek e vërteta e vizionit. Bota e krijuar nga ai vizion është më e rrallë, më intensive dhe më e plotë se bota që përbëhet kryesisht nga informacione autentike të ofruara nga njerëz të tjerë. Dhe për shkak të këtij dallimi dy llojet e fakteve nuk do të përzihen; nëse ndpdh ato shkatërrojnë njëri-tjetrin. Askush, si përfundim, nuk mund të bëjë më të mirën nga të dyja botët; duhet të zgjidhni dhe t'i përmbaheni zgjedhjes suaj.

Por edhe pse dështimi i *Elizabeta dhe Ekesi* të çon në këtë përfundim, ai dështim, për shkak se ishte rezultat i një eksperimenti të guximshëm të kryer me mjeshtëri madhështore, të çon në zbulime të mëtejshme. Po të kishte jetuar, Lytton Strachey pa dyshim që do të kishte eksploruar rrugën që ai kishte hapur. Ai na ka treguar rrugën në të cilën të tjerët mund të përparojnë. Biografi është i lidhur me faktet - por, nëse është kështu, ai ka të drejtë për të gjitha faktet që janë në dispozicion. Nëse Jones ia ka flakur çizmet në kokë shërbëtore, nëse kishte një dashnore në Islington, ose gjendej i dehur në një hendek pas shturjes së një nate, ai duhet të jetë i lirë të thotë kështu, të paktën siç e lejon ligji i shpifjes dhe ndjenjat njerëzore.

Por këto fakte nuk janë si faktet e shkencës - të cilat pasi zbulohen, janë gjithmonë të njëjta. Ato janë subjekt i ndryshimeve të opinionit; opinionet ndryshojnë me kalimin e kohës. Ajo që mendohej si mëkat, tashmë dihet, në dritën e fakteve të fituara për ne nga psikologët, mund të jetë ndoshta një fatkeqësi; ndoshta një kureshtje; mbase as njëra as tjetra, por një gjë e vogël e parëndësishme në një mënyrë apo në tjetrën. Theksi mbi seksin ka ndryshuar brenda kujtesës së gjallë. Kjo çon në shkatërrimin e një pjese të madhe të lëndës së vdekur që ende errëson tiparet e vërteta të fytyrës njerëzore. Shumë nga titujt e kapitujve të vjetër - jeta në kolegji, martesat, karriera - dalin të jenë dallime shumë arbitrare dhe artificiale. Rryma e vërtetë e ekzistencës së heroit mori, me shumë mundësi, një rrjedhë tjetër.

Kështu, biografi duhet të shkojë përpara në të tjerëve, si parlatmëruet i rrezikut, duke testuar atmosferën, duke zbuluar falsitetin, jorealitetin dhe praninë e konvencioneve të vjetruara. Ndjenja e së vërtetës duhet të jetë e gjallë. Përsëri, meqenëse jetojmë në një epokë kur një mijë kamera drejtohen nga gazetatat, letrat dhe ditarët, në çdo personazh nga çdo kënd shikimi, ai duhet të jetë i përgatitur të pranojë versione kundërtëne të së njëjtës fytyrë. Biografia do ta zgjerojë shtrirjen duke vendosur syzet

në qoshet e çuditshme. E megjithatë nga gjithë kjo diversitet ajo nuk do të nxjerrë një trazirë përshtjellimi, por një unitet më të madh. Dhe përsëri, meqenëse dihet aq shumë që dikur nuk dihej, pyetja tani në mënyrë të pashmangshme i shtrohet vetes, nëse duhet të regjistrohen vetëm jetët e njerëzve të mëdhenj. A nuk është dikush që ka jetuar një jetë dhe ka lënë një histori të asaj jete, i denjë për biografi - dështimet dhe sukseset, të përlulurit njësoj si të shquarit? Po çfarë është madhështia? E çfarë është vogëlsia? Duhet të rishikojmë standardet tona të meritës dhe të vendosim heronj të rinj për t'u admiruar.

4

Kështu, biografia është vetëm në fillim të karrierës së saj; mund të jemi të sigurt se ka një jetë të gjatë dhe aktive përpara, - një jetë plot vështrësi, rrezik dhe punë të palodhur. Sidoqoftë, mund të jemi të sigurt se është një jetë ndryshe nga jeta e poezisë dhe e trillimit - një jetë e jetuar në një shkallë më të ulët tensioni. Dhe për këtë arsye krijimet e saj nuk janë të destinuara për pavdekësinë që artisti e arrin herë pas here me krijimet e tij.

Duket se tashmë ka prova të sigurta për këtë. Edhe Dr. Johnson si i krijuar nga Boswell-i nuk do të jetojë aq gjatë sa Falstaff-i siç u krijua nga Shekspiri. Micawber dhe Miss Bates mund të jemi të sigurt se do t'i mbijetojnë Sër Walter Scott-it të Lockhart dhe Mbretëresha Viktoria e Lytton Strachey-t. Sepse janë bërë nga materie më të qëndrueshme. Imagjinata e artistit në momentin e saj më intensiv nxjerr atë që në fakt prishet; ndërton me atë që është e qëndrueshme; por biografi duhet të pranojë atë që prishet, të ndërtojë me të, ta fusë në strukturën e veprës së tij. Shumë do të humbasë; pak do të jetojë. Dhe kështu arrijmë në përfundimin, se ai është zejtar, jo artist; dhe vepra e tij nuk është një vepër arti, por diçka ndërmjet dhe në mes.

Megjithatë, në atë nivel më të ulët puna e biografit është e paçmuar; nuk mund ta falënderojmë aq sa duhet për atë që bën për ne. Sepse ne jemi të paafët të jetojmë tërësisht në botën intensive të imagjinatës. Imagjinata është aftësi që lodhet shpejt dhe ka nevojë për pushim dhe ripërtëritje. Por, për një imagjinatë të lodhur, ushqimi i duhur nuk është poezia inferiore apo trillimi i parëndësishëm - në të vërtetë ato e topitin dhe e shthurin - por fakti i matur, ai "informacioni autentik" nga i cili, siç na ka treguar Lytton Strachey, është bërë një biografi e mirë. Kur dhe ku ka jetuar njeriu i vërtetë; si dukej ai; ka veshur çizme me lidhëse apo jo; cilët ishin hallat dhe miqtë e tij; kë donte dhe si; dhe kur erdhi çasti për të vdekur, a vdiq në shtratin e tij si një i krishterë, apo...

Duke na treguar faktet e vërteta, duke shoshitur të voglën nga e madhja dhe duke i dhënë formë të tërës në mënyrë që ne ta perceptojmë të përmbledhur, biografi bën më shumë për të nxitur imagjinatën sesa çdo poet apo romancier, përveç më të mëdhenjve. Sepse pak poet dhe romancier janë të aftë për atë shkallë të lartë tensioni që na jep realiteti. Por pothuajse çdo biograf, nëse respekton faktet, mund të na japë shumë më tepër se një fakt tjetër për t'ia shtuar koleksionit tonë. Ai mund të na japë faktin krijues; faktin pjellor; faktin që sugjeron dhe nxit. Për këtë, gjithashtu, ka prova të sigurta. Sepse sa shpesh, edhe kur një biografi lexohet dhe hidhet mënjanë, një skenë mbetet e ndritshme, një figurë jeton në thellësi të mendjes dhe na bën që, kur të lexojmë një poezi apo roman, të kemi ndjesinë e njohjes, si të kujtonim diçka që e kishim ditur më parë.

Botohet në arabisht romani "Valsi i lumturisë" i shkrimtarit Ylljet Aliçka

Pas romanit "Rrëfenjë me ndërkombe-tare" botohet në gjuhën arabe roman i dytë i shkrimtarit Ylljet Aliçka "Valsi i lumturisë", dalë nga shtypi me titullin « Një ëndërr italiane ».

Romani « Një ëndërr italiane » është përkthyer nga origjinali nga përkthyesi me origjinë shqiptare Shaban Rexhep dhe botuar nga shtëpia botuese egjiptiane Al Arabi publishing house.

Romani « Valsi i lumturisë » është fitues i Cmimit kombëtar të letërsisë 2013, dhe veç gjuhës arabe është botuar në frëngjisht, italisht dhe maqedonisht.

Mbi subjektin e këtij romani është në proces realizimi i një filmi italo-shqiptar « Një ëndërr italiane ».



Kanë shkruar mbi romanin

Një komedi shqiptare "alla italiane". Të duket sikur e ka shkruar Age & Scarpelli, apo një Mario Monicelli më gërryes se zakonisht.

Goffredo Fofi, « Internazionale.it »

Një venë tragjike që provokon një buzëqeshje tejet të hidhur.

Stefano Pasta, « Corriere Della Sera »

Një roman ku absurdi na shfaqet nën petkun e një homori të zi.

Radio France-info

Përmes një ironie të distancuar romani të merr frymën. Atje ku çmënduria shëndrrohet në sjelljen më banale, terrori është e vetmja lidhje e mundëshme sociale.

Jean Paul Champseix « En attendant nadeaux »



الحلم الإيطالي

أوليت أليتشكا

ترجمة: شعبان رزبي



روايات مترجمة

A të ditë nuk më zgjoi si zakonisht alarmi i regjistruar në telefon. Ishte zgjim i pazakontë nga disa tinguj; u rrotullova disi nëpër shtrat me shpresën se mos flija edhe pak, por s'munda. Dera dhe muret e trasha nuk lejonin asnjë lloj zhurme të futej brenda. Dritaret i kisha mbyllur, grilat po ashtu. Asnjë magnetofon a radio nuk kisha në shtëpi. Televizorin e fika me telekomandë para se të shtrihesha. Atëherë, nga drejtin më futeshin deri brenda veshëve ata tinguj?! Më dukej se i dëgjoja me gjithë qenien. Se edhe trupi sikur po lëvizte nëpër shtrat, ashtu si në sintoni me ta. S'doja të zgjohesha aq shpejt. Ishte ditë pushimi. U ngrita në përgjumje e zgjim njëherësh për të kuptuar nga vinin tingujt grishës. Shkova drejt dhomës së ndenjjes. Atje ekrani i televizorit dukej i fjetur dhe sikur më thoshte: nuk është koha fare të më ndezësh kaq herët. Asnjë pipëtimë në dhomën e ndenjjes. I dhashë karar me mend se kishte qenë ëndërr. Po përpëlitesha në mundin për të kujtuar se pse më vinin aq të njohur në fakt tingujt. Ku i kisha dëgjuar tjetër herë? Por, sa u shtriva, sërish m'u shndërruan në tinguj alarmi. Alarm i kujtesës. Gjithkujt i ndodh, që tingujt të caktuar t'i rikujtojnë vende, ngjarje a njerëz të caktuar. Violina klithte magjishëm si në ekstazë pastaj mpakej në rënkim, e sërish tingëllimi përfshinte ca lëvizje të dorës dhe harkut mbi violinë, si të dy trupave nga ngjeshja pranë e pranë gjatë të njëjtin vallëzim. Po, në të njëjtin vallëzim... Vallëzimi ynë i parë trup mbi trup. Aty poshtë dritave të një peme që s'bëzante, për të na veshur me ngjyrat e dritave dhe tingujt e më të perëndishmes festë të Lindjes. Të Krishtlindjes. Nën tingujt e asaj melodie ne çmbështillnin poshtë pemës, në vend të dhuratave, lëkurën nga eshtrat tona prej pasionit.

- Sa e bukur kjo këngë!

- Le ta bëjmë melodinë tonë!

- Ç'janë këto truke adoleshentësh?

- Pse, ka dashuri pa melodinë e saj?

A, tash e kuptova se tingujt s'po dilnin prej askund tjetër, përveçse prej kujtesës sime. Si e përhënuar u ngrita sërish dhe u shtriva poshtë pemës së festës ... trupi i valë, i sapodalë nga shtrati i ëndrrave, m'u bë akull tek u përqafta trugut të kauçukit të bredhit imitues. Dritat që rrotulloheshin rreth degëve të sajuara nxirrnin, bashkë me ngjyrat, edhe tingujt e asaj melodie, që ishte atë natë sfondi i zëshëm kur bëmë dashuri një herë, dy herë, shumë herë, derisa drita zbardhi mëngjesin e ditës së shenjtë.

Pastaj më doli gjumi krejt dhe veten e pashë tek dridhesha nga nxehtësia përvëluese e dëshirës për t'i dëgjuar edhe një herë ata tinguj feste të trupave tanë poshtë një peme, që dukej se kumbonte edhe ajo. Festat zbkurohen më shumë nga llambat e ndezura të kujtimeve.

- Jo, nuk ka dashuri pa melodinë e saj, - thashë gati me zë, formova numrin e Julias në telefon dhe dola ta takoja te "Gloria", kafeneja jonë e preferuar.

- Ka kohë që nuk më flet më për të, - më tha ajo.

- Sepse nuk ka më rëndësi.

- Por dikur kishte, apo jo? - insistoi.

- Dikur po, - i thashë.

- A mund të më thuash diçka, që s'do ta harroje kurrë prej tij?

- Zërin...

- Këndonte bukur? - vijoi ajo pyetjen naive.

- Nuk ia njoh zërin e këngës, ato m'i dërgonte ndonjëherë nga youtube, - i thashë. Pastaj, duke menduar se Julia do të vazhdonte me pyetjen: cilën këngë të dërgoi së pari, i thashë pa më pyetur:

- Ne me quite pas/Mos më braktis...

- Unë, moj? - pyeti e tmerruar. Fjalinë time pa kontekst e mori si thirrmore të drejtpërdrejtë.

- Non, jamais/Jo, kurrë, - tha.

Nga frika se mos vazhdonte ligjëratën e

Anna Kove

GLORIA IN EXCELSIS DEO

tregim



saj në frëngjisht, e s'do t'ia kuptoja as edhe një fjalë të vetme, vazhdova: - Ky është titulli i këngës. Aq u desh për t'ia zgjuar kureshtjen. Nga iphoni i saj u derdh zëri i Jacques Brelit dhe ajo ia filloi të këndonte në sintoni me zërin e ngjirur të këngëtarin. Ndërsa mua më përshkuan dridhmat sapo m'u kujtua si më kumboi në veshë zëri i tij pas asaj nate feste, kur më telefonoi, pasi ishte zhdukur, e më thirri fort në emër. U drithërova. S'e kisha menduar se emri im kishte aq shumë pushtet mbi mua. Mbeta si e gozhduar nën forcën e vetëm tri germave. Heshta e s'munda t'i përgjigjem. Ai e përsëdyti: germa e parë... zanore e plotë, e zbardhur kumbuese, germa e dytë, bashkëtingëllore llastuese me gjuhën që ngulej e mishtë mes qiellzës së tij të lëngët, dhe germa e tretë sërish e njëjta zanore, më e plotë, bubulluese dhe më e zgjatuar nga simotra e saj e parë.

- Do të doja të të kisha pranë, këtu ku jam, - më tha.

- Ku je tani, që më dashke pranë, - e pyeta me hezitim, ngase kishim shumë kohë pa folur.

- Në varreza!

"O Zot, më ndihmo!" - mendova me vete në të qindtat e sekondës. A mund të bërtasë ashtu një i vdekur nga varret? Pastaj u kthellova. Përderisa po më flet, ky nuk është zë prej të vdekuri. Zëri i tij pak i ngjante haresë në zërin e një burri, që dhembshurisht i thotë emrin të dashurës në telefon, por ishte përgjërë e lutje, përzier më një lloj padurimi, për ta bërtitur, si për ta shkullur njëherësh atë emër nga vetja. Padurim për të më shkullur mua nga vetja, e njëkohësisht për të më pasur pranë. E, ku? Aty në varre.

Vetëm në tri germa ai përtheu gjithë

ndjesitë që shoqëruan atë marrëdhënie. Dashurinë e madhe e të rufeshme fillimore te zanorja e parë, pa e vrarë mendjen fare se ç'vinte më pas. Një "a" - si piskamë, si të ishte fillim i britmës së një ujku, që po bëhej gati për ulërimën e zgjimit të frikërave të çdo qenieje, që donte paqtim në terrin e natës. Ndërsa unë po prisja të paqtoja emocionet e mia të trazuar në britmën e tij, që mbase vetëm rastësisht u ngjante tri germave të emrit tim. Aty po fillonte hakmarrja e tij.

- Kush tha se dashuria i takon qiellit, Julia? - iu drejtova asaj që po priste t'i thosha diçka.

- I kam lexuar me sytë e mi çdo gjë që të shkruante, - më tha, - ishte çdo gjë thujse qiellore.

- Jo, zemër, fjalët e shkruara ishin çarku. I njuh gjahtarët? Nuk mund t'i ngrënë dot çarqet në qiell. Me zërin e tij, nga ai çast më paralajmëroi se ndjesia ime më shumë se qiellit, i takonte tokës, madje nëntokës...

- Ç'do të thuash ti me këtë? - më pyeti Julia dhe i ndërroi ngjyra e zërit.

- Atë që dëgjoje, madje dhe që e mendove, - i thashë.

- Po pse duhet ta bënte gjithçka aq të bukur, ashtu siç e bëri, kur do ta varroste? Nuk e harroj kurrë si u ktheve atë mëngjes nga "Gloria", - më tha.

- Si? - e pyeta.

- Si Afërditë.

Dhe pas fjalëve të saj, mua më kaloi ndër mend gjithë ajo natë që mezi u zbardh.

Pi një cigare me mua, të lutem, më tha. Zakonisht ai nuk pinte cigare. As unë. Atë çast ndjeva se do t'i pija të gjitha. Kaq shumë doja të flisja. Padurimi shoqëronte lëvizjet e duarve dhe përkujdesjen që duhani të ndizej, të digjej. Shtëllungat e tymit të trazonin ajrin

mes nesh, e pastaj të shuheshin. E kështu edhe me fjalën: do ndizej, do digjej, do batiste mes rodhanit të frymëve tona, e pastaj do të shuhej. Kisha filluar të flisja ende pa thithur cigaren. Fjalët, deri atëherë të rroposura në mendimet e fshehta, iu vardiseshin buzëve pa drojë fare. "Si guxoj kaq shumë, - i them vetes, - sikur ta humbas?" Mendimi nuk më trishton. Jam e bindur, se po të ndodhë kjo, do të fitoj tjetër gjë. Ai qëndron bri meje i heshtur dhe pret. Pret, që të ndez tjetër cigare e të flas sërish. Pret të çlirohet. Pres dhe unë. Thith më shumë se cigaren, mesazhet e pamjes së tij nga përjetimi i të thënave të mia. Tymi mes nesh rri pezull. Pezull dhe kjo natë e zbehtë që s'po din të erret, edhe pse orët kalojnë. Me siguri është nga ato net, kur muzgu i mbrëmjes shkrihet me muzgun e mëngjesit. Me dritën e yllit që as nuk lind dhe as nuk po perëndon këtë natë, mundohem të mbaj ndriçuar zenitin e pikëprerjes së komunikimit të fjalës sime me heshtjen e tij, dhe thith përsëri shumë thellë cigaren bashkë me guximin për të folur. Druaj se gulçi në gjoks do të më mbytë, ngaqë ai thotë gjëra të çuditshme, të padëguara, të pathënshme, të padashura, të pakapërdijshme për një grua që e do; ndërsa unë thith bashkë me to thartësi ngjarjesh dhe nikotinë. Përpiqem të them diçka. Për t'u qetësuar ndoshta. Belbëzoj. Flas kuturu. Flas me rrokje, me tinguj, me gishta. Flas kot. Fare kot. Gjëra që kurrë s'do t'i kisha thënë me mendje të kthjellët. Pastaj hesht. S'guxoj dot më. S'mundem. Fjalët vijnë deri te fyti e rroposen përsëri brenda tij, duke u shkapetur me gëlltijen e pamjes së frikësuar, që vjen nga burri përballë meje. Prapë belbëzoj. Ankthi rri pezull. Pezull dhe kjo natë, që s'u ngrys e as u zbardh, se dielli nuk zbriti sot më poshtë nga ç'duaja. Thith deri në fund cigaren, duke djegur gishtin tim të zverdhur si pashprehja e fytyrës së tij. Dhimbja e djegies së gishtit nuk është më e madhe se dhimbja e lëndimit. Përpiqem të kuptoj se ç'i thanë tingujt që kjo ditë-natë këndoi bashkë me yllësinë e qiellit të ndjesive të mia. Sytë i ka të mbyllur. Po dremit. Po, po. Mbi gjoksin tim po dremit. Si të qenë ninullë kënga ime! Pastaj zgjohet dhe më shtrëngon dorën. Fort. Gishtërinjtë marrin gjithë rrymat e dashurisë trupore dhe i çojnë te buzët, te flokët, te sytë, që shkëlqejnë si asnjëherë tjetër. "Afërdita, yll i mëngjesit", - më thotë, i patrazuar nga gjithë rrokjet e fjalëve të derdhura, rrotullohet më ngadalë e përkundër gjithë planetëve të tjerë, por është më i ndritshmi yll për tokën.

- E kupton, Julia? Unë duhet të isha ndriçim për tokën. Prej larg, a prej lart. Po ç'dreq rëndësie kanë metaforat tani, - i thashë, dhe këtë herë s'isha dot aq e fortë sa kur nisi biseda mes nesh. - S'mund të jetë vetëm qielli i bukur! Duhet zbkuroar edhe toka. A nuk i duhen tokës dashuritë e mëdha sa të tranDET? Ishte kohë të rmetesh atëherë. Të kujtohet? Po ti s'ke lidhje me tërmetet. Ti do vullkanet. Tokën në llavë, sepse që poshtë Vezuvit ende përvëlton lavdia e emrit tënd. Nuk ka asgjë më të ftohtë, thonë, sesa një dashuri e vdekur. Asgjë më të ftohtë se toka ku groposet ajo.

- Do më pëlqente më shumë të flisnin për lindjen e dashurisë. Jo për vdekjen e saj.

- Dashuritë i kanë thënë shumicën e gjërave, Julia. Emocionet që shoqërojnë lindjet e tyre pak ndryshojnë njëri nga tjetri. Pastaj, lindja e dashurisë e trondit qenien më pak se shuarja e saj. Apo jo?

Julia heshti. Ajo, që e ka çdo herë një mendim të vetin, s'tha asgjë dhe u përhumb në kushedi ç'mendime. - Ja, ma këndo edhe një herë vargun e asaj kënge, të lutem, - i thashë në fund, më tepër si për ta bindur se kisha të drejtë. "Do ta gërmoj tokën edhe pa vdekjes sime, për ta mbuluar trupin tënd me ar e dritë", m'i ndërmendi Julia edhe njëherë fjalët që bënin bashkë zërin drithëruar të këngëtarit francez me kumbimin e zërit të tij, teksa ma thërriste fort emrin prej varreve...

Me rastin e 148 vjetorit të lindjes

KUJTOJMË SHKRIMTARIN AMERIKAN XHEK LONDON

nga Dr. Ernest Nasto

John Griffith Chaney (12 janar 1876 - 22 nëntor 1916), i njohur si Xhek London (*Jack London*), shkrimtar, gazetar dhe aktivist i shquar amerikan.

Pionier i tregimeve e romaneve komerciale të serializuara në revistat e kohës, ai u dallua edhe si novator në zhanrin fantastiko-shkencor, duke u bërë një nga autorët më të parë amerikanë me famë botërore. London bënte pjesë në grupin letrar radikal *The Crowd* (Turma) në San Francisko dhe si socialist i flaktë, ishte mbrojtës i të drejtave të punëtorëve e të shtresave të shtypura. Disa nga veprat e tij trajtojnë pikërisht këto tema, si romani distopik

"Thundra e Hekurt" (*The Iron Heel*), përmbledhja me reportazhe "Njerëzit e humnerës" (*The People of the Abyss*), apo eseja "Lufta e klasave" (*War of the classes*). Prej këtyre prirjeve të majta censorët e regjimit komunist u kishin dhënë "vizën" e botimit veprave të tij edhe në Shqipëri, sigurisht nën shembullin e censorëve sovjetikë, siç veprimeve rëndom atëherë në të gjitha vendet lindore.

London ishte madje edhe më i privilegjuar në krahasim me autorë të tjerë të huaj, sepse studiohej veçanërisht në programet shkollore.

Në brezin tim të viteve '70-'80, ai admirohej jo për "Thundrën e hekurt", një roman i dobët që s'e lexonte njeri, e as për idetë socialiste, por sidomos për romanin "Martin Eden" (*Martin Eden*), ku heroi ishte tipi i njeriut individualist, të fortë e të paepur, të vendosur në arritjen e qëllimeve të tij për t'u bërë dikushi. Edhe veprat më të mira të London si "Kushtrimi i të parëve" (*Call of the wild*) dhe "Dhëmbi i bardhë" (*White fang*) pëlqeheshin prej nesh për të njëjtat arsye që e bënë atë të famshëm në Shtetet e Bashkuara e në shumë vende të tjera: përshkrimin mjeshtëror të natyrës së ashpër e të karaktereve po aq të ashpra, këmbënguljen dhe fitoren e më të aftëve, apo atë lloj primitivizmi magjepsës të jetës në viset e largëta veriore. Ngjarjet e të dyja këtyre veprave zhvillohen në Jukon (dhe Alaskë) gjatë etheve të arit të Klondajkut, ashtu si edhe ato të pjesës më të madhe të tregimeve të tij të shkurtra si "Shkretëtirë e bardhë" (*The white*



silence) apo "Të ndezësh një zjarr" (*To build a fire*). Një version filmik i këtij të fundit, i vitit 1969, shfaqej edhe në televizionin shqiptar në vitet '80.

Më kujtohet ndërkaq edhe se si teksti ynë i letërsisë së huaj në shkollë të mesme nuk harronte të vinte në dukje "kufizimet ideore" të Xhek London, ngaqë ky s'kish kuptuar mirë "rolin udhëheqës të partisë", apo se ishte tip anarkisti. Po ashtu atje theksohej se një nga romanet e tij të fundit, "Aventurë" (*Adventure*), ishte me pikëpamje të hapura raciste e kolonialiste.

Xhek London vdiq më 1916 në Sonoma të Kalifornisë në moshën 40 vjeçare. Është hamendësuar se ai bëri vetëvrasje, aq më tepër që kështu kishte përfunduar dhe personazhi i tij i njohur, Martin Eden, por studiuesit seriozë të tij e kundërshtojnë dhe e dokumentojnë që ishte vdekje.

Letërsia e tij më e mirë ka lënë gjurmë të forta dhe lexuesit shqiptar e ka dashur dhe çmuar.

Tregimi që po sjellim, ka gjithashtu për sfond Jukonin dhe kërkuesit e arit, por i përket një zhanri për të cilin ky autor i madh amerikan s'është edhe aq i njohur, atij humoristik. E pata përkthyer vite më parë, fillimisht nga italishtja, dhe revista "Hosteni" e kish nxjerrë me shkurtime në dy numra më 1986. Përkthimi i tanishëm, i plotë, është nga origjinali anglisht.

ZHDUKJA E MARKUS O'BRAJENIT

tregim nga

Jack London

- Vendimi i këtij trupi gjykues është të largoheni nga kampi... në mënyrën e zakonshme, zotëri, në mënyrën e zakonshme...

Gjyqtari Markus O'Brajen ishte tepër i hutuar dhe Mak Çarli i ra njëherë me bërryl në brinjë. O'Brajeni u kollit për të qëruar fytin dhe vazhdoi:

-Duke marrë parasysh madhësinë e fajit tuaj, zotëri, si edhe rrethanat lehtësuese, opinioni i gjyqit është që të furnizoheni me ushqime për tri ditë. Besoj se do t'ju mjaftojnë.

Xhek Arizona i hodhi një vështrim të trishtuar Jukonit(1). Ishte një rrjedhë e fryrë, pak si ngjyrë çokollate, gati një milje e gjerë dhe kushedi sa e thellë. Bregu mbi të cilin qendronin ishte normalisht dymbëdhjetë këmbë sipër nivelit të ujit, por ky po i afrohej tashmë duke përpirë parreshtur copra të vogla balte. Ato binin sakaq në gojën e shtjellave të panumërta dhe zhdukeshin përgjithmonë. Edhe disa pëllëmbë dhe Red Kau do të përmytej.

- Nuk mjaftojnë - tha me hidhërim Xhek Arizona. Ushqimet për tri ditë nuk mjaftojnë.

- E paskeni harruar rastin e Mançesterit - ja preu ashpër O'Brajeni. - Ai nuk mori as edhe një paund ushqim.

- Dhe ja gjetën kufomën në bregun e Lumit të Poshtëm, gjysmë të ngrënë nga egërsirat - u përgjigj Xhek Arizona. - Dhe vrasjen ai e bëri pa asnjë shkak. Xho Divesi s'kish patur ndonjëherë punë me të, as që i kishte rënë kurrë në qafë, por ai, vetëm e vetëm se i përzihej stomaku, u hodh mbi Xhonë e shkretë dhe e la në vend. S'po më gjykoni aspak drejt, O'Brajen, ja ku po jua them hapur. Më jepni ushqime për një javë, dhe e kam një shans për t'ia dalë mbanë. Ndryshe jam i humbur.

-Përse e vratë Fergusonin? - pyeti O'Brajeni me një ton të rëndë. - S'mund t'i duroj dot këto vrasje pa arsye. E pra, u duhet dhënë fund. Red Kau ynë s'ka ndonjë popullsi të madhe. Është kamp shumë i mirë dhe në të kaluarën s'ka pasur kurrë gjakderdhje. Tashti po na bëhen të përditshme. Më vjen keq Xhek, por dënimi juaj do të jetë shembull për të tjerët. Provokimi që thoni se ju ka bërë Fergusonin s'e justifikon aspak vrasjen.

- Hmm, provokimi! - u skërmit Xhek

Arizona. - Po jua them, O'Brajen, ju s'marrkeni erë fare nga kjo punë. S'paskeni pikë ndjeshmërie artistike. Përse e vrava Fergusonin? Sepse Fergusonin këndonte: "Dikur kujtoja se isha një zokth". Ja pra ajo që dua të di. M'u përgjigjini, ju lutem shumë. Përse ai këndonte "një zokth, një zokth?" Ç'duhej ky zokthi i dytë këtu? Vetëm njeri mjaftonte. Një zokth të vetëm do të mundja ta duroja. Por jo, ai dy që dy. Unë e paralajmërova. Ju afrova me respektin më të madh dhe i kërkova përunjësisht të hiqte një zokth. Bile ju luta. Dy dëshmitarë mund ta pohojnë këtë.

- Fergusonin këndonte me një zë të tmerrshëm, - ja pat një nga turma.

O'Brajeni bëri ca gjeste pavendosmërie.

- S'paskemi të drejtë të na respektohen shijet tona artistike? - pyeti Xhek Arizona. - I dhashë atij birboje një paralajmërim të qartë: dy zokthet ishin krejt në kundërshtim me natyrën time. Por ai vazhdonte të më dhunonte veshin duke më shtrënguar të dëgjoja dy zokthe. E pra, ta dini se ka njerëz me shije muzikore kaq të holla, sa s'do ta kishin duruar ta tepronte kaq shumë. Unë jam gati ta pij këtë kupë me helm, bile mund të lëpij edhe lugën, por dijeni ama se t'i japësh tjetrit tri ditë ushqim, ky është kulmi, po, po, tamam kulmi, dhe në shpëtofsa gjallë, s'kam për t'jua harruar kurrë. Vazhdoni e dërdëllisni tashti.

O'Brajeni lëkundej akoma. I hodhi një vështrim pyetës Mak Çarlit.

- Do të thoja se tri ditë ushqim është dënimi tepër i ashpër, - i sugjeroi ky, - por u përket juve ta vendosni. Kur ju zgjodhëm gjyqtar pranuaam t'u nënshtroheshim vendimeve tuaja, dhe do ta mbajmë fjalën siç e kemi mbajtur deri tashti, për besë!

- Ndoshta u tregova ca i rreptë, Xhek, - filloi O'Brajeni, sikur t'i kërkonte falje. - S'jam hiç në vete nga këto vrasje të mallkuara. Pranoj t'ju jap një javë ushqim.

Prapë qëroi fytin dhe vështrroi rreth e rrotull me plot besim.

- Dhe tashti mund t'i japim fund kësaj pune. Barka është gati. Lekler, sillni ushqimet. Hesapin e rregullojmë më vonë.

Xhek Arizona dukej shumë mirënjohës dhe, duke mermëritur diçka si "zokthe të mallkuar", hipi në barkën e zbuluar që përkundej në breg të lumit. Ishte një lundër e madhe e bërë me dhoga pishe të palatuara, të sharruara me dorë e të sjella prej pyjeve të liqenit Lindeman(2), ca qindra milje më sipër, në rrëzë të Shilkutit(3). Në barkë ishin vetëm një palë rrema dhe disa batanije për të dënuarin. Lekleri solli thesin me ushqime dhe duke u përkulur për ta ngarkuar pëshpëriti:

- Të kam furnizuar mirë, Xhek. Ke vuarë me arsye, mor qerrata!

- Pritjani litarin! - thirri Xhek Arizona.

Dikush e zgjidhi atë copë litari dhe e hodhi në barkë. Rryma e rrëmbëu në çast dhe e largoi nga bregu. Vrasësi as që i zuri me dorë rremat, bile dukej fort i kënaqur tek rrinte ulur në pupë duke dredhur një cigare. Pasi mbaroi, nxorri shkrepshen dhe e ndezi. Ata që rrinin në breg panë akoma dhe disa minuta shtëllungat e vogla të tymit mbi barkë. Qendruan aty derisa ajo u humbi më në fund nga sytë tek kthesa, nja gjysmë milje larg. Drejtësia qe zbatuar.

Banorët e Red Kaut i bënë në i zbatonin ligjet pa ato vonesa e sorollatje që janë aq karakteristike për botën tonë të qytetëruar. Nuk egzistonte asnjë ligj për ta në tërë Jukonin, përveç atij që krijonin vetë. Dhe ç'është e vërteta, qenë të detyruar të vepronin ashtu.



Red Kau lulëzoi më 1887 dhe Kllondajku(4) me ethet e tërbuara të arit qe akoma një e ardhme e panjohur. Madje as që kishin idenë nëse kampi i tyre gjendej në Alaskë apo në Territorin Veriperëndimor(5), me fjalë të tjera, nëse merrnin frymë nën flamurin me yje e shirita(6), apo nën atë të Madhërisë së Saj(7). Asnjë funksionar i çfarëdo rangu nuk qe hedhur kurrë deri atje, të paktën sa për t'u treguar gjatësinë dhe gjerësinë gjeografike. Red Kau ndodhej diku në breg të Jukonit dhe kjo u mjaftonte. Sa për flamujt ata ishin jashtë çdo mbikqyrjeje, e sa për ligjet, ishin në tokën e askujt.

Kishin krijuar kështu ligjin e tyre, e ky qe mjaft i thjeshtë. Ai lumë i bekuar i Jukonit ishte egzekutuesi i tërë vendimeve. Dymijë milje larg Red Kaut Jukoni derdhej në detin Bering përmes një delte nja njëqind milje të gjerë. Dhe gjatë gjithë këtyre dymijë miljeve s'kishte veçse një egërsi të virgjër. Të themi të drejtën, në vendin ku Porkupini(8) derdhej në Jukon, brenda Rrethit Polar, qe ngritur një bazë tregtare e Kompanisë së Gjirit të Hudsonit. Por ajo ishte disa qindra milje larg. Madje thuhej se akoma më larg ndodheshin edhe nja dy misione, por këto ishin vetëm fjalë, se banorët e Red Kaut s'i kishin parë kurrë. Ata qenë shtyrë deri në atë vend duke ardhur nga ana e Shilkutit dhe e burimeve të Jukonit.

Njerëzit e Red Kaut nuk i përfillnin krimet e lehta. Dehja, sjellja e padenjë apo përdorimi i fjalëve të ndyra quheshin prej tyre si të drejta natyrore të pamohueshme. Ata qenë individualistë dhe njihnin për të shenjtë vetëm dy gjëra: pasurinë dhe jetën. E për më tepër, në Red Kau s'kishte as femra, që t'u ngatërronin moralin e tyre të thjeshtë. Kampi kish vetëm tri kasolle prej trungjesh, sepse shumica e kësaj popullsie prej dyzet burrash banonte në tenda apo në kasolle prej degësh e gjetesh, dhe s'kishte as burg ku të mund të mbyllnin keqbërësit. Banorët ishin tepër të zënë me kërkimin dhe nxjerrjen e arit e s'mund të humbisnin një ditë të tërë për të ndërtuar një burg. Le që edhe ushqimi ishte me kursim të madh, prandaj mbajtja e burgut as që shtrohej fare. Kështuqë kur dikush prej tyre shkelte të drejtat e pasurisë apo të jetës, vihej në një barkë të zbuluar dhe lëshohej teposhtë Jukonit. Sasia e ushqimit që i jepej të dënuarit ishte në përpjestim të zhdrejtë me madhësinë e fajit. Një vjedhës i zakonshëm mund të merrte deri në dy javë ushqim, për grabitje të mëdha sasia përgjysmohej. Një vrasësi s'i jepej asgjë, por rrethanat lehtësuese mund të të siguronin diku ndërmjet tri ditëve dhe një jave. Markus O'Brajani ishte zgjedhur gjyqtar, ndaj i përkiste pikërisht atij të vendoste për sasinë e ushqimit që duhej dhënë. Kush shkelte ligjin duhej t'u nënshtrohej pasojave. Jukoni e rrëmbente barkën në rrjedhën e tij të shkumbëzuar dhe fatkeqi s'dihej nëse e arrinte detin Bering. Ama pak ditë ushqim i jepnin një shans. Nisja pa asgjë do të thoshte faktikisht dënim kapital, përveç një mundësie të vogël që varej nga stina e vitit.

Pasi zbatuan vendimin dhe pasi panë barkën e Xhek Arizonës të humbiste tej kthesës, të gjithë banorët e kampit u larguan nga bregu për të shkuar në punë, në pusët e tyre të kërkimit, përveç Xhim Kërli që ishte i vetmi në tërë krahinën që merrej me "lojën e mullirit"(9) dhe që spekulonte gjithashtu edhe me pusët e reja. Dy ngjarje të shënuara ndodhën atë ditë. Aty nga dreka Markus O'Brajani bëri një zbulim: nxorri një dollar, një dollar e gjysmë dhe dy dollarë në tri mbushje të njëpasnjëshme. Kishte rënë në një zonë tepër të pasur me ar. Xhim Kërli erdhi për ta parë, bëri vetë disa mbushje, dhe atypëraty i ofroi t'ja blente për dhjetë mijë dollarë: pesë mijë në pluhur ari në dorë, dhe gjysmën e fitimeve nga biznesi i lojës në vend të pesë mijëve të tjera. O'Brajani refuzoi duke shpallur me pasion se kish ardhur atje të nxirrte pasuri nga toka e jo nga shokët e tij. Dhe sidoqoftë ajo "loja e mullirit" s'i pëlqente hiç, plus që e çmonte vlerën e zbulimit të tij shumë më tepër se dhjetë mijë dollarë.

Ngjarja e dytë ndodhi atë pasdreke kur në bregun e Red Kaut zbankoi Sem Perli, i

cili vinte drejt e nga bota e qytetëruar. Kish me vete një gazetë të katër muajve më parë dhe, më kryesorja, një gjysmë duzine fuçi me uiski të porositura nga Xhim Kërli. Të gjithë e lanë punën për të shijuar uiskin - një dollar gota, që Kërli ua shërbente në vend - e për të diskutuar lajmet e fundit. Dhe gjithshka do të kish shkuar si jo më mirë nëse Kërli s'do të kish kurdisur atë plan të kobshëm, d.m.th. ta bënte në fillim xurxull O'Brajenin e pastaj t'ja blinte pusin.

Pjesa e parë e planit u realizua pa ndonjë pengesë dhe korri sukses të plotë. Filluan të pinin pa rënë muzgu dhe në orën nëntë O'Brajani kish ardhur në qejf e po këndonte. Me krahun pas qafës së Kërliit provoi madje t'ja merrte edhe këngës së të ndjerit Ferguson për ata zokthet. S'kish asnjë merak se mos stononte, fundja i vetmi njeri me shije artistike në tërë kampin gjendej tutje në Jukon, mes një rryme prej pesë miljesh në orë.

Por pjesa e dytë e planit nuk qe në lartësinë e duhur. Megjithë atë rrëke uiski që i derdhej grykës, O'Brajani s'bindej që s'bindej se shitja e pusit ishte një detyrë shoqërore për të. Herë pas here lëkundej në fakt, dhe ish gati të dorëzohej, ama në mendjen e mjegulluar buzëqeshte me vete. Ja kish kuptuar planin Xhimin, por i pëlqente edhe mënyra se si ky përpjekje t'ja fitonte zemrën. Uiski ishte vërtet për t'u lavdëruar. Pinin nga një fuçi e veçantë, që qe dymbëdhjetë herë më e mirë se të tjerat.

Sem Perli po u shërbente pijet burrave të Red Kaut në dhomën e kthyer në bar, ndërsa O'Brajani dhe Kërli vazhdonin gostinë e tyre në kuzhinë. Por O'Brajani s'mund të mjaftohej me kaq. U ngrit e vajti tek bari, dhe u kthye bashkë me Mak Çarlin e Persi Leklerin.

- Shokët e mi, miqtë e mi të mirë, - deklaroi duke u shkelur syrin e duke i drejtuar një buzëqeshje prej idioti Xhim Kërli. - Kam gjithmonë besim në fjalën e tyre, kam gjithmonë besim. Janë vërtet kapedanë. Hej Xhim, shtjeru djemve ca ujë të bekuar dhe le të vazhdojmë diskutimet.

Kërli u shqetësua disi nga këta miq të rinj, por, duke sjellë ndërmend vlerën e madhe të minierës, ku mbushja e tij e fundit kish nxjerrë shtatë dollarë, i dha karar se ja vlente ky uiski i tepërt, edhe pse në dhomën tjetër shitej një dollar gota.

- S'më vjen hiç mirë ta shes, - filloi t'u qajej O'Brajani të sapoardhurve, duke u përpjekur t'u shpjegonte çështjen. - E kush se? unë?... ta shes për dhjetë mijë dollarë! Jo që jo! Do të nxjerr ar sa të dua e pastaj do shkoj të vendosem në atë tokën e bekuar... si i thonë... ah, po, Kalifornia Jugore... tamam vendi që më duhet... hëm si të thuash... për t'i ngrysur ditët mirë... e pra, atje do të ngre... do të ngre... ç'po

thosha qëparë, do të ngre... e pra, ç'po thosha se do të ngrija?

- Një fermë strucësh - sugjeri sakaq Mak Çarli.

- Ah pikërisht...posi... tamam këtë kisha ndërmend të ngrija. - O'Brajani befaz drejtoi trupin dhe vështrroi Çarlin i mahnitur. - Si e gjetet? S'ja kam thënë njeriu, drejt ta marrë! Hëm, po ama për këtë po mendoja. Çarli, more qerrata, si ma lexove mendimin? Le të pimë prapë.

Xhim Kërli mbushi gotat dhe pati kënaqësinë të vërente se si rrodhi nëpër gurmaze një vlerë uiski prej plot katër dollarësh, sepse edhe ai pinte dollarin e tij. O'Brajani e kish bërë të jepte fjalën se do të pinte aq sa edhe miqtë.

- Më mirë t'i marrësh paratë në dorë menjëherë, - filloi të arsyetonte Lekleri, - do të të duhen dy vjet të nxjerrësh arin nga miniera, dhe ndërkohë do të bëje më mirë të merreshe me strucët. Do të kishe rritur shumë zogj e do të kishe marrë një sasi të mirë puplash.

O'Brajani e çmoi këtë ide dhe bëri një gjest miratimi. Xhimi i hodhi një vështrim mirënjohës Leklerit dhe mbushi prapë gotat (një dollar secila, jo shaka!)

- Dale, dale, prisni! - belbëzoi Mak Çarli, gjuha e të cilit po e humbte tashmë kontrollin. - Si miku yt i ngushtë... m'i ke rrefyer të gjitha... po, tamam... si vëllai yt... hej, drejt!

Ndaloi një çast të mblidhte veten dhe filloi prapë. - Si miku yt... si shok biznesi do thoja... apo më mirë do sugjeroja... po marr guxim të them... të sugjeroj... se mund të ketë më shumë strucë... bah, drejt!

Rrëkëlleu edhe një gotë tjetër dhe vazhdoi më me kujdes.

- Ajo që dua të them është... çfarë desha të thoja?

I ra kokës nja pesë a gjashtë herë me pëllëmbë për të shkundur mendimet që s'po i vinin.

- E gjeta! - klithi i ngazëllyer. - Po sikur të ketë shumë... po, shumë më tepër se dhjetë mijë dollarë në atë pus?

O'Brajani, që dukej se kish vendosur të pranonte, e ktheu mendjen në çast.

- Bukur! - thirri - ide e shkëlqyer! Kurrë s'do më kish vajtur vetë në mendje.

Ja zuri dorën përzemërsisht Mak Çarlit dhe ju kthye Xhimin i hakërryer. - Mund të jenë njëqind mijë dollarë në atë vrimë... s'besoj se do të doje të grabisje mikun tënd të vjetër, Kërli... hë thuaje, do doje? Sigurisht që s'do doje... s'kam pikë dyshimi...të njoh më mirë se ç'e njeht ti veten... posi, shumë më mirë. Ejani, edhe nga një tjetër... jemi të gjithë miq të mirë... ashtu vërtet, të gjithë!

Dhe ashtu vazhduan, ashtu rrodhi edhe

uiski, e ashtu vinin e iknin edhe shpresat e Xhim Kërliit. Një moment që Lekleri që shprehej për shitje të menjëhershme dhe gati ja fitonte O'Brajenit mendjen e lëkundur, vetëm e vetëm që ta humbiste përsëri përballë kundërshtimeve bindëse të Mak Çarlit. E pastaj që Çarli që ofronte arsye të pakundërshtueshme për shitjen, mirëpo Persi Lekleri rezistonte me kokëfortësi. Pak më pas ishte vetë O'Brajani që ngulte këmbë për shitjen, ndërsa të dy shokët përpiqeshin t'ja ndryshonin me lot e me ofshama. Sa më shumë uiski shkonin poshtë, aq më shumë u ndizej imagjinata. Për çdo argument të kthjellët pro ose kundër sillnin dhjetëra të tilla krejt të çoroditura, dhe ishin në gjendje t'ja mbushnin mendjen njeri-tjetrit kaq lehtë saqë i ndryshonin pozicionet orë e çast.

Erdhën kështu në pikën kur Mak Çarli dhe Lekleri ishin plotësisht të vendosur për shitjen dhe ja hidhnin poshtë kundërshtimet O'Brajenit sapo ky hapte gojën. Tashmë po i humbiste shpresat. Harxhoi edhe argumentin e fundit, dhe ra në heshtje të plotë, duke vështruar me përvuajtje shokët që e kishin lënë në baltë. I futi madje dhe një shqelm Mak Çarlit nën tavolinë, por ky hero i paepur shpalosi sakaq një argument të ri me logjikë të hekurt në favor të shitjes. Xhim Kërli e pa të fituar davanë, mori letër, penë e bojë dhe përpiloi një kontratë shitjeje. O'Brajani u ul dhe kapi penën.

- Të pimë edhe nga një gotë, o miq, - u lut - vetëm një, për fjalë të nderit, para se të dorëzoh të njëqind mijë dollarë.

Xhim Kërli mbushi triumfalisht gotat. O'Brajani e zbrazti të tijën me një frymë dhe u përkul të firmoste me penën që i dridhej në dorë. Por nuk kish shkarravitur as shkronjën e parë kur befaz drejtoi trupin dhe turulloi nga kënaqësia: një ide e shkëlqyer i kish shkrepur në kokë. U çua në këmbë dhe qendroi duke u lëkundur në mes të dhomës, me sytë e zgurdulluar që pasqyronin vorbullën e mendimeve aty prapa tyre. Në pak sekonda e gjeti përgjigjen. Me ngazëllimin që i rrezatohej në tërë qenien u kthye nga Xhimi i hutuar, e zuri për dore dhe i foli me zë madhështor:

- Kërli, ti je miku im. Ja ku e ke dorën time... shtrëngoje vëlla! Jo pra, nuk e bëj, nuk e shes... s'e grabis dot shokun tim. S'ka për të dalë kurrë ndokush në fytyrë të dheut e të thotë se Markus O'Brajani përfitoi nga shoku i dehur... ti je bërë tapë... s'mund të të grabis... sapo e mendova... s'e kisha menduar kurrë më parë... s'e di pse, por kurrë s'e kisha menduar. Kërli, mik i vjetër, pa ta zemë një herë... thjesht ta zemë se nuk do të ketë dhjetë mijë dollarë flori në atë drejtë pusi. Kjo do ish tamam grabitje ndaj teje. Jo mor zotëri, s'mund ta bëj... kurrën e kurrës... Markus O'Brajani nxjerr para nga toka, jo nga xhepat e miqve të tij.

Fshiu sytë me shami dhe u ul, ndërsa Lekleri dhe Mak Çarli, të entuziazmuar në kulm nga ndjenjat fisnike të shokut të tyre u hodhën mbi të duke e mbuluar me puthje e përfaqime të ngrohta. Mes breshërisë së lëvdatave as që e dëgjuan fare propozimin e Kërliit për të shtuar një klauzolë që parashikonte kthimin e diferencës nëse vlera e pusit rezultonte më pak se dhjetë mijë dollarë. Sa më shumë që flisnin, aq më të ndjera e më fisnike bëheshin fjalët e tyre. Çdo motiv i ulët qe sikterisur përgjithmonë. S'ishin veçse tre filantropë në përpjekje për të shpëtuar Kërlin nga vetvetja, nga vetë filantropia e tij. Ngulnin e ngulnin këmbë që edhe ai ishte filantrop. S'mund të pranonin kursesi egzistencën e ndonjë mendimi të keq në tërë botën. Me fjalët e tyre kuturiseshin në brigjet e në majat më të larta të etikës, ose mbyteshin në një det sentimentalizmesh.

Xhim Kërli ndërkaq djersinte, xhindosej dhe nga inati e derdhte uiskin pa kursim. Nxirrte lloj-lloj argumentash, pa asnjë lidhje me pusin e arit që donte të blinte. Sa më shumë kalonte koha, aq më tepër largoheshin në fakt nga çështja e pusit dhe më në fund, në orën dy të mëngjesit, Xhimi u tërhoq i mundur. I shoqëroi të tre miqtë, njerin pas tjetrit, deri tek dera e kuzhinës dhe u la lamtumirën. O'Brajani doli i fundit dhe të tre qendruan tek pragu, me krahët e kapura duke u lëkundur.

- Goxha djalë je... ti Kërli - lllomotiti



gjqytari. - Po ta them... më pëlqen stili yt ... dhe mik...mik... mikpritja jote... e pakursyer. E meriton ta them...sigurisht... dhe pazarin e bën pa hile...je i pastër, vëlla...jo tahmaqar... siç po thoja...

Në këtë çast Xhimi përplasi derën dhe të tre kumbarët filluan të qeshnin të lumtur duke u mbajtur tek njeri-tjetri. U gajasën sa u lodhën. Pastaj Mak Çarli provoi të hapte gojën.

- Oh ç'kemi qeshur... si asnjëherë... s'doja të thoja këtë... ideja ime ishte...çfarë? Ah, po, e kapa! E lezeçme ama si ikin këto mendimet... fshihen... të gjuash mendimet e fshehura... do qe sport i bukur... hej Persi, mik i lashtë... ke dalë ndonjëherë për gjah lepujsh? Kisha dikur një qen... zagar lepujsh... sa i mirë ishte... si e kishte emrin? S'më kujtohet hiç... s'kishte emër... ja harrova emrin... emri po fshihet... po kërkoj emrin e fshehur... jo, jo... idenë... idenë e fshehur... ja, e gjeta... ajo që doja të thoja... oh dreq!

Pastaj ra heshtja për një kohë të gjatë. O'Brajani u shkëput nga krahët e tyre, u ul në bar dhe zuri të dremiste i kënaqur. Mak Çarli vazhonte të ndiqte idenë që po i fshihej nëpër tërë skutat e mendjes së tij të pështjelluar, ndërsa Lekleri që i tëri sy e veshë në pritje të xhevahireve që do dilnin nga goja e shokut. Befas ky i ra shpatullave.

- E gjeta! - thirri me një zë solemn. Kjo ja preu fillin e mendimit Leklerit. - Sa dollarë qe mbushja? - pyeti. - Mbushja e sat'ëme! - shfryu Çarli. - Ideja, thashë... e kapa për këmbë... mbaje... mos e lësho!

Fytyra e Leklerit mori prapë një shprehje admiruese dhe po priste vazhdimin.

- ... oh, dreq! - klithi prapë Çarli. Befas Xhim Kërli hapi derën e kuzhinës dhe u bërtiti:

- Hajde, mjaft tashti, shporruni në shtëpi! - Ah, e çuditshme! - ja bëri Mak Çarli - tamam kjo ishte ideja... po, po, vetë ideja ime. Të shkojmë, pra, në shtëpi.


E zunë O'Brajenin për krahësh dhe u nisën. Mak Çarli filloi të gjuante një ide tjetër me zë të lartë dhe Lekleri e ndiqte i entuziazmuar. Ama O'Brajani s'ishte kurrkund, as shihte, as dëgjonte, as që dinte se ç'bëhej. Ishte thjesht një manekin që luhatej andej-këtej, dhe shokët, sado që përpiqeshin me zell, mezi e mbanin duke e tërhequr osh.

Morën shtegun që të çonte në breg të lumit. Ç'është e vërteta, shtëpitë e tyre s'qenë fare në atë anë, po ama ideja e pakapshme e Çarlit me siguri andej vërtitej. Dhe ky qeshte si budalla nën buzë me atë ide që s'po e kapte dot, megjithë interesin e madh të Leklerit. Arritën më në fund tek vendi ku qe lidhur barka e Sem Perlit. Litari që e mbante kalonte përmes shtegut dhe kapej tek një trung pishe aty pranë. U penguan paq e u shembën përdhe, të dy shokët mbi O'Brajenin e shastisur. Ky u përmend për një çast, ndjeu trupa që përplaseshin mbi të dhe u lëshoi një breshëri grushtesh. Pastaj e zuri përsëri gjumi. Vetëm gërhitja e tij dëgjohej dhe Mak Çarli prapë po qeshte nën buzë.

Befas belbëzoi: - Një ide e re, një ide e rrufeshme... ja, sapo e kapa... pa u lodhur hiç...ju afrova dhe, tak, e zura për qafe... tani është imja... ashtu posi...O'Brajani është i dehur... është krejt xurxull... turp... turp i madh... t'i japim një mësim të mirë... ja ku e kemi barkën e Semit... e fusim aty O'Brajenin, pastaj... pastaj...një ta prerë litarin e një ta lëshuar në Jukon... O'Brajani do zgjohet nesër në mëngjes... s'do mund të vozitë kundër rrymës... do detyrohet të kthehet në këmbë... do kthehet i xhindosur sa s'bëhet...ne të dy do ja mbathim në pyll se kushedi ç'na pret ... ai ama do të ketë marrë një mësim të mirë... ashtu posi.

Në barkën e Semit s'kishte asgjë veç një palë rremave. Bordi i saj lëkundej aty në breg, një hap larg O'Brajenit. E rrokullisën brenda si një thes me miell, Mak Çarli zgjidhi litarin dhe Lekleri i dha një të shtyrë barkës, e cila u rrëmbye në çast nga rrjedha. Pastaj të rraskapitur nga ajo punë e rëndë u shtrinë në breg dhe fjetën.

Në mëngjes gjithë Red Kau e mori vesh ç'i kishin punuar O'Brajenit. Bënë me dhjetra supozime se si ky do të hakmerrej ndaj dy



bukuroshëve kur të kthehej, madje vunë edhe plot baste. Pasdite nxorrën edhe roje për të vrojtuar bregun e për të dhënë lajmin e mbërritjes së heroit. Të gjithë mezi e prisnin atë çast. Por ai s'u kthye, sidoqë shokët qendruan të bregu deri në mesnatë. S'erdhi as të nesërmen, as të pasnesërmen. Red Kau s'e pa më Markus O'Brajenin, e megjithë hamendjet e shumta, asnjëherë s'u muar vesh ndonjë lajm që të sqaronte sadopak misterin e zhdukjes së tij.

Vetëm O'Brajani e dinte atë mister, por ai s'u kthye kurrë që t'ua tregonte. U zgjua në mëngjes me dhimbje e siklet të madh. Stomakun e kish të ndezur nga tërë ai uiski që kish pirë, dhe i dukej sikur po i digjej flakë. I dhimbte koka nga të gjitha anët, brenda e jashtë, por më tepër e shqetësonte fytyra. Për gjashtë orë rresht mijëra mushkonja kishin kullotur të qeta mbi të, duke e bërë të enjtej në mënyrë të tmerrshme nga helmi i tyre që s'të falte. Vetëm me një përpjekje mbinjerëzore arriti të hapte sytë e të shihte përmes atyre gropave mbi masën e mishit të fryrë. Deshi të lëvizte duart, por i dhimbnin shumë. I vështrioi për një çast mirëpo, ashtu të enjtura si trungje siç ishin nga pickimet, as që i njohu fare. Ishte krejt i humbur, pa asnjë ide për identitetin e tij. Ishte i shkëputur nga jeta e mëparshme dhe asgjë rreth tij s'i ngjallte kujtimin e së kaluarës. Për më tepër, ndjehej jashtëzakonisht i sëmurë e i dëshpëruar, pa pikë energjie apo dëshirë që të përpiquej të gjente se kush ishte apo çfarë ishte.

Pastaj vuri re që gishtin e vockël e kish të shtrembër, sepse kish thyer kockën shumë vite më parë, dhe vetëm atëherë e njohu veten, disi mjegullisht, për Markus O'Brajenin. Në çast e tërë e kaluara iu shpalos me vrull në ndërgjegje. Dhe kur pikasi edhe njollën e zezë në thoin e gishtit të madh që e kish vlarë me çekiç javën e shkuar, s'pati më pikë dyshimi: ato duar të jashtëzakonshme i përkisnin Markus O'Brajenit, ose më saktë, Markus O'Brajani u përkiste atyre duarve. Mendimi i parë që i shkrepri në kokë ishte dyshimi se mos kish qenë sëmurë nga malarja. Meqenëse i dhimbnin shumë sytë po t'i hapte, preferoi t'i mbante ashtu të mbyllur. Atë çast një degë peme goditi fort barkën, ai mendoi se dikush po trokiste tek dera e kasolles dhe u përgjigj "Hyrrë!" Priti pak e pastaj thirri me inat "Epo ik zhduku atëherë, thyej qafën!" E megjithatë ndjeu një dëshirë të madhe që dikush të kish hyrë e t'i thosh diçka për gjendjen ku ndodhej.

Dhe teksa dergjej kështu, imazhi i natës së kaluar filloi t'i kthjellohej ca nga ca në mendje. Jo, jo, s'kish qenë aspak sëmurë, mendoi, vetëm se qe dehur tapë, por tashti duhej të çohet e të shkonte në punë. Nga puna iu kujtua pusi, dhe ajo që s'kish pranuar ta shiste për dhjetë mijë dollarë. U ngrit pra ndenjtur dhe tek hapi sytë me mundim, e pa veten në një barkë që çante me tërë shpejtësinë mes valëve të murrme e të shkumbëzuara të Jukonit. Brigjet dhe ishujt me pyje bredhash ishin krejt të panjohura për të. Mbeti gojëhapur e s'po arrinte të kuptonte gjë prej gjëje. I kujtohej orgjia e natës së shkuar, por nuk shihte dot asnjë lidhje ndërmjet saj dhe gjendjes së tanishme.

Mbylli sytë prapë dhe shtrëngoi mes duarve kokën sa një daulle. Ç'i kish ndodhur vallë? Dalëngadalë në ndërgjegjen e tij po ngrihej hijja e kobshme e një mendimi të frikshëm, të llahtarshëm. U përpoq ta largonte atë mendim, e luftoi me të gjitha forcat, por ai këmbëngulte: KISH VRARË NJË NJERI. Vetëm kështu mund të shpjegohej përse gjendej në një barkë të zbuluar, në mes të rrjedhës së shpejtë të Jukonit. Me siguri ligji i Red Kaut, ai ligj të cilin e kish administruar vetë për një kohë të gjatë, ish zbatuar për të. Pra kish vlarë dikë dhe qe lëshuar në rrjedhën e lumit. Por kë kish vlarë vallë? Shtrydhi një copë herë kujtesën e mjegulluar për të gjetur përgjigjen, por nga tërë ajo përpjekje s'i doli gjë, përveç kujtimit të zbehtë të disa trupave që përplaseshin mbi të dhe një breshërie grushtesh të lëshuara me tërbim. Po cilët ishin ata? Mos vallë kish vlarë disa, e jo vetëm një? Vuri dorën të rripi i mesit. Këllëfi ishte, por thika mungonte. Padyshim ajo kish qenë arma e kimit. Por me siguri do të kish pasur ndonjë arsye për vrasjen. Hapi sytë në panik dhe u vu të kërkonte nëpër barkë. S'kish asnjë ushqim, as edhe një thërrime për be! Atëherë u ul dhe nisi të rënkonte. Kish vlarë pa kurrfarë arsye, pa kurrfarë provokimi. Mbi të kish rënë dënimi më i rreptë i ligjit!

Ndenji ashtu me kokën mes duarve ndonjë gjysmë ore, duke u përpjekur të mendonte. Pastaj freskoi stomakun me një grusht ujë lumi dhe u ndje më mirë. U ngrit në këmbë dhe, mes shtratit të gjerë të Jukonit, mallkoi alkoolin me fjalë që i dolën nga fundi i shpirtit, e që u dëgjuan veç nga ajo egërsi e virgjër që mbretëronte rreth e rrotull. Mundi të kapte litarin e barkës në një trung të stërmadh pishe dhe barka, e rimorkjuar kësisoj, filloi të ecte shumë më shpejt. Lau duart dhe fytyrën dhe u ul përsëri në pupën e barkës duke menduar. Ishte fundi i qershorit. Deri në detin Bering bëheshin nja dymijë milje. Barka ecte me

shpejtësi mesatare prej pesë miljesh në orë. Në ato vise veriore nata s'binte kurrë në atë stinë të vitit, e ashtu do të mund të ecte 24 orë pa pushim. Kjo do të thoshte 120 milje në ditë. Megjithë ndonjë pengesë të vogël, për 20 ditë do ta arrinte detin se s'bente. Dhe s'do kish nevojë të harxhonte energji, sepse punën e bënte lumi, ndaj mendoi të shtrihet në fund të barkës për të kursyer forcat.

Dy ditë me rradhë s'vuri gjë në gojë. Pastaj zbriti nëpër ishujt dhe mblodhi vezë rosash e patash të egra. Meqë s'kishte shkrepsë u shtrëngua t'i hante të gjalla. Vërtet qenë ca të rënda, po ama ja shtuan forcat. Kur kapërceu Rrethin Polar shquajti kampin e Kompanisë së Gjirit të Hudsonit. S'u kish arritur ende furnizimi, dhe kampi kish mbetur pa ushqime. I ofruan me gjithë zemër vezë rosash të egra, por u tha me mirësjellje se kish një sasi të madhe syresh në barkë. E qerasën edhe me uiski, por e refuzoi me neverinë më të madhe. Megjithatë u mori disa shkrepsë që të gatuante vezët. Tek afrohej në derdhjen e lumit pati erëra të forta përballë, të cilat e vonuan, kështuqë dieta e vezëve i zgjati 24 ditë. Për fat të keq ndodhej në gjumë teksa kalonte para misioneve të Shën Palit e të Kryqit të Shenjtë. Prandaj më vonë bënte be e rrufe me sinqeritet të plotë se thashethemet për egzistencën e misioneve ndanë Jukonit qenë veç pallavra. S'kish asnjë mision atyre anëve, këtë ai e kish vërtetuar me sytë e tij.

Sapo arriti detin e Beringut e ndërroi dietën e vezëve me atë të mishit të fokës dhe kurrë nuk qe në gjendje të përcaktonte se cila nga të dyja ishte më e neveritshme. Në vjeshtë i erdhi në ndihmë një anije e rojes së financës dhe, në të hyrë të dimrit, u gjend në San Françisko. Menjëherë u bë shumë i njohur si mbajtës leksionesh e konferencash mbi urtësinë dhe maturinë. Në këtë fushë Markus O'Brajani gjeti tamam prirjen e tij. "Mbani sa më larg shishen!" ishte kushttrimi dhe flamuri i tij i luftës. Arriti të linte përshtypjen se kish pësuar një gjëmë të madhe për shkak të asaj shishes së mallkuar. Fliste ashtu si kalimthi për humbjen e një pasurie kolosale dhe, pas këtij incidenti, dëgjuesit e shumë shihnin hijen e asaj të keqeje të tmerrshme e të patregueshme që vjen nga alkooli. Pati suksese të shkëlqyera në këtë karrierë dhe arriti të bëhej mjaft i respektuar në fushatën e guximshme kundër pijes së urrey.

Por në tërë krahinën e Jukonit zhdukja e Markus O'Brajenit ishte bërë tashmë legjendë. Ishte një mister që nuk do të sqarohet kurrë, një mister që mund të krahasohej pa frikë me atë të zhdukjes së eksploratorit të shquar polar, sër Xhon Franklinit (10).

- (1) *Yukon* - një nga lumenjtë më të mëdhenj të Amerikës Veriore që përshkon territorin kanadez me të njëjtin emër si edhe shtetin amerikan të Alaskës;
- (2) liqen malor në veriperëndim të provincës kanadeze të British Columbia-s;
- (3) *Chilcoat Trail* - shteg malor prej 53 km ndërmjet Alaskës dhe British Columbia-s, që u bë i njohur si rruga kryesore për të arritur në Kllondajk gjatë "etheve të arit";
- (4) *Klondike* - krahinë në Kanadanë veriperëndimore e njohur sidomos për "ethet e arit" që pasuan zbulimin e metalit të çmuar në fund të shekullit XIX;
- (5) *Northwest Territories* - një nga territoret administrative në përbërje të Kanadasë;
- (6) flamuri i Shteteve të Bashkuara;
- (7) bëhet fjalë për Mbretëreshën Viktoria (*Victoria*) të Britanisë së Madhe meqë Kanadaja ishte ende zotërim britanik;
- (8) *Porcupine* - lumë në Amerikën Veriore, degë e Jukonit;
- (9) angl. "faro" ose "farobank", një lojë popullore bixhozi në atë kohë;
- (10) Sir John Franklin (1786-1847), oficer i marinës britanike dhe eksplorator i njohur, ekspedita e të cilit në Arktik u zhduk misteriozisht më 1847.

Përkthyer nga origjinali dhe pajisur me shënime nga Ernest Nasto

Eshref Ymeri

Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe

19.300 shprehje frazeologjike



Shtëpia Botuese "Klubi i Poezisë"
Tiranë, 2022

Eshref Ymeri



ARTI I PËRKTHIMIT GOJOR

Eshref Ymeri

Përkthimi, një histori pasioni



OMSCA-1

Eshref Ymeri

Fjalor frazeologjik anglisht-shqip

25.400 shprehje frazeologjike



Shtëpia Botuese "Bota Shqiptare"
Tiranë, 2019